

BIBLIOTEKA

GJIROKASTER


854-32

1964

E

SHTETIT

SOTIR TH. ANDONI



MALEVE

NE SHENENDRE

TIRANË, 1958

18  
8  
28-36

19  
8  
28-36

891.983-32  
~~EA-3~~  
And 61

MADE IN  
THE U.S.A.



854-32  
A 64.  
~~814-13~~  
And 61

SOTIR TH. ANDONI

~~151~~  
151.  
BIBLIOTEKA E SHITETIT  
GJIRKASTER

# MALEVE NË SHËNËNDRE

NDËRMARRJA SHTETËRORE E BOTIMEVE  
TIRANË, 1958

Ky vëllim ka fituar çmimin e parë në konkursin e Ministrisë s'Arsimit  
e të Kulturës me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të  
Madh Socialist të Tetorit

Redaktor: SOTIR CACI

Tirazhi: 4.000

Stash: 2204-55

U shtyp në Stabilimentin «MIHAL DURI» — Tiranë, 1958



## MALEVE NË SHËNËNDRE

Atij moti të mallkuar kur gjëmonte topi i gjermanit, dimri nër anët tona qe i egër dhe me furtuna. Dëbora pllakosi gjithësinë me pllaska të trasha e shtrohej dit' e natë, sikur harroi të pushonte. Veriu vërshonte me tërsëllëm, sa nuk dëgjonje të pipëtijë as Juga e detit as era e Moravës. Pyjet e përrenjtë rënkonin nga ulërimat e Veriut e drurët ndër male çkuleshin me gjithë rrënjë e përmbyseshin tatëpjetë.

Në mbrëmjet e tilla ngrica bëhej m'e ashpër; hije në ngjyrë si t'errët si mavi shkisinin pas dëborës gjersa binte nata. Atëhere kopë ujqërish lëshoheshin nëpër fushat e ulërinin me të madhe. Lumenjtë dhe vijat e ujrave mbështilleshin me një savan prej akulli e cepikët pas strehëve ishin rritur si qysqi prej kristalli sa ment shponin tokën.

Hera-herës nër fusha, male e fshatra kërciste pushka e shkëm-bëshin bataretë. Kollona gjermanësh lëshoheshin fshatrave si ujq të tërbuar dhe flakadani ngrihej drejt qiellit mbi pullazet e shtëpive.

Në një ditë të tillë, në një mbrëmje dimri, një i panjohur la fushën e Devollit dhe mori përpjetë. I veshur si nata, doli nga ormanet e fushës, duke hetuar rrotull; i shpejtë si fajkua, me trup të shkathët e këmbë të lehtë, bëri për nga malet. Po ta ndiqte njeri nga afër do vinte ré se i panjohuri kish dy sy të prushtë e xixëllonjës që hithnin shkëndi posht e përpjetë nëpër krongjijtë e hollë si qirinj prej qelqi që vareshin nga kapuçi i gunës mbi kokë. Shpatullat e drejta dhe hapi i shkathët e tregonin të ri. Nga fundi i gunës i dukeshin këmbët e shtërnguara me kallce kozine. Qimet e dhirta të kallceve i rrinin të ngritura si gjemba prej eshi, të ngrira akull. Diç fshihte ndënë gunën, se në zhurmën më të vogël vinte dorën diku në brez. Hera-herës qëndronte dhe hidhte vështrimin rreth e rrotull. Afronte dorën në koka dhe hiqte më një anë kapuçin. Afshi disi i ngrohtë i fytyrës ja ngroh-te sado pak gishtat; ashtu përgjonte me sytë pishë, sikur t'ish vesh i tëri. Pastaj i lëshohej sërish së përpjetës.



Era frynte me thëllim, buçiste tutje nëpër gryka e lugina duke mbartur cikërima dëbore.

Kish rënë nata dhe i panjohuri vazhdonte të ngjitej përpjetë duke ecur larg rrugëve e monopateve; ike tërthori nëpër pllajat, larg vijave t'ujit e burimeve ku zihen pusitë e fshihet armiku.



Kur kaloi masën e kodrave u shkund dhe e ndjeu vehten si më të çkujdesur. Futi duart brenda gunës dhe nxori cigarin. Qëndroi një çast si për ta ndezur por shpejt ndërroi mendim; vijoi udhën duke kafshuar duhanin me dhëmbë. Ndofta bëri mirë se ja, disa hapa më tej, kur u ndodh ndënë degët e një dëllinje të gjërë, ndjeu një zhurmë metalike, sikur i shkohej llozi një pushke. U plas me fuqi mbi dëborë. Dhe dëbora u ngjesh; i panjohuri u fsheh atje si në një gropë.

«E ç'dobi do të kish se u shtri në dëborë?» — mund të pyesë ndokush; por ay, si njeri i stërvitur, e dinte mirë se korja e dëborës, ashtu si edhe faqja e ujrave ja kthejnë rrugën plumbit.

Vuri veshin: heshtje e plotë. Veç era punonte e nxirte fishkëllima të holla nëpër barin e thatë që ndodhej në gji të dëllinjës.



Pas pak zhurma u përsërit edhe një herë. Atëhere i panjohuri nënëqeshi sikur u tall me vehten e tija.

U ngrit. Zhurma ish e cepikëve t'akullit që thyheshin prej fuqisë s'erës.

Tashti ndodhej në kufit'e maleve të Moravës. Qëndroi një çast për t'u çlodhur dhe holli sytë prapa, nga Lindja, ku shtrihej Devolli. Larg në kazemat e Rëzës regëtinin dritëra si ndoca sy të fshehur që hapen e mbyllen duke përgjuar. Ndejti ashtu për t'u çlodhur, fërkoj duart me vrull e largoi me pëllëmbë reskat e dëborës nga balli e mjekra. Rrahu këllqet e mbushura me cifla akulli dhe ashtu ndjevi shpatullat që iu ndezën sikur i morën zjarr. Guna e dhirtë me kallcet e kozinta përjashta dhe gjaku i ri përbrenda po e mbanin mirë.

I panjohuri nuk e zgjati çlodhjen dhe u vu në rrugë. Tashti nuk i druhej më udhës dhe filloi të zgjedhë vrugat me një sy të çkujdesur, si njeri që ka rrojtur asaj ane. Me çap të sigurtë qëndroi diku anës pyllit, në qafën e malit, atje ku ahet e vjetër e nxinin më keq errësirën. Atje u vu të kërkojë diçka që e dinte se ndodhej aty. Nuk vonoi dhe i panjohuri zbuloi një hije të zymtë, që ngrihej mb'anë udhëkryqit. Ishte atje si shenjë kishe një copë muri sa një oxhak i madh, me një fletë kanate në ballë.

Kur afroi fytyrën në xhami i kanatës, i panjohuri vuri rë se brenda regëtininte i ndezur një kandil i vogël me vaj. Xhami ishte i veshur me okitë të trashë sa që rrezet e dobëta të kandilit zverdhonin si me përtesë. I panjohuri çeli me kujdes kanatën dhe futi brenda dorën për të ndezur cigaren. Një rreze drite çau atëhere errësirën për rreth.

Sikur të ndodhej njeri aty afër, do ta njihte mirë atë të panjohur që shtegtonte aqë me kuxim n'atë kohë e n'ato vraga të parrahura më parë.

Drita e kandilit i rrahu fytyrën, dhe krongjijtë si qirinj kristali q'i vareshin nga kapuçi i llamburitën në bebëzat e syve si në pasqyrë. Nga kapella ndënë kapuçin i feksi një shenjë e kuqe metalike në formë ylli, e ndënë 'të një zhgabë e zezë kadifeje.

Fytyrën e kish të mbushur, por thëllimi e kish rrahur aqë shumë sa i njiheshin njolla mavi në faqet e tëmthat.

Ay ish korier partizan. Rendte të arijë gjer në Polenë me një lajm të madh për ata që e pritnin.

Ish hapur fjala se forcat partizane në Devoll ishin zhdukur krejt. Dy Batalione të tjerë kish dërguar Komanda e Qarkut në ndihmë të devollinjve. Por edhe këto dy njësi, thuhej se ishin zhdukur.

Armiku mund të shpifte sa të desh, por dyshimi për humbjen



e tri njësave e kish kapur edhe Komandën e Qarkut. Dhe jo pa arsye:

Të tri njësitë nuk kishin dhënë shenjë jete. Shenjat e pritura me zjarre në majën e Moravës nuk ishin dhënë asnjë herë. Ishin nisur korierë për në Devoll dhe asnjëri nuk ish këthyer.

Dhe ja tashti korieri i ri po çante rrugën me një lajm të gëzuar.

Si ndezi cigaren partizani bëri më tej dhe u pështet pas një ahu. Hoqi nja dy herë cigaren duke e mbajtur disi të mbështjellë në pëllëmbën e kthyer si grusht. Por shpejt ndjeu ngricë në shpinë dhe trupi i mbështetur zu i shkiste pas ahut. Mori me mend se okita e kish mbështjellë ahun me akull të lëmuar.

— «S'duhet pritur më», pëshpëriti partizani.

Përsëri u vu në rrugë. Aty këtu i prisnin udhën egërsirat, që angullinin me përtësë dhe pastaj shkisinin tatëpjetë duke çfryrë dhe ulëritur nëpër errësirën.

Tashti partizani kish mbrijtur majat e Moravës dhe rruga hiqte nëpër një pyll të breshtë. Dëbora e trashë dhe e mbledhur kapulicë, kish mbuluar trugjet e pishave që mbanin përjashta veç majrat me ato bisqet si kryqe të akulltë. Korieri i preku halthet e pishave dhe boçat e thata dhe për një çast u ndje krenar që po kapte majat e drurëve që shtriheshin pas pllajës si ndonjë varrezë me kryqe mbi dëborë.

Furtuna po bëhej m'e ashpër. Era po e ngrinte dhe e shtynte hope hope me vrulle të papërmbajtshëm; atëherë ay i kthente kurrrizin Veriut, shtërngonte trupin e dhëmbët duke qëndruar i mbledhur kuspull. Frymë merte me zor; vështrimi i errësohej nga tufani që ngrinte ca si dallgë dëbore të mjergulluar dhe i përsëllonte sytë me cifla ngrice.

Kulmin e Moravës e kapërxeu duke u zvarosur me thonj e dhëmbë dhe bëri tatëpjetë. Këtej këmbët i punonin më mirë, por era e ngiste më me stuhi, se vëndi është i çveshur dhe avushë. Për një çast, si i ktheu kurizin Veriut, hodhi vështrimin nga Rëza e Korçës, nga fshati i tij. Erë e furtunë nga gjithë anët. Kandile të mekura ndrinin nëpër fshatrat e rënduara nga dimri. Majat e Qarrit dhe Zvezdës ngriheshin përpjetë si kone të zinj.

Vijoi tatëpjetë, duke rëshqitur pas rëzimeve me dëborë, gjersa ra poshtë faqes së malit, në përrenjtë e Mborjes. Atje korieri u ndjeu disi i çliruar dhe zgjodhi një vend të thatë pas shpatit të një shkëmbi. U unj për t'u çlodhur.

Rruga e gjatë nëpër atë dimër e thëllim e kish lodhur mjaft dhe i ndjente gjunjët si të mpitë. Mori pagurin e plumbtë nga brezi, e ngriti një herë dhe pastaj lagu duart duke i fërkuar. U ndje një damf rakije q'i gudilisi hundët dhe gjaku zu t'i lëvriqë



me forcë. Preku edhe një herë xhepin ndënë sjetullën e djathtë, ku kish letrën; u sigurua që e kish në rregull dhe nxori një copë bukë e gjizë dhe nisi ta hajë me një barrë shijë. Nxitohej në të ngrënë sa i tundeshin edhe shpatullat. Koha duhej kursyer e, sado e madhe nata e dimërit, rruga e nisur ish e gjatë.

Dhe duke ngrënë korieri mendohej:

Mendonte castin kur do t'arrinte në Komandën e Vendit në Polenë. Përpara se shokët të lexonin letrën që sillte, ay do ta shkreppte si bombë atë lajmin gazmor:

— «Shenjat e zjarreve nuk u ndezën se nuk linte veriu e ngri-cat, por të tre Batalionet në Devoll janë gjallë e shëndoshë, ata e kanë dërmuar armikun! Lexoni letrën e tyre. Na, merni edhe një flamur të gjermanit; e zunë pardje në luftë...»

Do t'i lëshoheshin shokët, pastaj, e do të putheshin buzë me buzë ashtu si dinë vetëm ata që kanë rrojtur orë t'atilla.

N'ato pllaja malesh, që shfrynin egërsinë e një dimri aqë të furishëm, ay po vinte e kthehej muaj me radhë. Këmba s'i përtonte, si djalë që ish, e sedra me ndjenjën e detyrës e nxitnin të bredhë maleve me një letër në gji e kuxim në zemër.

Pushkën e kish në krah, revolen në brez dhe një sërë granada varur pas gjerdhanit. Pajimet e tij ishin zgjedhur nga Komanda, e sejcili nga shokët në orët pas betejës do hiqte më nj'anë një pajim për korierët. Këtë kujdes e sajdi korieri e ndjente e, disi, i mbulohej ajo dëshira e pafjetur e luftëtarit që i është ndaluar të luftojë.

Se ish ligj i pathyer ay urdhëri i prerë:

«Korieri nuk ka luftë ballë për ballë me armikun; ay duhet të vrapojë gjithënjë dhe t'i shmanget syrit t'armikut. Ndjeu luftë a pritë, duhet të dredhojë, të shkasë si gjarpër e të mposhtë çdo revoltë të shpirtit. Kur mbrin në vend dhe dorëzon letrat, ay e ka mundur armikun; ja kjo është lufta e tij».

Edhe armiku e njihte mirë detyrën e korierve partizanë. Ay lidhej me radio e shifrarë, por luftëtarët e maleve me letra të shkurtëra në gji ngarendnin nëpër vijat e armikut. Të tjerë jepnin shenja me zjarre nëpër majat e maleve; e nuk ngjiste vetëm një herë kur roketat e kapura gjermanit shënonin në qiell shenja e parulla me gulshe drite në ngjyrat e ylberit.

Gjermanët vendosnin mina në vragat ku mund të kalonin korierët. Disa herë minat kishin plasur ndënë këmbët e korierve. Atëhere delnin vullnetarë të tjerë që i hapnin sytë më mirë dhe u lëshoheshin maleve, duke mbajtur nga larg erën e armikut dhe minat e tija. Kish ngjarë që natën n'errësirë, korierët, duke gjetur shtigjet e zëna me prita, futeshin në xhadenë e gjërë dhe u vareshin prapa kamionave të gjermanit!



E mirë se gjermanit mund t'ja hidhnje herë me gjoks e herë me dredhi (le që as ay s'e hante thatë) po çfarë mund t'i vinje përpara atij dimri të tmerrshëm që buçiste si i tërbuar?

Korieri ishte vërsulur përsëri pas pllajave me dëborë. Tashti qielli ish hapur, retë ishin shpërndarë dhe dukeshin yjtë si kandile të venitura. Veç Veriu s'kish ndërmend të reshte dhe harbonte si i tërbuar, si ndonjë bishë e goditur tutje nëpër luginat e përrënjtë.

Andej nga kalonte rrugë s'kish. Korieri drejtohej nga ay Ylli Polar, që dukej se xixëllonte më shumë se të tjerët.

Duke u zvarrosur tatëpjetë, në një rrëpinë e ndjeu dëborën të lëmuar si xham dhe fill atëhere shkau pa mundur të mbahej gjëkund. Rëshqitja ish e papritur dhe po ikte aqe me shpejtësi sa nuk mundi të marë frymë. Me një herë ktheu tytën e armës poshtë dhe rëndoq trupin mbi 'të. Thepi i pushkës gërvishti koren e akulltë të dëborës dhe u fut thellë. Atëhere mundi e qëndroi. Ndohej tashti në fund të një përroi të thellë. Aty duhej të kish patur ujë, por tashti s'ndihej të pipëtitë as pikë. Filloi të dalë prej përroit, duke u mbajtur pas ca si gollganësh prej akulli që nxirnin krye nëpër dëborën pas faqes së përroit. Por tashti ishte si në fund të një pusi. Nuk po dinte nga lind e nga perëndon, nuk e gjente dot me mënd nga cila anë duhej dalë. U suall poshtë lart e ariji në një vënd ku buzët e përroit ishin më të hapura. Atje ngriti vështrimin drejt nga qielli. Diku lart, po me shkëlqim, ndritte Ylli Polar. E njoiti mirë atë Yll të karvanit dhe shënoi me mëndje drejtimin e tija. Ngjitja tashti ish e vështirë dhe duart iu gërvishtën. Nga mezi i faqes së përroit shkau sërish dhe, pa pritur, u ndodh përsëri në fund.

Sa provë e vështirë!

Mëndja po i punonte me ngulm. Mendime e kujtime po i shkrepnin në kokë.

Që në vogëlin' e tija, kur ndodhej duke hipur a zbritur nër lisat apo majat e shkrepave, ay ndjente një si nevojë të brendëshme t'ja marë këngës. Kështu ndjehej më i shkathët dhe syri i shquante më mirë.

Dhe ja tashti aty pas faqes së përroit, kur po i ngarendnin në kokë tregime e copa historije q'i kallxonte komisari, tashti kënga i buçiti në kokë dhe iu bë sikur turma partizanësh e këndonin me të madhe.

*Nëntëqind nëntëmbëdhjetë  
Në dëbor e në tufan  
Ngritën flamurin e kuq  
Tej për tej në oqean!*



Po, edhe të tjerë si ay, të shumtë, të panëmëruar, qindra mijë e meleonë ishin zvarosur si ay nëpër akuj e tufane.

Dhe ndjeu krenari.

U ngrit me vrull dhe u vërsul duke rendur pas pllajave nëpër rrugët e vështira të luftëtarit kryengritës. Sa e gëzonte mendimi se n'ato udhë të vështira kishin sulmuar armikun mijra e mijra të tjerë, qindra vjet të shkuara, atëhere kur i madhi Skëndërbe dërmonte hordhitë e Sulltanit. Edhe atëhere rendnin korierë dhe ndizeshin zjarre në majat e maleve.

Kur ariji në Grykën e Avushës bëri emër të hyjë në Manëzë. N'atë fshat gjermanët nuk qëndronin natën; katundi ish bazë partizane dhe ay vetë ish kthyer aty disa herë.

I duhej të hynte në Manëzë sa për të ndruar kalloct e dhirta se ndjeu këmbët që iu lagën.

Zbriti faqen e malit dhe u drejtua tatëpjetë për në fshat. Më poshtë u shtri në kuriz dhe u lëshua tatëpjetë mbi dëborë duke u kolovitur. Për çudi qentë nuk po lehnin. Ndihej veç ushëtima e ujrave të remës që shkisinin ndënë akuj.

Arriji në shtëpit e para, në krye të katundit dhe u drejtua në një portë. Më sipër dritorja ndrinte. Me dorë të sigurtë dhe i çkujdesur trokiti në kanatë. Dikush brenda u nxitua të pushojë një qen, që nisi të lehë. Pas pak një çap i rëndë iu afrua portës nga brenda, e hoqi llozin; kanata e rëndë gërviti mbi mendeshetë dhe një zë i llahtarshëm u shkreh në gjermanisht e këputi një sharje pa kuptim. . .

Në fshat ishin gjermanët!

Korieri i futur në grackë pa e ditur dhe pa e kuptuar u ndodh ngushtë nga kjo e papritur e tmerrëshme. Duhej shkarë, duhej ikur, duhej gënjyer ay gjermani i madh sa një ari, që po çirrej bashkë me gërvimën e mendesheve. Duhej mënjanuar alarmi.

Këto ngjanë shpejt e shpejt, aqë sa zgjat një vetëtimë.

Korieri u vërvit tutje pas strehëve me rendje prej kaprolli. Po fill atëhere gjermani dha alarmin, duke qëlluar me revolver. Dhe me gjermanin nuk bëhej shaka. Se ja, si t'ishin ndodhur më këmbë, alarmit iu përgjegjën një breshëri të shtënash me automatik dhe një seri britma që ngjisinin si urdhëra dhe komandime.

Korieri ndodhej tashti në një qoshk të katundit pas një rendje të furishme q'ay s'e mori vesh n'ish rendje apo fluturim. Atje qëndroi. Ndënë këmbët e tija akulli u thye dhe ndjeu q'u fundos n'ujë gjer mbi pulpët. Dhe uji i përshkoi kallcinat.

Hije gjermanësh po i aviteshin dhe u zvaros më tutje. Aty n'errësirë, në një shullër dalloj nëpër bardhësin e dëborës një radhë manaferra. U zvarros me ngadale dhe vajti u fut atje. Duhej qëndruar pa lëvizje sa të qetësohej armiku. Pastaj duhej ikur.



Po fill atëhere hije gjermanësh po aviteshin nga manaferrat. Çaste të vështirë! Ta vrisnin aty aqë pa pritur? Si hyri në Manëzë aqë pa kujdes?

Duhej ikur, duhej ngarendur. Por jo! Me të ikur nuk do delte gjë veçse një vdekje e sigurtë. Do ta vrisnin pa tjetër. Por duhej rezikuar, duhej rëshqitur, duhej gjetur një mënyrë, një shpëtim. Shokët atje në Polenë duhet ta merrnin vesh lajmin e mirë.

Partizanët e lodhur nga luftimet e gjith atij dimri të tmer-shëm, partizanët e plagosur gjatë operacioneve, ata që nëmëronin me syt e tyre pikat e gjakut q'u rridhnin plagët pa patur barna t'i ndalin, shokët e terrenit që silleshin atyre anëve... Po, të gjithë ata njerëz të dashur për 'të ndofta ishin dëshpëruar për fatin e shokëve në zonën e veçuar të Devollit. Pra tashti ata njerëz të tij duhet të merrnin vesh nga ay, nga goja e tij se armiku gënjente, se njësitë partizane në Devoll ishin më këmbë dhe luftonin trimërisht.

I kredhur në mes të ferrave, korieri kish kapur granatat, i gatshëm t'i flakë sapo ta diktonin.

Për fat, gjermanët vinin vërdallë pa ditur nga të kërkojnë. Atëhere korieri hodhi vështrimin nga Veriu; ja aty larg, pas Rëzës, ish fshati i tija. Ay nguli vështrimin n'ato dritat e zbehta që regëtinin. Atje kish qënë kasollja e tij ku lindi e ku njohu botën, ajo kasolle që, tashti, ish shkrumb e hi.

Korieri, duke parë se gjermanët po largoheshin thellë fshatit, pati përpara syve të mëndjes vegime të shkurtëra:

— «Ja tashti nëna kërcure rri e përgjon natën, e gdhin me frikë, me mëndje bredh maleve pas djalit të vetëm, pastaj kthehet nga Lindja e falet; herë herë dëgjon shkëmbime armësh, del në dritore e përgjon me dorë në zemër: — Zot o zot, njërin djalë m'a more, ruama o zot djalin tjetër. Korba unë po bëhet tufani m'i ashpër, për çudi sa butë bënte kur u nis!..»

Papritur korieri dëgjoji një zë foshnje që qante. Ulërinte si e tmeruar një fëmijë në shtëpinë e fundit të fshatit aty pranë. Pastaj një batore automatiku u vërvit pas dritoresh sa u ndjenë krizat e thata të xhamave të thyer.

Korieri ndjeu përbrenda një pështjellim: gjermanët qëllonin dritoret nga qante foshnja. Dhe i dhimbej ajo fëmijë e njomë që ish zgjuar e trembur dhe e lebetitur. Po vallë fëmija pushoi vetë, apo ish goditur?...

— «Ja këta janë gjermanët. Ardhë të paftuar në tokën tonë, i vunë zjarrë vendit dhe qëllojnë foshnjat me automatik. Ja për këtë duhet luftuar, duhet shpëtuar, duhet ngarendur. U duhet treguar shokëve edhe kjo ndodhi, edhe ky rast kur gjermani shpirtzi vret foshnjat kur tremben...»



Në fillin e imagjinatës së tij, korierit sërish i dolli përpara e ëma. Pa tjetër se krizmat që ndëgjohen në Manëze i kanë vajtur në vesh edhe asaj. Po a e di ajo se unë ndodhem në gojë të ujkut? A e merr dot me mënd ajo se këto armë gjëmojnë pas djalit të saj? Dhe ajo flokëlëshuar e duarlidhur, falet gjithënjë. Kandili me vaj ja ndrit fytyrën e tretur, e urët në zjarr janë shojtur. Po, o nënë! Ti e pret djalin tënd, po ti nuk je e vetme. Meleonë nëna në botën an'e mb'anë presin djem'e tyre. Po ja që duhet vojtur, duhet luftuar, duhet zhdukur ky armik i tërbuar, ky përbindësh. Duhet luftuar që foshnjat të mos lebetiten në gjumë, që nënat e ardhëshme të mos rrojnë me ankth në zemër, që gjith nënat e ardhëshme të mos vuajnë ashtu si vuan ti! Është kjo lufta e fundit që nisi. . .

Këto mendonte partizani atje në mes të ferrave kur gjermanët filluan të mbyllën nëpër shtëpitë si e kishin zakon. Ata nuk linin roje kur flinin nër fshatra e veç ndonjëri përgjonte nga dritoret.

Veç kur u qetësua, atëhere korieri u zvarros ngadale dhe u vërvit fushës tatëpjetë.

Tashti sërish ndjehej i lehtë, i gëzuar i papërmbajtëshëm. Kishte shpëtuar nga një rezik e ndofta nga vdekja. Fluturonte nëpër arat e mbuluara me dëborë. Dhe dëbora e ngrirë e mbante sipër dhe sikur i jepte krahë për të fluturuar.

Por më tej iu desh ta ndërpresë atë ngarendje të marrë.

Kish kaluar xhadenë e madhe, kur këmbët e kujtuan se i kish të lagura, cingërima zu e ja mpinte gjith e më shumë. E ftohta zu e pushtonte gjith e më thellë. Buzët zunë t'i dridheshin, pastaj gjunjët. Një lodhje kapitëse zu t'ja shtërngonte qepallat dhe ta ndjellë në një si gjumë të rëndë.

U shkund si një kaproll që del nga ujrat dhe shtërngoi dhëmbët duke u vërsulur drejt kandileve në katundet e Rëzës. Aty diku ish Polena. Atje ish Komanda e Vendit.

Por më tej, gjunjët zunë t'i priten, pastaj filloi të përgjunjet. Përsëri shtërngonte dhëmbët si me mengene e lëshohej përpara me këmb'e duar gjersa u përplas në një ledh e s'mund të bënte çap përpara.

Atje u shtri sa gjat' i gjërë. Qerpikët filluan t'i unjen, koka iu rëndua e ndjehej si i humbur. Trupi zu t'i fundosej në dëborë, dhe tufani me shtëllunga të mjergulluara po e mbështillte me një shtresë dëbore. Ndjeu atëhere ca si spica që i gryenin ijet e çeli sytë që i kish të buhavitur. Ca si krimba të padukur po e brenin në tëmthat e iu duk vehtja se nuk ish ay, po ish dikush tjetër e bile filloi t'i vinte keq për këtë «tjetër» që po zhgryhej me vdekjen n'atë kallkan t'errët.



Të mbetej aty në rrugë si një udhtar i pazoti?

E ta shqyenin ujçërit trupin e tij?

Partizani pati një dridhmë përbrenda. Ay nuk desh të vdiste. As vetë e as ay «tjetri» që ish aty afër e s'dihet ku ishte.

U përmbloodh e shtërngoi dhëmbët, shkelmoi e përpoqi këllqet e mpitë dhe u ngrit. Kafshoi gishtat që të ndjente dhëmbje dhe t'i rridhte gjak. Një çerkë gjaku i ngrohtë i plasi nga mollza e dorës dhe në çast iu ngri. Futi duart ndënë gunë, nxori pagurin dhe derdhi pak raki ndër duar. Nuhati grykën e pagurit dhe u ndje disi m'i shkrifur.



Dhe sërish u lëshua në rrugë me shpirt ndër dhëmbë nëpër tufanin që ulërinte n'atë agim të ngrirë, kur suferima e kish bërë kallkan botën an'e mb'anë.

Tashti shtëpit e para të Polenës i shihte si nëpër mjergull. Nëpër cfilmat q'i delnin nga veshët dëgjoi zërin e një këndezi dhe pastaj lehjen e qenve. Duhet t'ishte fare afër. Buzët i kish si të pjekura, qiellza sikur i lëshonte avull dhe zemra po ja shkallmonte brinjët me forcë sa tëmthat i rrihnin si çekan.

Edhe pak rrugë... edhe një urëzë, një radhë drurësh dhe arrinte.



Tashti ishte brenda në Polenë afër Komandës së Vendit.

Por këmbët nuk e dëgjonin më dhe i ndjeu si të këputura. Atëhere u shtri dhe filloi të zvarroset si gjarpëri; edhe me gjysmë shpirti, por veç të mundte të shpinte vetë lajmin gazmor!

Dhe u zvarros me shpirt ndër dhëmbë gjer në sheshi para Komandës së Vendit. Provoi të thërresë, por zëri i tij i doli si një ulërimë e çjerrë dhe fare e dobët. Tashti mëndja disi i punoi me ngulm dhe, kur këmb' e duar nuk e dëgjonin, zu të zvarroset duke u mëshuar bryllevë dhe mjekrës. Por edhe kështu nuk mund të vazhdonte gjatë. Atëhere i vajti mëndja në revolja e tij. E çkuli nga brezi dhe me mundim e çkrehu një herë. Po vetëm një herë, më shumë nuk mundej.

U ndjenë thirrjet e rojeve partizane, këmbë që rrihnin dyshe-metë, zëra dhe urdhëra. Roja vrapoi drejt tij dhe i foli me emër. . .

Korieri pa shumë shokë që iu afruan dhe e morën më krahë; ishin shokë të njohur, por nuk i njihte dot.

E ndjente veten të lodhur, të dërmuar, të sëmurë, koka i lëshonte tym. . .

Mblodhi fuqitë e fundit që i kishin mbetur, shtërngoi buzët. lëvizti gjuhën e mpirë dhe foli. Jo nuk foli. Vetëm belbëzoi një thirrje të ngjirur:

— «Zjarret po ndizen mbi Moravë. . . shokët gjallë, luftojnë. . . merni letrën këtu. . .»

\* \* \*

Ditë të tëra korieri në shtratin partizan me gunën e tij përsi-për luftoi me vdekjen. Ilaçe nuk kish. Mjek nuk kish. Jo, mjek kishte. Ish një mjek rob gjerman që mbahej në katua me të tjerët pa të drejtë mjekimi. Dikush e shpuri mjekun gjerman afër të sëmurit sa për të dëgjuar një mendim.

Dhe gjermani e pa, i zuri pulsën dhe ngriti lart sytë e ftohtë:  
— «Për mua ka mbaruar, merni priftin».

Por shokët nuk iu ndanë. E mjekuan korierin ashtu si mjekojnë plevitin ndër malet tona: I dhanë të pijë gjalpë të ngrohtë dhe lëng pishë të zjerë.

Pastaj pritën ditë të tëra agonije e dyshimi.

Por korieri ish djalë i ri, trup i vojtur dhe i kalitur. Dësh edhe ay të rronte ditët e mëdha për të cilat mendohej.

Dhe rrojti.

Dhe përsëri ish korier.



## GAZET DHE HELMET E FSHATIT TIM

Një mëngjez qershori kur isha i vogël, më zgjuan shumë herët. Unë u grinda dhe u ktheva nga ana tjetër, qava dhe përpoqa këmbët, por nuk ma vunë veshin:

— Ngrehu që ngrehu!

Atëhere bëra sikur u ngrita dhe u futa ndënë krevatin e drunjtë, aty ja mora gjumit përsënjëzaj dhe për shtatë palë qejfe!

E mirë po isha pa fat, se shpejt më gjetën. Dhe këtë radhë s'kisha si shpëtonja. U ngrita.

Më dërgonin me Sekon në Selishtën me jonxhë që priste t'i vemë kosën.

— S'është ndonjë punë e madhe — më thanë — ja sa t'i ndodhesh kushos atje për ndonjë urdhëratë, sa t'i mbushësh ujë në krua.

Nuk e dinja e as ndër mënd më shkonte se ajo ditë do ishte veç të tjerave; se të themi të vërtetën, ngjanë asaj dite ca ndodhira që ja vlen t'i dëgjoni.

Kur iu afruam jonxhës më dolli gjumi fare; freskija e mëngjezit, aroma e grunjrave të ngalluar dhe ay pluhuri i verdhë i unapit që kundërmonte nëpër fushë, sikur ma kthjelluan ballin. Kalluam arat me thekër që rrethonin jonxhën, hapmë lesën në qoshe dhe hymë brenda. Bima hapëj hijerëndë si një qilim i gjelbër i spërkatur me bulëza vese. Kështu mua sesi më ardhi e u shtriva nëpër jonxhën, futa kokën pas rrënjëve, nuhata aromën e barit dhe atë erën që nxjer dheu i lagështë.

Sekua (Elisé e kish nga kumbarja po Seko e thërisnin) e gjeti t'udhës të më japë një të goditur me bishtin e kosës, e unë, duke u harlisur si ndonjë mëz q'e shpon tagjija, u vërsula nëpër jonxhën duke kërcyer kokë-tatëpjetë me gaz e me të qeshur ashtu si bëjnë kalamanët.

— «Mos mor viç i palëpirë, mos more se do të t'i jap në dorë ata veshë që s'të dëgjojnë...»

Kështu më thirri Sekua, po mua ec e më mbanje: gazi më këndonte përbrenda si bilbil dhe gjaku më zjente si qumësht i porsa mjelë.



Sekua u unj ndënë kumbullat e mezhdës, atje rrahu dhe kalitë kosën me majthin e vogël, i dha edhe një teh me grihën dhe janisi punës. Mua më mahnitte ajo zhurma e ëmbël dhe pak si e vrazhdë e kosës kur pret kërcejtë dhe, i vajta pas një copë herë. Bima që pritej lëshonte një lëng në ngjyrën e livadhit sa e gjelbëroi gjer në mes bishtin e kosës; veç tehu u zbardhëlye e fekste i hollë sa e priste qimen q'atje tej. Pastaj e lashë Sekon në punën e tij dhe fillova të sillem rrotull.

Aty afër është kisha e Shëngjergjit e rrethuar me avlli të larta një bojë njeriu. Oborri është i mbushur me pemë dhe rrethuar me plepa të gjatë. Dhe përmbi gjithë pemët, ngrihet atje një qershie e madhe që shoqen s'ja gjen në Devoll e tërë! Pa ato kokrat e kuqe të qershive, që ma bënin me sy që në agim, tashti ma lojtën mëndjen e ma bënë qerthull! Losnin e qeshnin me mua duke u fshehur prapa bisqeve e fletëve, kur rrezet e diellit shkisinin mbi cipën e tyre të njomë duke feksur e llamburitur.

Shkova dhe u kacavira pas avllive, Kisha droje të hynja brenda se jo më kot epitropi i kërcënonte djemërinë:

— «Mos hyni në qershit' e kishës se u del Shëngjergji me atë shtizën që vrau kuçedrën dhe u bën cop e trokë!».

Po epitropin me psalltërit q'i shtroheshin qershisë këmbëkryq dhe e hanin dhe e mblidhnin kur u tekej, Shëngjergji nuk u bënte gjë, se si duket ishin shokë e ortakë.

Por një palë djem të rritur (ndër 'ta ishte Sekua dhe Mihali i Gaqove) i hynin dorë qershisë ditën më drekë dhe as u bënte tërr veshi as prej epitropit e as prej Shëngjergjit. Asi kohe këta djema këndonin libra të ndaluara dhe shanin madhërin' e tij mbretin. Për këtë soj djemash foli një ditë dhespoti në kishë pas ungjillit kur nisi predikimin. I qojti të pafe e cipëplatur, tha se janë shokët e satanajt dhe së fundi i qojti demonë të kuq! (Mua më thosh mëndja se janë të kuq nga që hanë qershitë e kuqe të Shëngjergjit dhe i hyjnë në hakë dhespotit).

Plepat rreth kishës frushullonin duke zgjatur dhe përkulur hijet e tyre mbi varrezat ndënë pemët, atje ku çlodhen koskat e gjyshërve me kokallat e stërgjyshërve në prehër. Pashë hajatin e gjatë të kishës atje ku ngrihen dollapet e qirinjve; atje janë sëritur sëndyqet me eshtrat e priftërinjve të nxjera nga dheu tre vjet pas vdekjes, sipas zakonit; se në tre vjet, prifti (si prift që është) gjendet në dhë i tretur me këmbët shtritur e trupin përpjetë ashtu si e do e drejta. E m'u kujtua At Simoni. Thosh fshati se ay ish gjendur i patretur dhe i shtrirë, e gojët e liga flisnin se At Simoni — qoftë larg — (se ndër ta kish vajtur) na i kishte temjanisur nuset pa radhë dhe ishte mekatosur netët e pashkës kur kungohen çupat. Atëhere uratës së gjorë ndënë damfin e verës do t'i



kishte shkarë syri e mëndja pas gjinjëve të vashave q'i rihnin petrahilin kur u kavurdiste nëpër hundë ndjesët e mekatave!

U largova nga avllitë pa bërë gjë; se si e thotë edhe fjala: «Frika i ruan vreshtat». Nisa të sillem pas mezhdave. Trifili ishte rritur dhe kish lëshuar ato lulet e tija si rrodhe të buta, me ngjyrë ujra-ujra q'i afrohen asaj të mjaltit. Nga gjith anët bimët ishin ndezur dhe përtëritur dhe fusha dukej si një det i gjelbër. Po më shumë ma kish ënda të vështronja arat me grurë kur i ngiste era dhe i përkundte dallgë-dallgë. Dhe po të shtrihesh atëhere dhe të afrosh veshin pas bisqeve të ngalluar, të kënaq e të ledhaton ajo shushurima e ëmbël që del nga fërkimi i mustaqeve të grurit; ashtu të ze syri edhe ca pikëza t'imta e të kuqe flagë që lëvizin si me magji nëpër nyjet e kërcejve. Ato janë ca gjallëresa shumë të vogla që gjejnë strehë nëpër kokrat e bukës përbrenda kllasinës.

Kumbullat rënkoin të përkulura nga barra e rëndë e kokrave jeshile e degët e njoma ishin aqë ngarkuar, sa dukeshin si veshulë rush të gjatë e të këthyer tatëpjetë si hark. Andej sipër, nga ishin drurët më të dendur, qyqja këndonte e çkujdesur e si pa të keq e më tej e kthente zërin më të çjerrë (ashtu si bën grifsha) sikur i kërcënohej asaj tojës së gjorë q'i kish dhunuar folenë.

Aty afër ndihej gurgullimi i ujit të një burimi. E është aqë i ftohët ay gisht uji sa të bën ta kujtosh me mall ku të jesh e nga të ndodhesh, e jo veç ti e unë, por edhe ay mikut atje tej, q'i ka shpallur luftë ujit pa shpirtadhë.

Më tej u afrova pas kumbullave, atje në krye të jonxhës, dhe nisa të mbledh rëshirën e tyre. Sekua ma kish humbur tragën dhe kur ktheva kokën ta shoh, vura re se nuk dukej gjëkund; kosën e kish ngulur në tokë si flamur. U futa pas hijes së një kaçube dhe nisa të bëj saçma me rëshirën që pata mbledhur. Rëshirën e punonja me pëllëmbët dhe pëllëmbëve u ndihnja me gjuhën që kafshonja dhe nduknja pas nevojës. Nga puna e thellë ku isha përhumbur, më shkëputi papritur një zë i folur me gjysmë goje dhe si i trembur. Ngrita kokën dhe mbeta: Tre katër hapa më tej ardhë dy njerëz duke u fshehur me sa mund pas thekërishtës dhe gërsbetit të degëve. Ishte Sekua me çupën e vogël të Naqove, Katerinën. Mua as më panë e as kishin mënd të më shihnin. Ishin afër e afër dhe Sekua e kish përfshirë çupën pas beli, i përkëdhelte faqet dhe qeshnin ngadale e të gëzuar. Unë u struka e mbylla sytë, u shukosa e do desha të bëhem ikrë peshku sa të humbisnja në grashinën e mezhdës. E kuspulloja kokën dhe tëndosa dejet e zverkut sa mjekra më zuri në kërthiza; ashtu mbeta si i shatisur. Diçka ndëgjionja kur kureshta po më brente. Ngadale ngrita kokën dhe hapa njërin sy! Ishte e bukur dhe veç të tjerave Katerina. E pinte ujën veç shoqeve, i thosh diellit ja dil ti ja të dal



234674

SHKOLLË E SHTETIT  
GJITHËPËR

unë. Syfilxhan e qafëgjatë, gushëbardhë e vetullhollë, buzët e kishin me tul, të kuqe e të lëngëshme si ato qershitë e Shëngjergjit që ma lojtën mëndjen mua. Dhe e tëra që nga koka e ne këmba ishte e bëshme dhe e ngjeshur me një nur të rrallë.

Befas Sekua u bë si i egër, ja hodhi prapa gërshetat, e shtrëngoi pas vehtes dhe e puthi në buzë sa e la pa frymë!

Ndëgjova zërin e vajzës:

— «Veç mos më lësh o Elise, se jam jetime e është gjynah...»

Sekos i dridhej nofulla, gëlltitej me mundim dhe i mekej goja; vajza rrinte disi e qetë me një palë sy që ndillnin mëshirë, si një mëshqerë q'e ka zënë egjra.

— Rri këtu, — foli Sekua, — do vete të mar qershi, — dhe u nis për nga kisha. Mua m'u bë sikur po më sulej ndonjë kazan me ujë shkëmbi. Sekua, duke kaluar, sa s'më shkeli, por më pa.

— «Ç'bën këtu, more këlysh?»

Unë nisa të fërkoj sytë, buza më dridhej dhe ngrita doçkat me shpinë nga balli. Ata të dy folë diçka që nuk ma zu veshi. Si duket e ndjenë që nuk fshihej hosteni në thes. Më folë të ngrihem, por unë u katosi dhe u mblodha kuspull. Zëri i Sekos dridhej si i trembur, Katerina dukej si më trime. Më kapi nga sqetullat dhe bëri të më ngrehë. Unë pulita sytë dhe shtërngova buzët. Pastaj u unjën dhe më morën në mes.



— «Shiko, unë Sekon do ta marr burrë... po ti mos i thuaj gjë njeriu se pastaj na vret babagyshi juaj e bëhemi gaz i botës: pa unë do vij për nga herë në shtëpinë tuaj, ty do të të dua veç së tjerëve, pa do të të sjell një anteri të bukur, do të të ndih të nxësh mësimet, por ti veç ta mbash fjalën, se mos të shkasë goja ndonjë herë; Sekua do të të sjellë qershi, mollëdheu, lajthi...»



— «Po të më sjellë edhe një thëllëzë mali!»

— «Posi, edhe thëllëzë do të sjellë, hë Seko do t'i sjellësh djalit thëllëzë?»

— «Posi, më gjith kuvli bile, do të bëj një kuvli prej kallami». Më fjalë dhe përkëdhelje Katerina më mori në pëqi. Unë rina me droje dhe fytyrën e mbanja fshehur. Ajo më përkëdhelte sikur më moriste flokët. Nga turpi unë e ndjenja ballin zjarr d'faqen e kisha mbi gjinjët e Katerinës butë si në pupla. Pas qafës dhe mbi kokën e gethur shpesh ndjenja rëshqitas dorën e Sekos dhe fill atëhere (si për çudi) ndihej zëri i Katerinës që guitte si pëllumbeshë.

Si hëngrëm qershitë që solli Sekua, Katerina iku vjedhazi duke qeshur dhe kanosur me gisht. Pulpët e bardha i kish vija-vija nga shenjat e barit ku kish ndejtur, flokët i qenë mbushur me polenin e thekрит.

Unë, ca nga sedra e ca nga besa, fjalë nuku nxora. Por edhe Sekua e mbante fjalën si burrë. E kisha krahu në çdo nevojë dhe fjalë nuk më bëhej dy. Bilbila e thëllënza i kisha në kuvli, prazhden dhe llastikën në kamare, stap prej thanë prapa derës, lajthi sa të desha dhe qefin mal e shkuar malit. Po kjo begatija ime nuk zgjati shumë kohë.

Ishte koha e lëmit atij gushti, kur filluan grarija të endin shajakun për burrat, që do shkonin në kurbet. Kjo ngjiste mot për mot e sa afronte vjesht' e parë. E, se Sekua ishte rritur e bërë goxha burrë, gjyshi ynë që mbante timonë e shtëpisë, bëri emër që t'i gatitin rrobat.

— «Nisu edhe ti atij kurbeti, more bir — i foli Sekos — nisu, ndofta na sjell ndonjë mbarësi e ndofta të vijnë ato mëntë, që m'i ke majë plepit; por më parë do ta hamë atë dasmën tënde, e ke parë edhe vetë, ajo çupa e Kozmajt u rrit e s'e nxe porta...»

Kështu foli gjyshi dhe qeshi i kënaqur duke fërkuar me pëllëmbën e dorës atë barrë mustaqe gjer ne lap' e veshit. Sekua përpëliti sytë, u zverdh e u thartua nga fytyra, mjekra iu drodh si prej etheve të gushtit, po sesi pati zemër dhe ja ktheu sy ndër sy:

— «Ajo që thua, ore gjysh, është punë që s'bëhet, martohem, por veç Katerinës së Naqove tjetër nuk marr, as sot e as mot!» Plasi sherri në shtëpi. Plaku mori zjarr dhe e humbi mëndjen fare. Thërriste dhe ulërinte me të madhe:

— «Jashtëëëë, nxireni jashtë qenë e pabesë, jashtë këlyshnë e pabindur, se do të ngrihem ta vras me dorën time.»

Ishte i mirë me ne të vegjëlit gjyshi, po kur zihej me të mëdhenjtë bëhej si i prishur menç, ishte zemërgur dhe s'desh t'i bë-



hej fjala dysh. Emta Olimbi u pikëllua sa i ra vilanija. I hynë grarija plakut dhe deshin sikur ta ëmbëlsojnë punën, mos e nxirte Sekon jashtë, po ku shtrohej ay!

— «Jashtëëë, nxireni jashtë qenë e pabesë, jashtë të flerë si ay qeni, se mos do t'i fryhet barku a!»

Britmat dhe sherrin e shtëpisë i mori vesh fshati i tërë. Asaj nate njeri i gjallë nuk fjeti në shtëpi. Por edhe Sekua nuk i shtrohej fjalës dhe as kish ndër mend t'i unej plakut:

— «Do marr rrugët, thërriste tërë inat, do ik ku sytë këmbët dhe gjer prapa diellit do vete, po do mar atë që dua vetë. Iku koh'e pleqve, martohem unë, jo ay gërxfhua!»

Kështu shfrynte Sekua, por mua s'më vinte mirë ta shante gjyshin e me mëndje nuk mbanja dot asnjë anë; por, që të na vinte në shtëpi ajo Katerina e bukur e Naqove me atë anterinë time të kuqe, këtë ma desh zemra veç së tjerave.

Gratë u falë ndër gjithë shenjtorët, ndezë qirinj e kandile nëpër kishat, lidhnë e zgjidhnë djaj edhe magjira, e bënë edhe gjyshin shenjt e i bënë lutje e metanira, por bosh që bosh, plaku nuk unej.

— «S'ka ndodhur t'urdhërojnë djemtë në strehët tonë; sa është gjallë kjo koskë (dhe rrihte gjoksin) do bëhet si them unë.

Puna vajti gjer atje sa iu mblodhë gjyshit vërsnikët e tija dhe rrahnë ta sjellin mb'udhë. Kot që kot, nuk u ndezi. Veç Serafimi ja mblodhi këmbët në një opingë kur i foli vetullngrysur:

— «Ëndëra të liga kam parë, o xha Gjergo, gjer në kreshmët e vogla ke gjak e prishje në shtëpi, shtëpija është e jotja, njeri nuk të përzjehet, por veri gishtin kokës se gëzohet qoftë-largu; nipi do t'ikë nga shtëpija e do bëhet qefi i hasmat: — Nipi i Gjergos dhëndër brenda! Turp për atë perëndi, turp sa je gjallë zotrote!»

U përtyp gjyshi, u gëlltit i menduar dhe psherëtimi thellë me sytë përdhe. Kjo fjalë e fundit sikur e shpoi mu atje ku i dhimbte më shumë.

— «Po mirë, o Serafim, po ti si më mëson kështu? A të fut unë në shtëpi çupën e Naqove? A nuk kemi qenë në sherr gjithë jetën me derën e tyre?»

— «Po ca më mirë, mor vëlla, do t'i vemë plagës bar të mirë, mjaft me hasmëri, nesër-pasnesër do dalim përpara gjyqit të madh, si do ta gjykojë zoti kur përze nipin nga shtëpija? Pastaj ti ç'ke me shtëpinë e Naqove? Ti merr zogun nuk merr folenë!»

Ra në mendime gjyshi e u tret një javë të tërë pa ngrën e pa pirë; dy tarkaçë duhan i dogji çibuk pas çibuku. Sekua s'mblidhej në shtëpi as ditë e as natë. Gjyshit po i merte flagë pisha nga



të dy anët. Një mëngjez të djele, si u kthye nga mesha, gjyshi lëshoi pé dhe e thirri Sekon pranë:

— «Po unë s'e kisha me tërë mënt more bir, po ti mos e merr për keq, veç ma theve zemrën, o nipçe, mua që akoma i kam pëqinjtë me shurrën tënde. Dhe e ke atë kokën ti, tamam si unë kur isha i ri. Vërtet kështu kam qënë, por pleqve nuk u s bënja fjalën dy; pastaj të rrimë shtrembër dhe të flasëm drejt: Mua më shumë më ardhi keq për atë çupën, q'ë paske bërë me llafe se, për ndryshe, ta këputnja kokën si të zogut dhe ta hidhnja tutje.»

Kështu foli gjyshi sa për të folur, po ç'është e drejta u unj.

Unë, atij mëngjezi, kur gazi dhe mirësija qeshën sërish në shtëpi, u sula me linkth nga shtëpija e Naqove dhe zura vinja rotull oborrit. E pashë Katerinën ne dardha kur po tundte në pëti; ishte zbehur si prej verdhëze dhe syri i qe këputur. Kur më pa, u vu të bëjë buzën në gaz, por nuk mundi. Më bëri shenjë t'i afrohem, por unë iu derdha me vrap, si ay qeni kur këput zinxhirë dhe ja lëshova sihariqin. Ajo më rrëmbeu në krahë, më puthi faqet, më shtërngoi me dashuri dhe më futi në odën e saj. Tashti faqet i kishin marrë zjarr, sytë e prushtë i u njomën dhe më mbyti me fjalë dhe përkëdhelje. Po më jepte dardha dhe një luleshpate, kur dera u përplas pas murit me tërsëllëm sa çupra gërqejeje u përshkënditën nëpër dhomë. Ne pragu u dha Sekua me flokët e rrëzuar mbi ballë, me këmishën e çkopsitur gjer ne lukthi sa i dukej ay gjoksi leshtor; sytë i kish si të çakaritur. Kur më pa mua me sihariq në dorë, e mori vesh q'isha nxituar dhe foli me bujë e me të qeshur sa lojtën xhamet e dritoreve:

— Katerina moj!

S'pati as turp cipëplasuri po e përfshiu Katerinën në sy tim, e ngriti lart, e puthi dhe e shtërngoi sa i krisnë koskat. Ajo desh t'i ikte nga duart se i shkau fustani përmbi ato gjunjët e mbushur e të bardhë qumësht, po ku merrte pykë ay kokëshkëmbi me fjalë e me të butë.

— «Po dale, more, po ti u prishe mënc, ç'bën kështu?!

Pastaj me zë të ndruar:

— «S'ke as turp nga yt kushëri!»

Unë kisha futur kokën në qoshja dhe nuhatja një erë linje që delte nga dollapi.

— «Po lëshomë more — i fliste Katerina — lëshomë të them, lëshomë se do thërres, lëshomë t'u bëfsha kurban se po vjen nëna...»

— «Po le të vijë moj, — ja ktheu Sekua, — unë s'iu tremba atij që kam atje në bash, pastaj sat ëme do t'i trembem!»  
Dhe ja buçiti zërit Sekua sa gjëmoi shtëpija:



— Lenooo, moj, Lenooo!»

Xhullira reshti m'at'anë dardhës dhe nëna e Katerinës u dha ne dera:

— «U bubu, more djalë, po të plasi cipa more bir, po ç'bën kështu, o të keqen, mos eja kështu në mes të ditës se do na varësh korminën më qafë...»

Po Sekua nuk e la të flasë.

— «Hajde, leri fjalët Leno, bëj gati perin e kuq të mëndafshitë, nesër të vjen mëmë Olimbija të sjell nishanë!»

\* \* \*

Nuk vonoi dhe në ballkonin e shtëpisë ngritëm bajrakun e dasmës me një mollë të kuqe ngulur majë shtizës. E kush më mbante mua me atë mësallën e bardhë gjer përdhe?

I rashë kryq e tërthori fshatit me plloskën me verë krahë-qafë ngarkuar me borzilog dhe i ftova njerëzinë më dasmë. Ca uronin çiftin e ca lëshonin thumba:

— «Haj të trashëgohen dhe të rrojë sebepi!»

Tutje tëhu m'a bënin qefin edhe mua:

— «Gazi t'u trashëgohet, një herë e me jetë, e më kokën tënde.»

Ndonjë shakaxhi i shkreppte urrët larg e larg:

— «E fortë kjo vera ore, si inati i Sekos... si inati i Sekos dhe si palla e Gjergos...!»

Unë ngisnja çap e jak, mbush e zbraz plloskën. Kur më ra rru-ga nga Naqot, hyra kapadai drejt e brenda. Një tufë gra qëronin grurin e dasmës dhe këndonin:

*Do t'i bëj babajt një dhunë,  
Do t'i zbraz hambar me grurë,  
Se më dha ku s'desha unë,  
Se më dha në njerëz shumë,  
S'i laj dot e s'i ndroj kurrë,  
Që të hën' e gjer të shtunë!*

Hyra edhe atje ku ishte Katerina. Shoqet e kishin marë në mes dhe këndonin. Ish e bukur si nga hera, por që veshur me një **rrrobe të vjetër që t'i binte nur kur të vishej nuse.**

**Të shtunë mbrëma ardhën aqë shumë miq, sa s'i nxinte shtë-pija. Atëhere fqinjët hapën dhe ata portat e na bënë nder se ua kishim borxh për gaz e për të mirë.**

**Ka krisur vallja e gazi asaj nate sa thamë se u shemb shtë-pija.**

Ishte prerë udha asaj kohe të mernim për sazë Bramkën me gërnetë se gjith e më mirë e bënin këtë punë djemëri e fshatit.



Nga kjo, ata më pleqtë, i çpërveshnin buzët dhe i binin më të prerë:

— «E shikoni djalën e Serafimit, — u fliste im gjysh shokëve, — ja shiko se ç'solli nga kurbeti; e dërguan Argjentinë përpara dhe ay solli atë goxha gajdë pa pizgë e me njëzet fletë. Shikoje më qafsh, shikoni Kolën e Savit si e lot atë buzukun me tëtë tela, veç ajo i mbeti nga kurbeti.»

— «Kështu e sollën kohrat, o xha Gjergo — ja ktheu një tjetër — po sa për Todën e Visarit, s'ke ç'më thua se atij gëmetën ja la i ati.»

Unë, si u hodha një copë herë qosh më qosh e odë më odë, ndjeva se më digjnin shputat e këmbëve dhe shkova u struka pranë gjyshit e mbanja vesh fjalët e pleqve. Tundnin kokën më qesëndi e gjithë qërtonin punët e të rinjve ata pleqtë e këndit. U vinte maras që për rridhte uji në të tjera vraga.

— «U prish dynjaja, o xha Gjergo — fliste dikush — tashti po e lënë devolliçen e hedhur çapkënçe dhe vallja na u bë vetë i dytë bark më bark e çup' e djalë:

— «Nem një lule, na një lule  
Cingër mingër, më do, të dua...»

— «Ashtu e më të lumtë goja, — ja kthente im gjysh, — ç'pret tashti zotrote! Djemtë më s'bëjnë kryq as të djelë as të hënë, bota po lidhet me tela e — goftë larg — edhe lëgatën e kanë futur në një kuti që çirret e lebetitet për aman (o zot!»

Dhe ja atëhere u ndje një këngë që tej nga dhomat e miqve:

*Kush i ftoi pleqtë në dasmë,  
Ay goftë i mallkuar.  
Që kur vijnë e gjer kur shkojnë,  
Ato llafet s'i lëshojnë!*

U panë sy ndër sy pleqtë e qeshnë si me pahir. U ngrit im gjysh atëhere dhe u bëri lutje shokërisë:

— «As ngrihi ore vëllezër e t'ja hedhim si qëmoti, se na vënë në furp.»

Dhe vallja u nis me këngë në gojë:

*Ç'kishin pjellë atë nëna,  
Ato nënë ato kokona,  
Qafë-gjat' e kërci-holla,  
Kishin pjell' e bërë drëna!*

E losnin vallen pleqtë ngadale, po me masë, dhe e mbanin zërin për bukuri. Gjyshi hera herës vinte rrotull, unej si levend dhe



dridhte shaminë e bardhë. U shkëput Sekua atëhere dhe ja mbajti vallen gjyshit. Iu bë qefi mal plakut dhe u kapardis me kokën lart. Nuk di sesi po vura re se sytë iu mbushën me lot.

Veç e pira dhe rakija nuk shkon ndër anët tona. Vijnë në qejf njerëzija me gaz të zemrës e me këng' e valle, po sa për do-lli, nuk i ke gjëkund. Pinë dy tri kupa — sa për urim e shëndet — e pastaj e lënë më një anë. Për këtë duan të na tallin ata malsorët e Moravës:

— «E ç'pret prej tyre, — thonë, — këta janë fusharakë, e djegin zjarrë me bajgë...»

Pleqtë tregojnë, se e kanë amanet nga gjysh-stërgjyshët, që mos pihet raki nër dasma se dikur kanë ndodhur vrasje në mes të krushqve e janë vrarë e prerë për logori. Dhe prandaj, shpesh, ata më pleqtë e thonë një fjalë gjysmë me shaka:

— «Amanet e paçi, ore djema, ashtu si e kemi patur edhe ne, por me Hoçishtin dhe Dardhën druhuni krushqisë se ata e pijnë më keq se mokrarët, zjerë dy herë, pa ujë, me opingë e me havanë e hudhravë;»

Të djelën pas dite shkuam të marëm nusen. Gratë këndonin sipas radhës:

*Bëj konak e shtrë shtëpinë  
Moja gjeraqinë*

• • • • •

Kumbarja hera-herës vërviste mbi krushqinë nga një dorë oriz. Një poqace e madhe u thye n'oborr të Naqove mbi kokën e vëllamës. U rrahnë krushqija me tufa borzilogu dhe u lojt valle, gjersa dolli kumbarja me nusen pasdore. Gratë sërish ja nisën këngës me hov e me zell:

*Mirë ja bëmë krushkës  
Q'i morëm të bijën  
Atë më të mirën  
Çupë gjeraqinën!*

Kur u nisëm të këthehemi shkuam nga rruga tjetër për të ndruar udhën sipas zakonit; por fill atje ku merte rrug' e kishës e duhej vajtur për t'i vënë çiftit kurorë, fill atje zu të mahisej puna. Sekua nguli këmbë e nuk desh të vinte kurorë. Gratë filluan të çkulin faqet e të rrihnin pëqinjtë. Gjyshi u egërsua sa i dridheshin dejet e faqeve, e ngrysi ballin e ndroi çeren dhe buza iu prq e iu kaltërye. Pa dolli edhe krushka Leno e ja yuri të thirrurës:



— «Do ta kthej çupën prapë, nuk e martoj e s'e jap në ma-sonët...»

Me fjal'e me të shara arrijtëm ne shtëpija. Sa hymë brenda u duk në krye të dhomës At Dhimitri me takëmet e kurorës. Atje e pa pisk Sekua, se emta Olimbi u bë si e prishur mënc e sa të pinte helmin. Mua më vinte të qeshur me atë Sekon kapadai, që mbante në kokë atë si këmborë ergjëndi e rrinte i mvrejtur sikur i ishin mbytur gjemitë. Kur filloi psalltiri më kujtohen si sot fjalët e tija:

— «Gruaja duhet t'i bindet burrit dhe burri duhet ta dojë gruan.»

Pastaj me zë të ngritur me një psallmë basi dhe si me bujë:

— «O zot, o zot, si bekove Isakun dhe Rebekën, beko edhe shërbëtorin tënd Elisë me shërbëtoren tënde Katerina, jepu shëndet e lumtëri, bashkoi si një trup e shpirt që të shtohen dhe shumëzohen! AMIN!»

Të nesërmen në mëngjez, kur ardhën krushkat me pemë dhe këndonin:

*Si u ngryse, si u gdhive  
Maj bija ime...*

Gratë e shtëpisë këndonin një farë kënge që unë asaj kohe e mernja nëpër gojë pa ja ditur rrënjët:

*Në çardhak, moj nuse,  
Në çardhak digjet qiriri.  
Shkova nënë, shkova,  
Shkova dhe m'u ndez pëqiri.*

*Mor qiri, more qiri,  
Këtë që më bëre ti,  
S'ma ka bërë asnjeri  
S'ma ka bërë asnjeri!!*

Dasma kaloi shpejt, e, se ishte koh'e misrave e pisku i punës, u lëshuan njerëzija nëpër fushë dit'e natë. Gratë tova vinin në nusen e Sekos në ishte e zonja në magje dhe a i vinte ndoresh të qeverisë shtëpinë.

Unë asaj kohe isha velur nga të mirat. Gjithë ditën bridhnja arave e mbushnja ujë nëpër krojet e mezhdave. Nëpër kumbullat me lëng t'ëmbël e ngrinja limerë orë të tëra. Me shokë bënim rendje hipur mbi gomarët, sindozot se kishim dëgjuar që gjetk' e gjetkë bëhen rendje të tilla. Kur ishim më të zellshëm për t'u lëvdur dhe rrahur gjoksin, u mprihnim demave tonë brirët me



thikë dhe i vinim të munden duke u dhënë zemër për të fituar basin.

Por kaluan fluturimthi ata muaj të ëmbël dhe ja, po afrohej Shëmitri. Ishte koha kur iknin burrat në kurbet. Kështu ngjiste mot për mot se toka ishte e pakët e nuk na mbante dot.

Nuk më harrohen kurrë ato ditët e trishtuara të vjeshtës së lagësht e të mvrejtur kur qanin grarija e pëshpëritnin midis tyre:

— «Po afrohet dita, moj motrani, po mbledhet lëmshi e do mbetemi si kërcuret.»

Shajaku ishte sjellë nga dërstilet. Sopotat e qymyrxhinjve ishin kalitur e bërë gati. Pleqve q'u vinte ndoresh puna e nallbanit, i mbathnë kafshët e samarit me potkonj. U bënë stela të reja samarëve, i mbushnë mirë me thekërishte dhe u ndruan kaptejtë e litarët.

Natën e fundit e gdhimë i madh e i vogël. Iknin katër meshkuj nga dera jonë. Sekua midis tyre, e kish kurbetnë e parë. Katerina mundohej të rrinte e qeshur, po vinja rë që psherëtinte dhe sytë i kishte të skuqur.

Asaj nate unë rrinja afër gjyshit se ishin mbledhur atje një sërë pleq nga fisi ynë dhe çanin fjalë e kuvende.

Xha Nastua e hapi fjalën e sikur desh ta vinte në sedër tim gjysh:

— «Si shumë shpejt e nise nipën, o xha Gjergo, gjynah nga zoti ore, një muaj martuar, e linje, ore edhe këtij dimri!

— «Hak ke zotrote, — ja kthente im gjysh, — se Selishta të lëshoi mirë sivjet, por pa më pyet mua që mora vetëm farën? Në hambarin tim bje miu e thyen hundët! Pastaj me masë çdo gjë, ore Nasto, puna punë e nusja nuse; ja iku viti e motin tjetër këtu e ke Sekon, se pastaj na ngjet si atij që tregojnë».

Dhe qeshi gjyshi me të madhe sa iu dukën ata dhëmbët zinxhir q'i kishte si stërrall gjer në pleqëri.

— «A e di, ore Nasto, si i ngjau atij mikut?»

Dhe filloi im gjysh të tregonte historinë e atij dhëndërit të ri që ja hante gjeli qyret.

Unë vërenja tespijet e pleqve dhe mundohesha të nëmëroj kokrat e tyre. Njëri i kish prej qelibari të verdhë, tjetri prej xhami të kuq me xhufkë të zezë, Kola i kish nga bërthamë pjeshke dhe im gjysh të përzjera me guaska ulliri.

Kur fjala e pleqve kish shkuar thell'e më thellë, ja se ku desha edhe unë të hynj pesë para në grosh — si thotë fjala.

— «As na trego, ore gjyshi ynë, për ata djemat që thërrisnin sher! sher! sher!»

Miturakët si mua lojtën vendit duke përpjekur kokat e ndo-



ajëri që ishte me gjumë në sy, fërkoj fytyrën e u gëlltit duk tundur supat:

— «Tregona gjysh, tregona!»

Dhe kur e merrte fjalën gjyshi, na i përkëdhelte faqet e njoma me ato duart e tija t'ashpra — po sa të dashura — dhe nuk di se si, por më dukej se nga goja, bashkë me fjalët i ku llonte mjaltë e sheqer.

— «Qefin nuk jua prish, por të bëhi të urtë dhe të nxini mirë mathimat e dhaskallit. Hajde se do t'ju hamë dasmën një javë. Ja, kështu — që thuani ju çuna — iknin djemërija në kurbetin e parë andej nga Sheheri, hipur mbi këto mushka xanaxare tërë vrull e këngë dhe i pyesnin njerëzija:

— «Për ku kështu bre kapedanë?»

— «Sher! Sher! Sher! — ja kthenin ata tërë sulmë e brohori. Po kur ktheheshin atij Sheheri të lodhur e të drobitur nga ethejt e moçaleve, të zverdhur e me kokën unjur i pyesnin gjith'ata fusharakë:

— «Që nga vini kështu, bre bir kapedanë?»

E ata zvarë-zvarë mezi përgjigjeshin me gjysmë goje:

— «Nga Sheeee-eeri...!»

Qeshnim të kënaqur dhe të llastuar nga sajdiya që na bënte gjyshi dhe na çelej oreksi për përralla e rrëfenja sa përmbysnim shtëpinë gjer fillonte përsëri.

Teto Evgjenija sikur desh të thyente edhe ajo mërzinë e asaj nate të zymtë; filloi të këndonte një këngë kurbeti. Në ishte kënga a në ishte vaj, nuk e shquanja dot, po ku mbaroi fshiu sytë me shaminë e zezë që mbante në kokë.

Vargun e asaj kënge e kujtoj gjithënjë:

*Qofsh e mallkuar, o der' e tim eti .*

*Kur ardh bandilli nga kurbeti,*

*Moj motra, në shtëpi s'më gjeti.*

*I hodha shkallët përmbi avlli,*

*Pashë burrin ku po më rri,*

*Mbledhur pëllëmbët futur në gji,*

*Pinte zeher, pinte raki,*

*Tretur e mbetur si ashkëti.*

Kur u dha ay agim, këndezat dualë nga koteci të lodhur nga kënga e në ballë të shpeshërisë. Silleshin pas mushkave që hanin tagjinë në torbat e kozinta varur në qafë. Unë rrinja në pragu i portës s'oborrit e kafshonja gishtat që mos më roniteshin lotët. Se kur qajnë gratë duke nëmëruar ato dertet e dhëmkat



e kurbetit, në je burrë shko dhe i mbaj dënesat që të të mbytin në grykë.

Yjet e pakët po shuheshin. Brigjet andej nga Morava po laheshin gjith'ë më shumë. Kopet e harabelave u derdhën pas gjerdheve e kopshteve e zhurma e ujrave të remës së mullirit nuk po ndihej më. Oborri nxinte nga gjith ata burra kokë-unjur që rrinin si të mekur e të menduar. Kalamanët u silleshin nëpër këmbët e fërkonin faqet e njoma pas gjunjëve të baballarëve të veshur me shallvare të shajakta.

Tej nga udha e madhe e fshatit, nga ajo lëndina e bukur me atë emrin e shëmtuar — Lëndin'ë Loteve — ndiheshin zilet e mushkave, që zbrisnin duke gërvishtur kalldrëmin me përkonjtë e posambathur.

Unë isha ngritur dhe rrinja pas Sekos. Emta Olimbi ish verdhur si dyllë e të bardhët e kokërdhokëve të syrit i kish marë ngjyrën e qumështit të prerë. Nxori nga gjiri një qese me dizgë mëndafshi të kuq dhe i tregoi Sekos një copë venetik me vërë, të qepur në fund:

— Merre qesen, o shpirt i nënës — i foli Sekos — merre,





o bir, e të më kthehesh shëndoshë, të më bëhesh i mbarë, o bir e përmbi shokët, ruaju të keqen mos pish ujë kur nxehesh ng pëna, të mbulolesh mirë kur të bijesh në gjumë.»

Sekua e mori emtën për qafe dhe e shtërngoi me dashuri. Shtërngonte dhëmbët e rrudhte ballin se dukej që dhëmbja e nënës ja digjte shpirtin. Aty pranë rrinte Katerina e zbehtë e buzëplatur.

— «Motin mos e mbyllish, o bir i nënës — fliste emta gjithënjë — e të vish, o kurban nëna; gjer atëhere do na ketë gëzuar zoti me njënjë djalë... (Katerina unji kokën dhe u bë lulekuqe nga fytyra) Motin mos e mbyllësh, o shpirt i nënës, se m'u zbraz shtëpija, të vish o bir!»

Të gjithëve sa nisin ato rrugët e largëta të kurbetit, kështu u thoshin. Kështu u thanë atyre që kishin ardhur, kështu u kishin thënë atyre që mbushnë njëzet e kusur vjet e s'po vinin, e po kështu u kishin thënë atyre që s'u kthyen kurrë.

Emta Olimbi e kish plagën të hapur që s'ju mbyll kurrë. I ati i Sekos pat mbetur në kurbet dhe nga trupi i tij im gjysh kishte sjellë vetëm nofullat. Më kujtohet ajo historia e lamerisur e gjyshit që, kur e tregonte, më dukej se bashkë me fjalet nxirte edhe shpirtin:

Një mesnate në kurbet, aty në malet e Moresë, në Athos, ishte çarë kamina e madhe e qymyrit. Xhaxhi Tasja — i ati i Sekos — që lëshuar me lopatë të mbulojë flagët e kaminës me kum dhe nuk ishte kthyer më. E pritën asaj nate, e kërkuan të nësërmen, çanë dhenë javën e tërë, por xhaxhin nuk e gjetën më. Pas jave kur hapën kaminën e madhe dhe nxorën qymyrin e zi, gjetën aty vetëm nofullat e xhaxhit, kusurin e kish tretur zjarri. Kishte rënë i mjeri brenda në zjarr, kur mundohej të mbulonte flagët dhe ishte bërë shkumb.

Rëndom kurbetlinj kanë mbetur nga ethet nëpër fushat e Sheherit, ca i hëngri vajtja dhe mundimi i asaj punës së rëndë e pa fitim prej druvari e sharxhiu, të tjerë lanë koskat nëpër pusitë e hajdutëve të malit. Koskat e tyre dergjen sot e kësaj dite pa shenjë e gjurmë nëpër udhëkryqet atje ku varrosen të huajtë. Ja, edhe sot e kësaj dite ka nëna që betohen me dorë në zemër:

— «Për atë që më la koskat aty majë malit!»

Ne pragu i portë Katerina vuri një kusi me ujë. Atë — sipas zakonit — Sekua duhet ta qëllonte lehtë me këmbë sa të derdhej një dorë ujë. Por si duket, atij i kish ardhur shpirti majë hundës. U vërvit dhe i dha një shkelmë kuisisë sa e përmbysi dhe e fluturoi tutje në sokak. Mushkat kërcyen të trembura dhe ne vegjëlija sikur vumë buzën në gaz. Gjyshi u gëlltit



e në çip të syrit u mundua të fshehë një lot që iu rrëkëlye nëpër faqe. Qëlloi me bastun kanatën e portës dhe foli:

— Nisuni!

Muarmë rrugën tatëpjetë. Aty ne «Iëndina e Loteve», n'atë mëngjez tetori ishte mbledhur fshat' i tërë. Unë kisha marë sot-patën e Sekos në krah dhe dëgjonja një breshër fjalë e porosira:

— «I thuaj, të keqen, tim biri — i lutej Sekos Teto Krisa — i thuaj mos lakmojë pas parasë, se më kanë thënë që është tretur e dobësuar.»

Një grua tjetër e hoqi Sekon më nj'anë dhe i foli:

— «Të ma gjesh Kocin, o t'u bëfsha kurban, ku të jetë e ku mos jetë, të ma gjesh dhe t'i thuash të mbledhë paratë pa derman, se gjer Shën Vasilit mbaron pengu i shtëpisë dhe mbe-temi pa strehë.

Dhe gjithë fshati e dinte se Koci ish shkrojtur me kohë në radhën e të humburve në kurbet.

At Dhimitri tërhoqi litarët e kabanave të Shën Gjergjit; gra pleq e burra bënë kryqin dhe karvani u nis.

Dukej si një karvan i përmortshëm»

U përshëndoshëm për të fundit herë në mes të vajtimeve të grave. Mua më morën me radhë xhaxhallarët më puthnë e pastaj më mori Sekua në krahë; më puthi faqet e m'i hoqi lehtë veshët:

— «Të bëhesh i mbarë ti këlysh, do të të dërgoj një pllakë me kondil nga kurbeti, Katerinën ta dëgjosh se i kam lënë fjalë të të ndihë kur të nxësh mësimet.»

Katerina rrinte aty pranë, gëlltitej e psherëtinte e ndofta nuk po dinte si ta përshëndoshë të shoqin. Por ky, i shpejtë e kokëkrisur, s'e bëri të gjatë; e pushtoi ndë krahë, e shtërngoi dhe e puthi me zjarr, pastaj e shkundi pas supi:

— «Bëhu e fortë, mos ki merak, nuk më gjen gjë e keqë mua.»

Dhe iku me vrap prapa karvanit që po zvarrisej tej nga ugaret.

— «Hajde, — folë rëndë rëndë ata më pleqtë — kthehemi. Gratë thyen bisqe shelgjishtash e i bënë tufë-tufë, sipas zakonit, dhe muarëm rrugën e fshatit duke qarë e duke i dhënë zemër njëra tjetrës.

Një tufë djem të shkollës nxuar kokat që tej nga lajthish-tat, andej nga rridhnin ujrat e lumit.

Po mendohesha si i vogël dhe për hesapin tim:

A do të vinte radha të mernja edhe unë atë rrugën e hi-dhur të kurbetit?

Nga përëndimi, rë të zeza katran po mbulonin qiellin.



## BYK E KASHTË NGA FSHATI IM

Dikur ka krisur kopaçja në fshatin tim sa na mbetën gjerdhët pa hunj e pa purteka.

Se ne jemi mjeshtër të drurit. Këtë e di Devolli i tërë. Dhe jo veç për ta bërë drunë drasa e qymyr, por edhe për ta lojtur vëndçe, daç kur rrahim misër në lesë e daç kur është punë për të bërë ndonjë kurriz më të butë se barkun.

Si e qysh na ka ngjarë, pritni se jua tregoj vetë.

Kishte ndodhur asaj kohe të kishim për kryetar në Komunë një farë Sefer, Sefer, e java shtatë ay tetë, linte Komunen, ngjishte lugën për brezi dhe na çatiste në fshat si fandi spathi.

Pa fjalë se për sytë tona nuk vinte, por fshati im — të themi atë që është — ka qënë dhe është rrëngë me çupa të bukura.

Ishte ky Seferi një meso burrë me surratin tërë rrudha, hundë kërc e katarosh me një palë sy të çpërlarë si dy kumbulla jeshile të venitura nga bryma. Sa për kokën e sa për flokët, njeri nuk ja kish parë gjer ditën që ngjau hataja, se Seferi mbante ngjeshur në kokë e gjer mbi ato veshët e mëdha si kllapa, një farë kepelle, që asaj kohe i thoshin «republikë».

E ku kish helme e ku kish gaze, ku zjehej rakija e ku prishej ndonjë bletë, në të tretat e fëmijve a në dasma, Seferi avitej si pa të keq e na shtrohej këmbëkryq.

Në dasmat zinte vendin e parë e mbërthente sytë andej nga ishin vajzat. Ishte beqar dhëmbërënë e mendroitur. Burrat e shihnin vëngër po ay gdhë e kokëmushkë, s'tundej sikur të zbriste nga baxha edhe prefekti me Musa Jukën.

Dale ngadale filloi t'i shtrijë këmbët dhe na e kapi dashurija. I vajti syri ne Afërdita e Tërpos dhe s'kishte burrë që t'i mbante dorën.

Fjala doli nga shtëpia e kryplakut dhe e solli qerthull fshatin e tërë. Se ishte si ishte Seferi, po një sërë xhandarë i kish ndënë urdhër e vula e tij e kish hijen të rëndë. Po Afërdita, le që nuk e qaste as n'oborr, po ishte e fejuar me Kilon e Thanit.

Nga kamja, vërtet, Kilua ishte i pakët, po nga shtati i hedhur e nga puna e krahëve s'mundi t'i gjendej shok.



Dha e mori Seferi duke trembur njerëzinë. Nëna e vajzës nuk e kthente fjalën kursesi. Kilos nuk i trembej syri dhe vetë vajza i kish thënë vlesit se gati e mbante një sopatë të kalitur prapa portës.

Kur e pa Seferi se nuk i shkoji kali mb'urë, hapi tefterin e madh të gjendjes civile dhe i kërkoi për nuse gjithë çupat e fshatit që më shtatëmbëdhjet vjet e lart sipas kanunit e zakonit.

Po edhe kështu nuk i ndezi eshka, me gjithë që i mëshonte masatit rëndë e sa i mundej.

Kur e pa se nuk i doli gjë edhe kështu, erdhi e u ndez e mori flagë, sa damari mavi, që kish në ballë, i kërceu e iu trash sa një gisht. Tashti filloi të na vijë në fshat me një sërë xhandarë pas dhe hapte një farë gjyqi atje ne sheshi i shkollës. Urdhëronte të vinin aty një sërë burra dhe e merte fjalën:

— «Ti, ore, je ay që shkel ligjin e mban çakmak?»

— Jo, zoti kryetar, t'atillë unë as kam parë...

— Leri llafet; juve xhandarë ju them, jepini njëzet shkëpinj prej thane atje në postë.

Pastaj i kthehej tjetrit:

— Po ti pse nuk mban fotografi të madhërisë?

— Derman zoti kryetar, mos më bjer më qafë se këtë javë kam dasmën e djalit...

Po kur dëgjoji Seferi për punë dasme ardh e u nxeh sa thirri si i tërbuar:

— Tashti të nisësh për në post, qen bir qeni, se atje meremi vesh mirë!

Po sado me të keq e me përdhunë edhe kështu Seferi nuk nxori gjë në dritë e nuk iu bë vullja.

Atëherë e ktheu fletën dhe nisi të na marrë hakë me majën e kalemit. Si e qysh e merte hakën njeri nuk e dinte gjer ditën që i doli tymi asaj pune. Ne veç hapëm sytë një ditë vere kur na çatisi në fshat «nënprefekti me të madht e tija». Pas kish një tufë xhandarë; në hejbet varur pas pelës kish tefteret e gjendjes civile dhe bëri emër të mblidhet gjithë fshati ne sheshi i shkollës.

Puni fjala asaj dite, jo kështu e jo ashtu, gjersa u muar vesh ç'kishte ngjarë:

Që ditën që nuk i dhamë nuse Seferit e këtej gjithë gratë e martuara të fshatit na dollën të pamartuara e virgjëresha, burrat beqarë e fëmija që u patën lindur... s'di as unë i mjeri si t'u ve emrin!

Ja këto gjëra na kish bërë Seferi për inat. E, se inati i tija kish qënë i fortë si një arrë gungë, gjithë paratë e pullave që paguanin të martuarit, Seferi ja kish hedhur xhepit.

Ja kjo është hakë e marë trimërisht, as me plumb e as



me zhurmë, po me majën e penës dhe me inatin e kokës.

Mund të më thotë ndonjëri tashti:

— Kushedi sa do jenë trembur ato grat' e fshatit kur morën vesh që ishin të martuara pa ligj e veç me bekimin e uratës.

Po jo, ore jo, as q' u bëri veshi tërr, se si e thotë edhe fjala «Demi mbahet për brirësh e burri për fjalësh!»

E kështu na u martuan njerëzija sërish aty ne sheshi i shkollës. Të pyeturat dhe të shkrojturat i bëri nënprefekti dora vet me një barrë inat. U vinte turp nuseve të përgjigjeshin «e dua në sy të kalamanve po ç't'i bësh inatit të Seferit?»

Edhe prifti i këndoi psallmet atje ne sheshi i shkollës, ve pa zë e pa temjanicë; vetëm rruazat i sillte ndër duar si rodhar. Kështu u vunë firmat dhe u paguan pullat nga një dollar për kokë. E pastaj, doemos gjith ato gaze në një ditë, nuk mund të kalonin pa lagur.

Pa u ngrit dollija dhe u derdh rakija sa edhe vetë urata hoq dhi valle. Veç Seferi nuk u ndodh n'atë gosti. Daç nga turpi daç na frika, po ç'është e drejta nuk ardh.

— Në djall të vejë paraja e gostija, — tha fshati, — me këtë që ngjau do shpëtojmë nga Seferi.

Kështu tha fshati, po ndryshe dolli puna. Seferi as që u turp prej komunes.

Më tej na bëri një punë të padëgjuar:

Ka qënë një natë shkurti në mes të një dimri të rëndë. S' duket kish pirë verë asaj nate Seferi, se ish nxehur e bërë furtunë. Kështu na vjen në fshat në mesnatë dhe e mban frymë drejt në shtëpinë e Afërditës për të cilën akoma i digjej shpirti. Atje ishte vërvitur të hyjë nga dritorja.

Mbante një qen shtëpija e Afërditës që, besa po, çante uj kun e arinë, po ç'e do se, si thashë, ishte muaji shkurt e qeni ish lëshuar tutje edhe ay, furtunë sindozot Seferi!!!

Afërdita flinte me të gjyshen, kur ndëgjoi zhurmë në dritore. Zgjoi plakën e vunë veshin: Dikush mundahej të çaplojë hekurat. Në kllanik varur në çengel llokotitte gjymi përmbush.

E kish rrëmbyer gjymin e nxehtë vajza (gënjeshtër më therrtë) dhe e kish lëshuar lumë nëpër dritore...!

Ma ha mëndja se Seferziut i kish dalë e pira shpejt, se s' rrafshi e kurrizi i qenë përvëlur sa i kishin këreyer fluska të kuqe.

Si kish ikur asaj nate e si ish ndodhur në komune, këtë nuk e di njeri. Por Seferi nuk e hapí gojën se mund të pyeste dikush:

— Ç'kërkon kryetari pas mesnate në dritoren e botës.



Kur kapërxeu detin dhe shkeli Shqipërinë ushtria e Duçes, thamë ne se shpëtuam nga Seferi. Edhe ay vetë u gatit atij Prilli të marrë rrugën e mërgimit, se ja, kufia aty afër është. Pastaj ay zogist i thosh vehtes e jo më kot kish ngrënë gjith ato rroga bashkë me paratë e pullave të monopolit.

E mirë po Seferi e pleqësoi sërish punën me gjak të shtruar. Gjithënjë thosh katrani:

— Gjakun e nxehtë ma pastë kali e xhandari, të ltohtin e mbaj për vehte.

Mendoi Seferi: Ç'më duhet mua të bredh posht e lart Evropit për një copë bukë? Pa rri Sefer urt'e butë, a nuk e kthen gunën nga të fryjë era... Pastaj? Pastaj, si të shohim bëjmë.

Dhe na mbeti Seferi kolionë dhe i patundur aty në komune. Ca marshallë e xhandarë iu shtuan poshtë, po librat e tija askush nuk ja preku. Në fillim ndjehej si më gjemba, po më tej, si veshi këmishën e zezë, i thosh Gramozit, eja të materni.

Dhe sërish u lëshua fshatrave për byrek e petanikë. Po fshatin tim kurrë s'e harroi, se mund të ngriheshim ne e të qabeshim ne nënprefekti se Seferi s'na partill e s'na sajdis!

Atëhere kur Seferi e tregoi sheshit cili ishte, ka qënë koha kur doli fshatrave me xhandarët pas, për të mbledhur lesh për ushtarët e Duçes. Ngado që vajti e kudo që shkoi, fjalët i kish të pakta:

— «Ja lesh për Duçen tonë, ja qep' e kripë për kurrizë tuaj!»

Dhanë e muar njerëzia, me shtërngesë e me të keq, kush dha lesh dele, kush dha lesh dhije, kush... kutë di unë çfarë.

Veç Kilua i Thanit, që sapo ish kthyer nga kurbeti, nuk dha. E jo vetëm që nuk dha, po për punë leshi lëshoi një fjalë me zarar që vajtje Seferit gjer në vesh. Më ta kapën Kilon xhandarët e duke e shtyrë ja shpunë përpara Seferit.

Seferi e dinte që ky ish i fejuari i Afërditës. Pra e gjeti rastin ta marrë Kilon në komune dhe atje t'i punonte qindin.

Hyri në mes urata dhe sikur desh ta ëmbëlsojë punën, por Seferi i donte drutë të shkurtëra. U ngrit me inat dhe i foli:

— «Ja të më sjellësh pesë okë lesh në mbrëmje, ja të ardhja në shtëpi dhe të «sekvestrova» ç'ke e ç'nuku ke.»

Nuk e dinte Seferi se Kilua ish trokë nga kamja. Ay ku ngulte shkopin varte hejbet e veç kur qe puna për tallje ta ngulte thumbin sa një hell dashi.

Doli jashtë Kilua gjoja për të gjetur leshin e unjet i shkruan Seferit një kartë të bardhë me shkronja gushëpëllumbi:

«Derman, ore Sefer trimi, lesh nuk kam as edhe një fije,



për të lutem shumë, kur të më «sekvestrosh» mallin e gjëne  
veç mullirin me dy gurrë mos ma nga se e kam për shpirt...

Pa lexuar gjithë letrën, Seferi qe kthyer shpejt nga krye-  
plaku dhe e kish pyetur:

— Ka mulli ky varfanjaku o Kostë?

Dhe Kostë kryeplaku me gjith frikën, ja buçiti një të q  
shure faqe Seferit, sa iu çaplua goja e iu bë sa një kamare

Kur mori vesh Seferi ku qëndronte thumbi, lëshoi xhanda  
rët qosh më qosh Devollit të kapë Kilon cipëplasur.





Sa për Kilon ky i thirri vrapit asaj Morave ku i dukej më mirë e ku i desh zemra vetë. Edhe Afërditën nuk e la në mëshirë të Seferit, po e dërgoi atje ku i mbushej mëndja.

Më vonë ardhni Seferi në fshat dhe e dogji atë copë kasolle të Kilos.

Si e nisi Seferi do të shkonte thell' e më thellë, se dorën e kish të gjatë dhe inatin e fortë.

Por ngjanë asaj pranvere ca ndodhira q'u çudit i madh e i vogël.

Ishte koha kur çeli gjethi Moravës. Sa herë ngjiteshin fuqsharakët në mal për të prerë dru, hasnin karvane me djema që mbanin në ballë nga një yll të kuq e zhgabë të zezë.

Pushka zu kërciste e bataretë s'kishin të sosur. Italianve s'u zinin këmbët dhe, u mbyllën brenda telave me gjemba.

Pleq të lashtë më mykët, nga ata që kishin njëzet e kusur vjet lënë sopatën, ngjiteshin në Moravë, gjoja për dru, e takonin ata trimat e rinj që u thoshin partizanë.

— «Aman, ore komandar, iu pat lutur një plak i fshatit tim, atij të parit të partizanve, aman, ore po nuk bere fjalë të qërohet ay Seferi se, emri i zotit q'është një, na e ka sjellë shpirtin majë hundës.

Ishte menduar komandanti sa kish peshuar punën e pastaj kish thirrur lisave sa i hante në kokë:

— Dil këteja, o shoku Kilo!!!

Plaku, kur pa Kilon me yll në ballë e pushkë në krah, mbeti i habitur. Komandanti e mori fjalën:

— Nisu Kilo atje në fshatin tënd bashkë me tre shokë, prit atje sa të vijë Seferi. Gjyqin ja bëj në mes të fshatit, kusurë e di ti vetë, veç plumbat i kurse.

Për të kursyer plumbat ish fjalë e kotë, se Kilua, djalë, nip e stërnip druvari është. Dhe, besa po, për punë druri nuk ja ha qeni shkopin.

Asaj dite kur Kilua zbriti në fshat, Seferi vet' i katërtë, ndodhej duke ngrënë drekën në kryeplaku. Nuk ja merte mëndja që ata të malit t'i binin fushës ditën më drekë.

Çudija e papritur u bë kur Kilua me shokë u dha në dera me pushkët peshë.

Ngriu në vend Seferi me shokë e, sado e lyrtë gjella, s'u bëri tatëpjetë e u mbet në grykë. S'u bënë për burra, hodhe armët, ngritën duart e u lutën me lot për faqe.




— «Sillni një kopaçe të shëndoshë — u foli Kilua fshat  
rëve që ishin mbledhur n'oborr».

E mirëpo atje u ndodhë ustallarë të punës kolektive e  
kthyen Kilos zjarr më zjarr:

— «Ç'thua një kopaçe, mor vulëhumbur! Zbriteni bre kë  
afër gjerdheve se kemi afër edhe sërën e druve!»

.....  
— «Fundi i fjalës, Seferi ç'u bë?» — Kështu ke për  
pyetur ti që leçit.

Eh, more vëlla, Seferi e kish mbushur kupën plot sa nu  
nxinte as një fije byku.



Mbaroi, as prej plumbi e as prej zjarri. Shkoi në jetë  
jetëve i kopanisur vëndçe me hunjë e gjerdheve e purtekat  
fasuleve.

Ç'të të them si ish bërë!  
Si i shkuar në dërstilë!



## KUR ISHA I VOGËL...

Mbaj mënd një ditë vere, kur isha i mitur, m'u duk se s'më vinte më fustaneja e isha rritur për të mbajtur pantollona. Nga kjo e tekura ime, si do ta shihni, doli dhe u thur një histori e tërë.

Për punën e fustanes e çora gurmazin nga të oarat, gjersa nëna preu nga tallaganeja e vjetër e babagjyshit një palë pantollona dhe m'i qepi ashtu si i vinte mbarë asaj.

Mëngjez herët dolla jashtë këmbëzbathur e fillova t'u kapardisem vërsnikëve. Por Vani i Teto Savos ma theu. Av u gjeti një cen pantollonave të mija dhe ja dha të qeshurit faqe shokëve:

— «Hy, more, s'ke turp, ti i ke pantollonat me vërë përpara!!!»

Talljet e tija ma cartën gazin dhe zëri i Vanit m'u bë si i një koneie që më çirrej nga pas.

Se më patën mësuar keq, unë u sula vrap e në shtëpi dhe nisa të përpjek këmbët me potere. Më thanë se vrima më ishte e nevojëshme. U munduan të më shtrojnë me fjalë dhe kuvend, por më kot, se mua përkëdheliet më patën bërë sherrët sa s'ka më fei. Më premtuan të më japën thana të kuce e bukë liepurushi, kulloshtër nga lopa e ré dhe një fole prej qyqe... por bosh që bosh, unë drugën time:

— «Ja pantollona pa vrimë përpara, ja rashë e vdiqa!»

Më ranë xhindët vec atëhere kur babaj rrëmoi në një kamare e nxori më dha nja dhjetë mangërë që m'i qoiti «kollonata». Vlerën e tyre të madhe ma vulosi nëna duke më folur vetull-unjur:

— «Mos i nxir nga pragu, bir, se t'i rrëmbejnë shokët, pa kur të rritesh me 'to do blesh një pendë që e një kalë me shalë».



Nëna as q'u besonte atyre që thosh, por gojën ma mbyll  
sa unë harrova vrimën e pantallonave dhe nisa të thur e të gër-  
shetoj ëndëra pas pendës së qeve dhe kalit me shalë.

Më zu veshi se babaj i kishte gjetur këto mangëre bashkë  
me Sefe Çobanë, kur kërkonin një haznë andej nga fusha  
Pilurit mb'anë Moravës. Në vend të haznës u kishte dalë një  
poç balte i vjetër me njëzet mangëre brenda. Kishin ndarë këtë  
më dysh dhe i kishin vënë pëlloçën asaj pune.

«Kollonatat» ishin prej bakëri, disi të rrumbullta dhe të  
shtrembërta, si punuar prej kovaçi.

Çdo ditë ulesha mb'anë vatrës që ndritte si një gur grih  
dhe atje i nëmëronja mangëret dhe kënaqesha së dëgjuari trin-  
gëllimën e tyre. Rinja ashtu gjersa bishtat e urëve më përvë-  
lonin gjunjët me avuj dhe jargë të nxehta dhe pastaj shkronja  
dhe i fshihnja në një zgavrë muri afër kalives së qenit. Ku  
s'kishte njeri afër të më dëgjonte, i flisnja Murros:

— «Kij mëndjen, Murro, se mos m'i vjedhën hajdutët!»

Isha i bindur se Murrua i ruante si jo më mirë, se ishte  
një birko qeni ky që as ujk e as ari s'peshonte; namini e kishte  
marë në fushë e në mal fyt për fyt me egërsirat; por këtë e lëmë  
më nj'anë se ka tjetër sërë.

Një ditë kuxova i nxora jashtë kollonatat dhe ja tregova  
Marko Opingarit. Ishte ky një plak i moçëm që kishte ngrënë  
kurbet të gjatë m'at'anë deteve në Misir. Ditët me diell vinte  
e ngrohej përpara shtëpisë sonë, ndenjtur mbi një tra lisi, ku  
mblidheshin saradan pleqërija e çanin fjalë e kuvende. Marko  
c mbanin për burrë shumë me mënd e më të kënduar se At  
Gjergon që dinte të shkruajë veç trisahitë. Xha Markua, si  
ktheu mbar e prapë, i gjeti të vyera, por jo se janë flori më  
tha, vlejné se janë para të vjetra, antika nga të Aleksandrit të  
Madh, që dikur, mijra vjet më parë, ka luftuar këtej afër nga  
fusha e Pilurit.

Fjalët që më tha plaku i vulosné ato që më pat thënë nëna  
dhe shkova i futa përsëri kollonatat në zgavrën dhe s'i lojta më  
nga vendi.

Nga vendi atëhere s'i lojta, por hataja e kollonatave të mijra  
ardhi pas ca ndodhive që ngjanë asaj kohe.

U hap fjala se iku Zogolli, ardhi Duçja dhe u prish Shqi-  
përia.

Mua s'më hante malli se ikte Zogolli, se fjalë të mira për të



kurrë s'pata dëgjuar. Thanë edhe se Zogolli duke ikur kishte rrëmbyer edhe thesarët e vendit; ato i rrëmbeu vërtet, po kollonatat e mija shëndoshë e mirë m'i ruante Murrua!

Sa për Duçen që kishte ardhur, e mora zët se të gjithë sa ja zinin emrin në gojë e shanin me rrënj' e degë; pastaj ndër né, «kokë Duçe», thërrisnin një dhjetar që e kishte kokën sa një shinik. Dhjetari sillej verës nëpër fshat dhe shpesh na i bënte veshët oputë kur kuxonim i rrëmbenim ndonjë kallëp misri që shkiste nga reznishtat e qerres. Sa për Shqipërinë, po. Më vinte keq që u pat prishur, se më kishte zënë veshi ca fjalë të Marko Opingarit kur kish thënë:

— «Jemi të gjithë Shqipëtarë, edhe ne edhe fshati ynë dhe krahina jonë; fjala Shqipëri rrjedh nga emri i shqiponjës trime që sillet në qiell dhe në majat e maleve!»

Ato që ngjanë me Zogollin Duçen e Shqipërinë nuk i ndjeva në fillim. Gjith ditën e diellit bridhnja me shokët nëpër fshat që nga mulliri në Shënkolli, nga Shënkolli në lëmënjtë e më tej jo, se gjer atje ishin karakollët e frikës sonë.

Por pas mot-moti një ditë pranvere, m'u ngushtuan kufijt e të briedhurit. Atëhere fillova të ndjej dhe të kuptoj se ç'ndodhte. Isha rreth të dymbëdhjetave.

Karvane ushtarësh të huaj, veshur me këmishë të zeza, i mbytën rrugët e fshatit tim. Ne të vegjëlit delnim të trembur n'obor dhe çaplonim sytë me atë hordhi të paparë dhe atë zhurmë të padëgjuar.

Jeta e qetë e fshatit tim m'u duk sikur u prish.

Fillova të shoh gjëra të pandodhura më parë:

Mburrja e fshatit, kopeja e dhenve me ata deshinjtë me këmborë që prinin përpara, nisi të zvogëlohet, fusha e bukës u mbush meistikame, pyllit i vunë sopatën sa shpeshërija u arratisën; në lumin e fshatit, ku shpesh hidhnja grepin e nanurishja ëndërat e fëminisë pas valëve t'ujit, tashti s'mbeti më as peshk e as bretkosë; por çudia më madhe që me zor e kuptova, ishte kur vura re se motra ime e madhe rrinte mbyllur brenda. Gazin tim të mbrëmjeve, kur unjeji dielli prapa Moravës, tashti s'po e ndjenja më... se ndër ato mbrëmjet e zakonëshme të fshatit tim kisha një dëshirë të shpirtit: Vinja te kroj i Shënmarisë e rinja aty kur vinin vajzat varg e varg me llërat përveshur, me shtambat ndër duar e gazin në sy e në buzë... E, se kisha një vlla çapkën gati për martesë, kush e kush të më jepte agulçe e manushaqe...



Fashti, kroj i Shënmarisë me postaf të thyer e me shëlgjet për rreth pa degë, nxinte nga kazanet e ushtarëve të huaj.

Më vinte pështirë t'i shoh në sy ata të huaj cipëplatur që shkretuan jetën e qetë të fshatit tim.

Veç fytyrën e një oficeri mjekërosh s'kam për ta harruar kurrë!

Ay ishte burrë i pashëm dhe me sy të kaltër, por nga shpirti katran e hajdut me çizma pat qënë. Herën e parë, ma zu syri një mëngjez të djele n'oborrin e kishës. Rrobat i ndritnin nga ca vija si t'arta q'i silleshin rreth mëngëve dhe qafores; ndër duar mbante një si xham, një si pasqyrë të rrumbullaktë dhe me bisht. Kishte hipur shkallët pas mureve të kishës dhe me xhamin këqyrte ca gurë të shkrojtur ndënë kambanoren. Një nga djemat e fshatit po tregonte atje se mjekëroshi, të djeshmen, fshinte me furçe gurët nënë mezhnikët e arave, pastaj matte kodrat për rreth atje ku ngulte një hù, vinte ushtarët të rrëmojnë dhenë. Kish takuar të gjenin një shigjetë të vjetër që mjekëroshi e kishte rrëmbyer sikur t'ishte e artë.





Më tej mjekëroshi shkante portë më portë, si prifti me kusinë, dhe kërkonte antika të vjetra. Në shtëpinë e Mihollinjve kishte parë një pllakë mermeri, ku qe skalitur një fytyrë njeriu. Pllakën e kishte gjetur në dhë, vjete të shkuara e reja e Mihos kur hapte një pus. Djali i Mihos s'kishte dashur t'ja jepte pllakën mjekëroshit, por ky, me revole në kokë, i qe kërcënuar:

— «Ç'gjen mbi dhe janë tëndet, ç'gjen ndënë dhë i takojnë shtetit, sille këtu se të pret e zeza...»

U duk sheshit dhe e mori vesh fshati tërë se mjekëroshi Italian mbliidhte e kërkonte me qiri antika të vjetra. Dhe ja një ditë djalli e solli mjekëroshin ne porta e jonë; ishte bashkë me Sefe Çobanë. Kur i pashë te porta. m'u bë sikur më kafshoi gjarpëri; zura të kruanja hundën me kurizin e dorës se djeva të keq. Babaj u ndodh brenda e shpejt dolli këmbëzbathur, u ktheu ngjatjetën me gjysmë zëri dhe i pa si me frikë. Sefe Çobani e mori fjalën dhe i foli babajt për kollonatat e mija. i shkeli edhe syrin duke i dhënë të kuptojë se lot paraja... Unë, kokëunjur e me frikë në zemër, u pështeta pas kalives së Murros që po lehte me të madhe; më dridhej trupi si prej ethesh dhe kafshonja gishtat me dhëmbë. Vura ré se babaj hyri brenda sa të mbathte opinat, kur mua diç m'u shkrep në kokë! Mjekëroshi po priste i gëzuar të delte babaj dhe fërkonte duart besëplot se do t'i shtinte në dorë kollonatat e mija për të cilat i kish folur Sefe Çobani.

Nuk e bëra të gjatë. i dhashë një të shtyrë kllapës që mbante derën e kalives dhe Murrua u derdh përjashta duke ulëritur si i tërbuar...

— «Kapi bre, Murroooo!»

Dhe vetë i thirra vrapit përjashta sa thembrat e këmbëve më arinin te lugu i qafës prapa.

Ç'u bë atje, pas ditësh e mora vesh. Murrua i qe vërvitur mjekëroshit, e kishte përfshirë nga tulet, ja kish ndukur dhe çarë rrobat sa ky s'qe bërë për burrë, po vetëm bërtiste për ndihmë nëpër oborr. Ishte sulur babaj, pastaj, dhe me zor kishte mbledhur qenë. Mjekëroshi ishte bërë për faqe të zezë, buza i qe zbardhur dhe i rridhnin ujë pantallonat!!

Vrapin e asaj dite unë e mbajta në Gembër, një fshat nja një vrap pele larg, te der' e nënës, tek gjyshja.

Si më kërkuan tri ditë me radhë, babaj e mori vesh ku isha dhe ardhni një ndajnate herë. Ishte gjithë hundë e buzë. Më vuri nërpara e m'u kërcënuar, po unë, ama, rrinja pas kurizit të gjyshes dhe sytë herë nga dera e herë nga dritorja. U shtriva për-



para babajt dhe u bëra si i prishur mënj veç atëhere kur ay tregoi se «trimërinë» time Murrua e kishte paguar me kokë: shadhet e këmishëzinjve e kishin vrarë ditën më drekë. M'u frytë nga vaji sa ndjeva në gojë shijën e athët të lotëve, qartë sa më mbytën dënesat.

Babaj i tregoi gjyshes se e kishin sjellë posht e lart në një komanda dhe e kishin trembur dhe kërcënuar gjersa kishte dalë një oficer i thinjur dhe kishte thirrur me inat:

— Kalamandin s'e ze ligji!

Pas darke, babaj ardhi në të mirat. Desh të më kandiste më të mirë:

— «Po pse, bre bir, bëhesh kokëshkretë, bindu, bre, kur flet babaj, daç eja vetë, daç tregomë mua ku i ke ato djall man gëre; mjekëroshi ta fal fajin; për ato të shkreta mangëre në lë





gim do bjerë që m'i rrëntë rrufeja prapa veshit; më thirri në çadëren e spitalit dhe m'i tha këto.

Kur ay është tuaf dhe na jep para të bardha për mangëre të zeza, ti pse nuk e do të mirën e shtëpisë?».

Kështu më kumtoj babaj, por unë gdhë e kokë-mushkë:

— Jo që jo. Kollonatat e mija i njohu Marko Opingari që janë antika të vyera; kur të rritem, me 'to do të ble pendë që e kalë me shalë!

Babaj shkoi të nesërmen e unë mbeta në Gembër në derë të nënës. Bukën me djersë e hanja se kullotnja kecat. Veç më bren-te dyshimi se mos m'i gjente njeri kollonatat.

Por ditët shkonin dhe fjala e keqe nuk vinte.

Kaluan nia dy muaj. Një ditë vjeshte, ardhë në livadhet e Gembrit një kushëriri im të më takojë. E pashë nga larg tek afrohej kokëulur dhe i vrerosur. Ndjeva se kishin fluturuar kollonatat e mija. Por jo me aq. Hataja kishte qënë e rëndë.

Hakmarrja e mjekëroshit ishte e egër. Av io më kot e kish-te lodhur mëndjen gjithë kohën që mbante tulet me dorë.

Kishin kontrolluar shtëpinë se gjoia strehonim partizanë. Kishin përmbysur dhe bërë lesh e li kthina e mure, qilarë e kaliven e qenit, gjersa gjetën mangëret e mija.

M'u rronitën lotet në hijen e një kullumbrije.

Por tashti e ndjenja vehten më të rritur, lotët nuk më shkonin më.

E ngrita ballin lart. Gjaku më kishte hipur në kokë dhe, si prej vetiu, dhëmbë e grushte i ndjeva të shtërnguar.



## PUSIA ANËS LUMIT

Asaj mbrëmjeje doli një urdhër në mes të pyllit që të gati-  
ten për udhë nja dhjetë partizanë nga ata që ndjehen më të çlo-  
dhur.

Por rrinja me shokun tim Tefikun nënë hijen e një ahu kur  
ky këceu përjetë:

— Këtu më ke shoku komandant! Dyfegun e kam të vajo-  
sur, opingat shtërnguar, këmbët rrufe, syrin pishë, sherrit t'ar-  
mikut i them lepe, brezin e mbanj zvarrë...

Qeshnë shokët me Tefikun dhe e panë ashtu si vështrojnë  
një mëz t'azdisur.

Kur u gatitme për udhë, Komandanti na hoqi më nj'anë e  
na foli kështu:

— «Dalip Beu i Sulinjve e kaloi kufinë dhe po e shton zullu-  
min, ka marrë armë nga italianët e ka bërë emër të zhdukë parti-  
zanët. Si duket atij ju mbarua vaji i kandiles. Ne kemi fjalë nga  
njerëzit tonë se beu nesër kthehet nga pazari në kullën e tij.  
Prandaj Hamdiu do t'ju heqë rrugë dhe do t'ju flasë më gjatë  
Tashti nisuni e presim kokën e Dalip Beut me gjithë dyfeknë.»

\*\*\*

Muarëm rrugën Moravës tatëpjetë. Në livadhet e Sulit na  
zuri nata. Duke ecur n'errësirë, në njësh kollonë, dëgjonja pas  
meje partizanin plak Dilkon tek bisëdonte ngadalë me vehten e  
tij:

— «Eh, në më shpëtofish gjallë kësaj radhe o gërxfhua i ku-  
llës, vallahi kam për të ta falur gjith sa më ke bërë!»

Unë mendonja Dalip Bejnë, që vinim të pastrojmë, dhe mun-  
dohesha me hamëndje t'afroj ndodhitë e nesërme. Prej kohe më  
kish zënë veshi ca tevatore për atë bej gjakësor që e kish shkuar  
gjithë jetën me vrasje e grabitje. Më fanitej ajo fytyra e tij me  
një palë sy të vegjël me qerpikë gjak të kuq dhe balli i tij i  
mvrejtur e vrarëlije. Vrasjen e katër fëmijve në Gjonomadh



e kish bërë Dalip Beu si hakmarrje për një të sharë. Kulla e tij e mbushur me rësk të rrëmbyer ditën më drekë ngrihej larg fshatrave e në mes të pyllit si shtrofta e fshehur e një hajduti të prallave. Edhe gruan e kish të vjedhur Dalip Beu, të rrëmbyer tinëz dhe të sjellë lidhur pas bishtit të pelës. Gjer asaj dite s'kish dalë njeri i gjallë t'i mbante dorën. Qeveri e prefekta ja njihnin hijen e rëndë dhe kur kishte gaze e synete i dërgonin shëndete e mushtullukë.

Vonë asaj nate kur po ngrihej Afërdita, iu afruam vendit ku do zinin pusinë.

Ishte koha e lëmenjve dhe ecnim nëpër sternishtat e thata t'arave. Aty këtu nëpër ugaret flinin kopetë e dheneve. Shihnim nën zjareve itytrat e çobenjve të rrahura nga flagët, tek thërrisinin me të madhe që mos qasej «gojëlidhuri». (1) Tutje, thellë Moravës regëtinin ca gulshe të kuq flagësh; ishin zjarret në kaminat e qymyrxhinjve përmbi Grapsh. E gjithë fusha flinte përgjumshëm dhe n'atë qetësinë e thellë që vinte pas lodhjes së ditës, ngriheshin filmat e pafund të brumbujve të natës.

Më tej, xha Dilkua më foli:

— Eja pas meje o këlysh i pagoditur, eja të them, se me tët atë kemi ngrënë një barrë kripë.

Ja bëra qefin Dilkos edhe se fjala e tij më ndilte për ato shakatë me kripë që na tregonte kur ishim të ngeshëm. I fola.

— Po pse, o Dilko, a nuk pati ndonjë djalë në vend tënd po ardhe ti plak njeri?

— E po kështu e do puna, more bir, me atë bejnë unë kam ca hesape të vjetra për të larë...

Kur iu afruam Kuçit, Tefiku nxitoi të mbajë qentë mos lehin. Me ata Murrot me nam të kopeve të Kuçit, Tefiku kish miqësi të vjetra që atëhere kur i mbante nër krahë dhe i nxitte pas egërsirës. Kaluam nëpër Kuç me Tefikun përpara q'u dha nga një shëndet gjithë Balove e Murrove që nxirnin hundët pas gjerdheve dhe ndënë pragjet e portave. Kaluam vreshtat e Kuçit dhe dollëm anës Devollit që ushëtinte rrëmbyer duke shkarë mbi zallishtat. U unjëm grumbull pas një ugari dhe dëgjuam fjalën e Hamdiut:

— «Do qëndrojmë në një pusi gjithë ditën diku anës së lumit gjer të kalojë Dalip Beu duke kthyer nga qyteti».

Po prisnim të çelte agimi kur Hamdiu me xha Dilkon po kërkonin një vend të fshehur për pusinë. Një kukuvajkë klithi n'errësirë. Ish shenja se vendi ish gjendur. U përgjegjëm me

1) gojëhidhuri = ujku.



një zë grifshe dhe u afruar. Hymë në një si orman midis ca dris-  
zash e ferrash të dendura buzë lumit. Atje u unjëm pa bërë  
zhurmë.

Nga prapa, herë-herë, ndjehej një si kërsëllitje, sikur ndonjë  
kollos i fshehur n'errësirë kërciste gishtat. Më hipi kureshta po  
Dilkua më shpjegoi se kërcasin imonikët e arrirë në një bostan  
aty pranë.



Kur u hap dita vura re ku ishim. Ato që na u dukën si dri-  
za, nuk ishin të tilla. Ishin rakita të gjata me fletë të vogla si  
t'ullirit dhe me kërcellin mbuluar me një pluhur të murmë; sapo  
të preknje rakitën pluhuri davaritej dhe mbetej kërcelli bisk i  
bukur në ngjyrë t'uthullit.



Më mëngjezin, në patekat aty frötull filluan të vozitin bujqërit që kthenin ujrat për vaditje. Udhë që vinte nga qyteti kalonte bash m'at'anë lumit dhe ne drejt aty i mbanim armët. Pak më vonë zbritnë në lumë kopetë e rosave me rosakët përpara; notonin e silleshin nëpër ujrat dhe hera-herës çlodheshin ndejtur me një këmbë diku anës lumit. Më thellë fushës afër një mulliri shquante nga sërët e tullave një qeramithanë; më tëhu dukeshin cordolecë ngritur majë furkave për të trembur galat. Një erë e rëndë squfuri na goditte nuhatjen; por Dilkua na shpjegoi se aty afër burojnë ca ujra me shkumbë që shërojnë përdhesin.

Me gishtat ndër këmbëzat i gëzoheshim fushës që zjente nga puna. Një bujk i ri në një ugar m'at'anë lumit na bëri borçli me një zë bilbili, e ngrinte këngën duke lëruar:

*Ngjijnje të përpjetën pcsi pul'e fjetur:  
Na more më qafë, gështenj e papjekur!  
Ke dal në parmakët e më ri pështetur,  
Na këpute shpirtin me këtë të qeshur!*

Si u ngrit dielli nja dy hostenë, vajtje ardhjet u prenë dhe ne ndejtëm më shtruar. Kryeja dhe fundi i rrugës dukeshin nga larg e sido që t'ishte puna, kishim kohë të mernim shenjë. Më i paduruar ndihej xha Dilkua. E dëgjonja që lutej ngadalë:

— O zot, lermë ta mar hakën me dorën time!

Po ç'hakë desh të merte xha Dilkua që lutej faqe shokëve?

Ja solla fjalën rreth e rreth gjersa ay e hapi gojën:

— «Kam qënë unë, ore, një jetë të tërë yzmeqar ne beu; një jetë yzmeqar e dhjetë vjet në hapsanë për kokën e atij qen beu...»

Flisnim ngadale dhe fytyrat i kishim aq pranë sa shihnja vehten time në bebet e syve të xha Dilkos. Qime të bardha dhe t'ashpra i klepsitëshin nëpër rrudhat e faqeve dhe më ngjiste Dilkua si ajo fytyra prej martiri e Shënkollit të verbër. Fjala nuk po merte fill, kur Hamdiu ju kthye Dilkos:

— «Me që e nise, o xha Dilko, mer mundimin jua bëj me-xhitet kacidhe këtyre djemve se ky birkua që ri me kalem ne dorë, të këtilla historira pret».

Si bëri ca naze jo dua jo s'dua. xha Dilkua e mori sërish fjalën:



— Në bukën e hidhur të beut kam hyrë që kur isha dhjetë vjeç e nuk dinja dynjanë. Dalip Beu asaj kohe ja i kish ja s'kish të pesëmbëdhjetat. E, se ish prej oxhaku e i rritur me pekule, ç'i thosh mëndja i bënte dora. I ati nuk ja prishte po ja nxitte trimëritë dhe Dalip bejçja ku rënça mos u vrafsha, zullum pas zullumi. Në kumar ish i pari, në të pirë dollibash, në sherr djall me brirë. Ku s'e mbillaje aty e korinje. Për punën e një zagari një ditë bëri sherr mes pazarit me të birë e kajmekamit të Kosturit; iu duk hunda dyfek dhe ja lëshoi tjetri me karadake barkut. Tyrgëliu s'pati kohë të bënë as gëk e a mëk. E përfshinë zaptijet bejçen dhe e plas në brenda. Kajmekami edhe ay s'e hante thatë. Do t'ja tundte këmbët mes pazarit por i ati i bejçes përmbysi dynjanë e tërë me miq e me tarafë. Vajti edhe gjer në Stamboll në sulltani dhe i tregoi fermandë e bejllëkut të madh sa një rogoz. Kështu e shpëtoi të birë nga vdekje dhe ja prenë me burg për jetë. Më tej kajmekamin e hodhi në Anadoll dhe Suli beu u vu të nxjerë të birë nga burgu. Paga ryshfete gjersa i thanë të lëshojnë të birë me konditë që të gjejë një bedel të hajë burgun. Më morën mua, or buk'e djathë skllav, yzmeqar dhe jetim si isha, pa më thënë e pa më pyetur dhe më s'punë drejt në burgun e Manastirit. Kur mora vesë ku isha nisa të qaj e të thërres me të madhe, po kush ma vinte veshin! Paratë e beut asi kohe e kthenin ujët përperjetë. Kryemuj vinte beu e më sillte të ngrëna dy palë hejbe plot. Ish dorë shuar, se kish frikë mos vdisnja, e i duhej të gjente bedel tjetër. Desha s'desha rrethi prej hekuri m'u vu kokës. Veç një ditë kur ardhni Suli Beu, kuxova dhe i fola:

— O Bej, të mar dor' e këmbë, po ç'taksirat un' i mjeri, ç'faqaskam bërë që më mbylltë këtu? Më djeg në shpirt, o bej edhe për gurët e fshatit edhe për varrin e nënës!

— Hajde hajde, leri llafet — m'u përgjegj beu — burgu për burrat është.

Tretesha në vaj dhe qanja me dënosa, po njeri nuk çante kokën për mua. Trokitnja në një portë që nuk hapej. Dhe kam ndenjtur në hapsanë, ore djema, dhjetë vjet plot e përplot gjersa u bë yrjeti. Atëhere më lëshuan. Çere-vrarë dhe i brengosur, i mplakur pa u rritur, u ktheva në Devoll. Suli beu kish vdekur. Dalipi ish bërë goxha burrë; kamjen e kish shtuar, kullën bërë minare, priste të trasha dhe fjala nuk i bëhej dy as në fshat as në qytet. Kur më pa, më rrahu supin dhe, që të nesërmen,



më dha punë. Pas një muaji u sëmura rëndë. Më hipi një ethe e fshehtë dhe një kollë e thatë. Hoxha dhe xherahu nuk më vunë shpëtim; isha sëmurur nga dergja. Vate dhe puna ime, mendova. Kisha ndër mend të martohesha asaj kohe, por ja, po më qasej vdekja. Mirë e thonë një fjalë: kur nis fukaraja të lozë valle, çahet daullja.

Po, si më shihni, nga vdekja shpëtova. Këtë ja kam borxh bashçobanit të beut (shpirti i ndrittë atje ku ka rënë). Ishte shpirt njeriu. Ay më mori në mal e më mbante në mes të stanit, gjoja me punë. Unë atje hanja e pinja e merësja veç me qentë. Gjithë ditën bridhnja pllajave për lulushtrydhe, për lajthi, kërpudha. Dimrit bashçobani më merte në vërrin. Shkonim asaj kohe në fushë të Prevezës. Atje m'u gjend edhe ilaçi i dergjes. Bashçobani trette guaskat e vezëve në lëng limoni dhe ma jepte e pinja atë lëng me okë e me varele. E mbanja pas ilaçin në një bucelë aqe sa dikur, ma patën ngjitur «Dilko Bucela».

U ndje një fëshfërimë që prapa drizave. Hamdiu bëri she një të vështrojmë kush afrohet. Këceva unë me Tefikun. U zvarosëm këmb' e duar dhe pamë një kurbat të gjatë këmbëzbathur që po priste rakita me një kosor. Më këtej po hynte një kurbatkë me një çelikan në dorë. Dukej si e bija. Flokët i kish të pakrehura por ish e bukur dhe me fytyrë të paqme. U krus pas rrënjëve të rakitës dhe, nëpër linjën e çlirët të gjoksit, ju dukën një palë gjinjë si shegë. Nuk u folëm dhe po ktheheshim në shokët duke u zvarosur, kur Tefiku më hoqi pas këmbe. Ktheva kokën nga ay. Me shënja më tregonte diçka që nuk e kuptonja. Kur iu afrova, vura re, se kishte gjetur një furik me vezë rosash. Mushmë xhepat dhe kapellat me vezë dhe u avitme në shokët. Nëmëruam nja gjashtëdhjetë vezë.

Vapa po shtërngonte dhe ishte zagushi. Era nuk lëviste dhe, tej në fushë, ajri dridhej si n'ethe. Ujrat e Devollit na tërhiqnin, por s'mund të lëviznim. M'at'anë lumit nga po tretnim vështrimin nuk dukej njeri; një këriç i njcmë po turfullonte në misëroren afër mullirit. Dilkua e mbante vështrimin mbërthyer nga udha e syt i lodheshin sa i rridhnin pika lot. Dukej se beu do nisej nga qyteti pas dite kur të thyente vapa.

Xha Dilkua sikur desh të vazhdonte fjalën.

— Hajde hajde, mjaft u përtype, zgjidhe gjuhën, Dilko!

Kështu i foli Hamdiu dhe e shpoi me bryll n'ijet. Plaku u gëlltë një herë, fshiu me shami sytë lodhur dhe e mori fjalën:



— «Çfarë të nis e çfarë të lë, ku ta nis e ku ta mbaroj. Në kohë të Frëngut Dalip Beu mblidhte njerëzinë angari dhe i degdiste në Guri i Kamjes të hapin istikame. Pastaj si u rrëkëllye kohrat, u bë njësh me komandarët e prefektat. Shtronin zija fete në kullët, sa rakia derdhej lumë. Unë u sillnja deshinj ngkopeja dhe u gatitnja mezetë. Po më vonë aty nga seneja njëzë e katër Dalip beu i vari hundët. Dolli fjala atëhere se u ngrit në Tiranë një qeveri që desh të mirën e fukarasë. I pari i asaj qeverije na paskëshe qënë një dhespot me shkollë të madhe dhe armik i bejlerve. Dhe si vërtet, na ardhi në qytet një nënprefekt i ri e patriot i mirë. Ky mblodhi popullin ditën e pazarit dhe mbajti fjalë. U ndodha asaj dite në pazar dhe e dëgjova Qeveritari i ri i ra fjalës më të prerë dhe e lëshoi sihariqin:

— «Qeveria e Nolit, tha ay, do t'u marrë tokat bejlerve dhe do t'ja ndajë fukarasë...»

Mua se si më ardhi pas zemre ajo fjalë e ja buçita me të madhe e sa më hante në kokët atje në mes të popullit:

«Rroftë, e goftë qeverija e re!»

Fjalët e nënprefektit të ri, si duket, i ranë rëndë Dalip beu. Nuk e zgjati shumë dhe ra e vrau nënprefektin mu në mes të pazarit; pastaj i dha vrapit e dolli kaçak.

Kur u ktheva mbrëmanet në kullë i gjeta portat mbyllur. Një sejmën faqezi mu kanos që tej nga shkallët:

— «Haram të goftë buka, qen bir qeni, ik tashti të të jap bukë ajo qeveria e re...!»

Gjashtë muaj ndenji kaçak Dalip beu. Pastaj Zogu u kthye me ndihmën e Sërbëve dhe doemos beu sërish filloi të kapardiset. Tashti nderet iu rritën edhe më. Veshi edhe rrobe zabi e mbante në brez një revole me emrin e Zogut në dorëzë. Dhe sa kohë ish Zogu në fuqi, beu ish qeni i tij i besës.

Unë asaj kohe isha lopar i fshatit. Gjith druanja ta gjej bejrin në rrugë. Po desh djalli dhe e hasa një ditë. Më pa vëngër dhe më hodhi një dhëmb:

— «E mo Dilko, ç'thotë ajo qeveria e ré?»

Shkova pështymën e nuk iu përgjigja, po ay e kish lëshuar brezë zvarë. Sërish më foli:

— «Jo, për zotin jo, nuk e lëmë hesapin palarë!»

Atëhere i fola:

— Lermë rehat në hallet e mia, o bej, a nuk janë mjaft dhjetë vjet burg që hëngra për ty?



— Burgun e hëngre si bej zotrote; jo, për zotin jo, nuk e lëmë hesapin palarë...

Që asaj dite i lashë lopët e fshatit dhe nisa të bënj qymyr për kovaçët tutje në pyll. Këtë e bëra vetëm që mos takonja bejnë.

Kur pllakosi Italia më tridhjet e nëntë u nis edhe Dalip beu të luftojë armikun në Durrës. Iku në krye të vullnetarëve duke rrahur gjoksin.

U vonua mjaft asaj kohe e thamë se do ta ketë bërë sheshin breg më ndonjë anë. Po, jo ore, jo, ku humbet paraja kallp! Në krye të majit u kthye beu kapadaji. Këmishën e kish bërë të zezë prej atij santenit që veshin qivurët. Ca grada e nishane kish varur gjoksit e krahëve; nga kapella e zezë i varej një xhufkë e gjatë si pepellashkë e furrës...»

— «Mjaft tashti! — foli Hamdiu vetullunjur — po afron mbrëmja.»

Dhe vërtet, rrezet e diellit po na rrihnin prapa e mezi arrinin ndër ne, nëpër tufat e rakitave.

Fusha gjith po zbrazej e bujqërit po ktheheshin me pendët përpara. Një trokëllimë e thatë ndjehej nga vidhat e Kuçit, ku dukej se punonte ndonjë pikth. Mulliri kundrejt pushoi së blojturi e nga gryka e pendës së penguar, ujrat vërshonin me potere me curila t'argjënta.

Pak kohë kaloi kur Hamdiu pa me dylbi një kalorës që po afrohej këtej. Ne, që ishim më djem, çquamë me sy një kalë çil të lëshuar në pikë të vrapit. Pastaj Hamdiu tha se është Dalip beu e Dilkua ja vulosi fjalën. Zemra zu na punonte me forcë.

Ishte beu dora vetë. Kalin e kish mës të ri me pajvanë këmbëve për të mësuar revan. Shaluar rrinte beu me dy palë gjerdhanë q'i feksin gjoksit, pushkën e mbante në dorën e djathtë të pështetur në shalën e kalit. Muarmë shenjë dhe prisnim urdhërin e zjarrit. Xha Dilkua puthi kondakun e manxërit dhe vura ré që kish shtërnguar nofullat dhe vështrimin humbur në shënjestrën.

Kur u afrua beu m'at'anë lumit, i ramë njësh e përnjëherë! Kali i tij u ngrit kas përpjetë më këmbët e prapme, u lëkund i goditur dhe u përplas më hundëzaj bri rrugës. Beu sikur fluturoi nga shala dhe zuri vend. Nuk ish goditur. U shtri në hendek, shau me të madhe si për të marë zemër dhe shtiri në shenjë.



Plumbi i tij na mori mbi kokë me një «fësht» pa fishkëllimë. Papandehur një gërritje mitrolozi u dha që nga kodrat përtej Shtinin italianët në drejtim tonë ku po kërciste pushka. Mbajtëm frymën, u gëlltitëm dhe ndjemë të keq se na iku nga dora. Koha nuk priste dhe atje pashë atë që s'e prisnja. Foli xha Dilkua i nxituar:

— Po na iku, ore djema, vate Devolli i tërë, në hell do të shkojë fëmijët ky xhelati i kullës... në iu avitshi ju, do t'ju hajë se jini djem të papjekur, sido që të ngjasë unë e kam kullotur livadhin, veç ma bëni hallall, mbajani zjarrë batare se do t'i vete gjer mbi kokë!»

Një të thënë e një të bërë. Ne lëshuam plumbat batare dhe xha Dilkua iu vërvit beut sipër.



Këto ngjanë shpejt e shpejt ashtu si këputen pikat e ujë nga gusha e sulinarit. Beu e njohu xha Dilkon se lëshoi ca të shara dhe e vuri në shenjë... ne s'e linim të nxjerë kokën dhe ja mbanim zjarrë hapur. Tashti i ndante vetëm ledhi. Xha Dil-



kua i vërviti një granatë hendekut sa ledhi lojti vendit dhe pluhuri u ngrit lart si ndonjë mullare prej tymi. Kur po çaplonim sytë nga hendeku, pa pritur u dha xha Dilkua në mes të lumit me dy manxërë krahut.

Bataretë e italianve po shtoheshin e galinat (1) lëshonin pluhur nga goditjet e plumbave.

Kapërxyem rrezikun ne vahu i Kuçit kur kthyem një bryl të rrugës dhe ramë në një përrua. Xha Dilkua e kish parë bejnë me zorrët jashtë. Pastaj vështruam pushkën e Dalip beut; ishte një belxhike e re pa rryp, ashtu si i mbanin hajdutët qëmoti.

\*\*\*

Mbrëmja po binte dhe Hamdiu na hoqi në Baban në shtëpinë e tij. I ati bluante në mulli dhe na pritën gratë. Fjala u hap shpejt dhe u mbloodh atje fshati i tërë. Na uronin e përshëndoshnin sikur kishim vrarë Ballaban Pashën.

Dhe se motra e Hamdiut e kish magjen të mbarë, kemi ngrënë atje një petanik me pulë që kemi lëpirë gishtat.

Veç na ardhi rëndë për harxhet e petanikut, po ec dhe e mbanje atë nënën e Hamdiut që desh të therë dashin me këmborë.

Disi u lehtësuam kur nxorëm dhe u dhamë vezët që gjetëm në furikun atje ne pusia anës lumit. Por vonë natën, kur ishim në rrugë, vumë ré se vezët, të zjera dhe me kamatë na i kishin futur nëpër çantat e shpinës.

1) galinë = plis pa bar, copë tokë, galinat e arave.



## M I H A L I

«... Gjer atëhere partizanë sheshit nuk kisha parë. Kjo ngjante se ndër ne, aty majë Çukës përmbi fshat, italianët ishin fshehur thellë ndënë dhe me armë e me topa e të mbrojtur nga sipër me çimento dhe hekur.

Isha rreth të shtatave atëhere e ma merte mëndja se partizanët me këmishëzinjtë ishin hasmë në gjak dhe, për këtë, mirmëngjezin dhe mirndajnatën e kishin midis tyre në majë të dyfegut. Me gjithë këto, partizanët vinin edhe në shtëpinë tonë, por une nuk mund t'i shihnja se akoma nuk kisha dalë nga tefteri i ferishteve. Se si thotë fjala, «i vogli t'i nxjer lakrat në pazar». Por «me që muret kanë veshë» unë e dinja se partizanë kishte ndër ne, e për këtë unë vinja vërdallë nëpër shtëpi, — rinja vetullunjur, i heshtur sikur desha të them: «Unë e di e nuk tregoj.

Një ditë, nëna me teton po gatuanin dy lakrorë.

— Mirë, u thashë unë, se njëri është për ne, po i dyti?

— Do t'ja shpijem babajt nd'arë, — nxitoi e tha nëna.

— Po qetë kullosin në fushë e nuk lërojnë... e babaj po bënte roje... he he lerini ato, e kini për partizanët!

Fjalën s'e kisha mbaruar, kur nëna ma zuri gojën me pëllëmbë.

— Ç'janë këto llafe, mor i zi? — dhe u vështruan sy ndër sy me teton Rinën që dridhte petët. Kur e panë se nuk fshihej hosteni në thes, më lëshuan pé.

— «Mos, kurban nëna, mos të keqen tetua, ç'janë këto fjalë, mos kështu se djalli atë punë ka e na djegin shtëpinë italianët dhe babanë e varin në litar.

— E di unë, e di, — dhe zemra m'u bë mal që nuk fshiheshin nga unë. Ashtu kryelartër dhe i gëzuar shkova nga ura, hodha gripin në lumë të zinja ndonjë peshk qor.

Pas dreke më të këthyer vapa po rrinja në dritoren e çardhakut e mëndjen e kisha nga zërat që delnin nga oda e miqve... kur dikush më ardi nga prapa, e sa të hapësh e të mbyllësh sytë, më mori peshë e më shpuri në odën e miqve.

Atje çaplova sytë: Ay që më mori ishte një partizan i ri. Të rinj ishin edhe katër të tjerët. Më vajtën sytë në pushkët e reja



që kishin varur në mur aty ndënë kornizën ku dukej Skëndërbeu hipur në kalë me shpatën ngritur. Pra, këta ishin ata partizanët që ua kisha dëgjuar zërin dhe punën se, ditë të shkuara kisha parë kur «parakalonin» nëpër fshat, për në Çukë vargje me karabinjerë pa armë, pa pantallona, me nallone në këmbë e duke qarë i paraqiteshin kolonelit. Po edhe puna e hambarëve të bej-dhjetarve që ja ndanë fukarasë nuk ishte e pakët.

Në odë më pritën me fjalë të mira e me gaz, por unë u mblo-dha shuk e u bëra sa një lajthi se më vinte turp. Në fillim e mbanja kokën unjur dhe gishtat në gojë, por me fjalë e me orë e shtruum sa, gjer në mbrëmje, u hapa si vaji n'arma.

Ay që më mori brenda e kishte emrin Mihal. Duhet të ishte nja njëzet e katër vjeç; flokët i kish të zeza, nga fytyra ish ezmer, jo shumë i rritur, por ish i shkathët e sytë i kish të mprehtë sikur i lëshonin xixa.

— Cilët do ti — më pyeti Mihal — italianët apo ne?

— Italianët andej nga plehrrat i dua, unë atyre ua çkula tërë bishtat e kuajve dhe i bëra kom për leqë...

Si e hapëm muhabetin mirë, mbrëmë herë ardhi nëna në odë, ndezi kandilen në konizmat dhe m'u karos me dorë duke buzëqeshur. Dësh të më merte jashtë por unë nuk tundesha vendit. Edhe partizanët iu lutën të më linte. Me të rënë nata hëngrëm darkën bashkë; nëna solli një tepsi trahan bërë përshesh me misërnike dhe lugë druri.

Pas darke oda u mbush me burra, gra, djem e vajza nga fshati. Unë u shtriva në prehër të Mihalit, si maçoku në diell, dhe dëgjova e dëgjova gjëra që pak i kuptonja. Pastaj më pat marrë gjumi. Kur u ngrita në mëngjez partizanët kishin ikur.

Q'ato ditë unë me shokë e ashpërsuam punën me patrullat e italianëve që silleshin nëpër fshat. U viheshim pas dhe që prapa gjerdheve u thërrisnim:

— Hidhe xhufkën prapa, se të zuri vapa.

Nuk vonoi dhe një ditë shtatori, italianët, që strukeshin aty majë Çukës, u ngrysën dhe nuk u gdhinë. I pari i tyre kishte hedhur armët dhe u kish thirrur ushtarëve të këtheheshin në itali.

Por tatëpjetë Devollit lufta ishte ndezur këtu e tri ditë. Luftonin partizanët kundër ballistëve dhe gjermanëve. Mbrëmjeve më të mugëtirë dukeshin flagët e pushkëve dhe luginat e Moravës sillnin krizmat e batareve. Italia ish përmbysur, por vendin e saj e kishin zënë gjermanët.

Një ditë më vonë, tre kamionë me ngjyrë të murme po i afroheshin fshatit tim. U dha alarmi. Njerëzia filluan të fshihen në pyll, kur dikush thirri se janë partizanët.



E mbanj mënd mirë se ishim një çetë pionerësh dhe u ngjitëm nëpër drurët afër shkollës për të pritur partizanët që vini me automobila. Si duket ja kishin zënë gjermanit.

Kur hynë kamionat në fshat, ne me gjuhën tonë prej kalamanësh, me gëzim e me të thirrura, duke tundur degët e kumbullave, sikur u binim këmbanave, i pritëm partizanët. Gjithë fshati ish mbledhur atje si në një festë të rrallë. Tashti po i shihnj partizanët sheshit. Po çaplonja sytë të shihnja Mihalin tim, po në gjith atë turmë s'po e njihnja dot. Një partizan i ri pa mustaqe, veshur si oficer gjermani, rrinte mbi kabinën e një kamioni. Unë atij ja ngula sytë e disi u turbullova, por ay zbriti i qeshur futi duart në një çantë gjermane që mbante në krah dhe na vërviti disa grushta lajthi e rushka. Ne e përshëndetëm këtë dhuratë me thirrje e brohori. Kërcejem nga degët poshtë dhe e ndam dhuratën ashtu si e ndajnë kalamanët. . .

Por mua nuk më harrohej Mihali. Qoftë larg, mos kish pësuar gjë? Me zemër të ngrirë iu afrova atij partizanit që na hodh lajthitë:

— O shoku partizan, ku është Mihali?

— Ku e njeh Kcmisarin ti?

— E njoh, e njoh. . .

— Është i plagosur, po me gjith' atë ardhi, shiko pyet nëpër fshat.

U nisa. Pyet këtu e pyet atje, ja shpura gjurmën tek Teto Rina. Atje ishte vërtet. Gjer ne dera vajta nxituar, po atje mbeta. Si do t'ishte Mihali vallë? Tërë gjak, i lidhur me pëlhura të bardha, ndofta edhe sytë i kish të lidhur e nuk do më shihte. Po sikur të më shihte e mos më njihte fare? Ngadalë e shtyra derën, ashtu si bën macja, dhe zgjata kokën brenda si i trembur. Më ardhi çudi! Mihali vërtet ishte në krevat, mbuluar me kuvertë gjer në mes, po trupin e kish të ngritur përgjysëm e bisedonte shtruar me teto Rinën. Kur krisën mendshet e derës, Mihali më pa:

— O. . ., shoku Todi. . . ku je mor kapedan? Pa eja këtu!

Vajta. I zgjata dorën Mihalit si i madh duke mbajtur kokën më n'anjë si i vogël; por ay më mori në grykë e atëhere unë s'e bëra të gjatë dhe e përfshiva për qafe me të dy duart.

Pasi ndejta, Mihali m'i mbushi xhepat me lajthi e rushka sikur kthehej nga kurbeti. Vura re se Mihali ishte plagosur në këmbë. Q'atë ditë dhe sa ndeji aty u bëmë shokë të ngushtë. Mbrëmjeve merrnja abetaren, futnja ndënë sjetull një copë bukë dhe e mbanja vrapin ne Teto Rina. Mihali më ndihte të nxëmësimet dhe më qortonte gabimet që bënja kur shkruanja në pllakë. Atë vit ndiqnja klasën e parë në shkollën që hapën parti-





zanët. Mihali ishte djalë fshati, por dukej që kishte shkollë të madhe.

Vinin dendur në Mihali për të shikuar partizanë të ngjeshur me armë e të qeshur nga fytyra. Unë strukështa në një qoshe se nuk i njihja. Por Mihali nuk më linte pas dore: — Ja ky — dhe e ngrinte zërin — ky është shoku i im i vjetër dhe i pandarë, është partizan, ka yll të kuq në ballë, ka edhe revole (unë në brez e mbanja një kabure dërrase) po di edhe të këndojë... pa thirrja një herë, o Todi!

Unë bëhesha kaftan i kuq, kruanja me thonj «revolen» e futnja mjekrën në fund të gushës se këngët i shisnja shtrenjt faje gjith atyre që më ngulnin sytë dhe goja nuk më hapej. Atëherë partizanët bashkoheshin kundra Mihalit:

— Ama, shok paske, o shoku Komisar, po ky qënka memec, ky nuk di asgjë...

— S'di po, ashtu thoni ju? S'di s'di...  
— E po hë de, kur di ku i ke?

Kështu ca nga sedra, ca nga që më vinte më të djathtë, e frynja gurmazin sa dejet e qafës më kërcenin të mavijosur e ja thërrisnja sa më hante në kokët:



*Shqipja jonë mori malet  
Theu zinxhirat përsëri*

.....

Po mua ec e më mbanje pastaj, se ishte zor sa më hapej oreksi e shtegu... Në fund më mernin përpara e më përkëdhelnin me dashuri. Unë u kërkonja kallamidhe e kapsollë të djegur e puna gjith më shkonte mbarë se kamaren ku dikur mbanja llastikën, tashti e kisha «modernizuar» me plaçkë lufte të zëna në fushat e luftës e që fillonin që nga thupra, palcore, qyta e lloza të thyer e gjer në kaska gjermani, që nëna i përdorte si kusi kur zjenim ligaveçë.

Më tutje Mihali zu m'i kthente vizitat; kucër-kucër e çalë-çalë vinte ndër ne. Puna e parë unë i viheshja të më tregojë si i mundi gjermanët, si u plagos ose të më këndonte; por ay e hidhte fjalën posht e lart me mua dhe kuvendonte me të shtëpisë që ndodheshin aty. Kur unë e shtonja zullumin dhe nuk pushonja ay më hidhte shakara, që m'i thosh ngadalë në vesh:

— Hë, more ti, i ke akoma pantallonat me vërkë përpara!  
Atëhere më zinte ngushtë dhe unë pushonja.

Po më kish mbetur merak të dinja si ngjau që u plagos Mihali, si u kthye nga lufta me automobil dhe mbushur torbat me lajthi e rrushka.

Një ditë, bashkë me shokë të tjerë, ardhni në fshat, ay partizani i ri që na kish dhënë lajthi e që ish veshur si oficer gjerman. E pyeta se e kisha shok të njohur; kishim shkëmbyer fjalë që ditën e parë. Dhe ay nuk ma prishi e më tregoi:

Ishin përpjekur në luftë me gjermanët brenda në Bilisht. Mihali me shokë ishin sulur t'i kapin të gjallë por armiku kish luftuar qenërisht. Pas ndonjë ore Mihali kish sulmuar sërish. Pas e kishin ndjekur dy partizanë nga fshati i tij. Sulmi kish shkuar mbarë dhe gjermanët kishin filluar të tërhiqen. Mihali luftonte më këmbë. Shokët i thërrisnin të unej por ay kokë-shkëmb e shok vehten. Pastaj një plumb gjerman e kish goditur në kofshën e djathtë. Mihali nuk kish dashur të largohej nga fusha e luftës por këmba i ishte mpirë dhe nuk mund t'ecte më. N'atë luftë partizanët kishin djegur shumë kamiona të gjermanit dhe tre i kishin marë me vehte. Këta tre kamiona na kishin qënë të ngarkuar me rrushka e lajthi.

Vinja ja tregonja këto Mihalit në bazën e tij dhe ai më shih-te me sy të qeshur. Por unë tashti ja çkulnja xhakëtën për fundi dhe e lutnja të më këndojë. Kur ngulnja këmbë ay nuk ma prish-te. Merrte kitarën dhe loste një këngë të shpejtë që më tërhiqte sa e mbanja frymën. Në fund i shkreppte gjithë telat një herësh



— E, të pëlqeu? Ç'do tashti?

— Tashti, tashti merrja një herë me kitarë dhe me gërmaz. Atëhere Mihali thërriste disa partizanë që punonin me makinë shkrimi dhe me radio në shtëpinë kundrejt, vinin edhe ata të Komandës së Vendit dhe ca fshatarë devollinj e mjeshtër të këngës. Sipas zakonit teto Rina nxirte rakinë. Po, si kalonte kupa një herë rrotull, Mihali i fliste:

«— Hiqe teto atë të shkretë shishe, jemi në luftë e si e thotë fjala, rakia marton dhespotin. . .»

Partizanët qeshnin me zemër. Qeshte si më dysh edhe Serveti veç molla e Adamit i punonte si sovajkë dhe me sy e ndiqte shishen gjer në dollap.

Niste Mihali e ma hidhte mua «sa për të hapur zërin» një palo këngë, që unë e quanja timen.

*«Shkova unë i gjori nëpër llucët  
Isha djal' i vçgël më mbetën këpucët»*

E si gjëmonin zërat, ja ngrinte Serveti dhe e priste Mihali:

*Tridhjet' e nëntë mos ardhësh kurrë  
Që na rrëzove flamurë*

Unë mbështetnja kurrizin në derëzat e hambarit (gjer atje më harrinin shpatullat atëhere) dëgjonja këngën dhe mundohesha t'i vjedh vargun. Por më shumë më ngulej në kokë ajo thirrja si me vajtim në fund të vargut; Oji, oji, oji, oji!

Këngën e kuptonja; vajtonte flamurë dhe thërriste rininë që të hidhej në luftë e ta ngrinin përsëri.

Pastaj shkonja e shihnja flamurë në ballkonin e Komandës së Vendit, Kuq e Zi që përkundej dallgë-dallgë, hije-rëndë dhe i përflakur me shqipen e zezë në mes, i madh sa një qilim me katër fletë.

Një ditë kur po nëmëronja «armët», Mihali m'u afrua:

«— Ç'djall i do gjithë këto vjetërsira? Hidhi tutje!»

— Pse, do mos rritem unë a? . . . do mos bëhem Komisar? dhe i mbledh që tashti që të bëj luftë pastaj. . .

— Jo, jo, kurrë mos ardhhtë ajo ditë e mallkuar!

Fytyrën ja mbuloi një hije mallëngjimi. Tashti më shihte tne-llë e me qërtim.

— Jo, mor pioner, nuk duam më luftë, ne duam t'i zhdukim ata që nuk ngopen me gjak. Kur të rritesh ti do marësh penën dhe librat të bëhesh njeri i ditur, prandaj luftojmë ne, që luftë të mos ketë më.



Më mbulonte një farë mallëngjimi që zbriste mbi mua nga sytë dhe vështrimi i tij dhe ulja kokën si fajtor.

Mihali më rrinte afër, më rrihte lehtë supin dhe mendohe të më shihte në sy. Pastaj më fliste për të ardhmen e ndritur që do ngrihej mbi gjakun e partizanve.

Dielli i ngritur lart, hidhte nga të çarat e çatisë me ploçq gulshe drite që rrezatonin gjer në kamaren e murit.

Në një agim të kthjellët kur plaga i qe mbyllur, Mihali u nis për në Batalion. Shumë ishim ne që dcllëm ta përcjellëm. Ay mori me gaz të përpjetën e Lisnikëve i shpejtë si shkjarth armatosur gjer më dhëmbë.

Afërdita po ndritte afër kubes së qiellit e ne prisnim të hapë dita, të lindte Dielli.





## TETO LIMIADHA

Aty nga pranvera e dyzet e dysë, delnja kodrave të fshatit e vështronja fushat për rreth: ca karvane të huaj, të gjelbër si zhabjaku dhe të armatosur rëndë, zvarroseshin me turp dhe përtesë për nga lindja. Kaptuan Moravë e Gramoz dhe me frikë e droje i afroreshin Kosturit ku edhe ndjehej lufta. Nga radhët e gjata t'ushtarve, — për kundër zakonit të tyre — nuk delte as zë e as këngë. Dukej një ushtëri e mërziur dhe e raskapitur, e kalbur me vjete ndër llogore ku i qe ngrënë shpirti e fryrë koka nga mërzi-tja e vuajtja.

Në një nga këto ditë (mbaj mend ish e dielë) më dërgoi im gjysh në kishë të ndez një qiri në vend të tij se atij nuk i punonte as dora e as këmba.

Kur iu afrova Shëngjergjit, dëgjova zërin bas të At Dhimitrit që psallte me të madhe:

— «Për lëmë të mbarë, rrafshërim të pemëve të dheut dhe për kohra paqe, le t'i lutemi zotit!»

Për lëmë të mbarë lutej urata se hambarët ishin zbrazur. Edhe për paqe e ngrinte lutjen prifti i gjorë; por paqja kish marë tatëpjetën dhe nuk dukej të mbahej gjëkundi!

Kur iu avita portës së madhe të kishës, më goditi era e qirinjve të djegur dhe e temjanit, në atë çast më ardhi si vështirë të hynja brenda dhe m'u shkrep të kthehem prapë.

Fusha po i shtrohet pranverës, mendova, topi po kërcet posht e përpjetë, në ka gjë për të parë po kat sot... a s'u bije kryq e tërthori arave?

Kështu bëra dhe u nisa tatëpjetë.

Kur dielli u ngrit më lart, aty këtu filluan të ngrihen nëpër fushë drejt qiellit ca si pupla të bardha në formë rrodhe me fije t'imta që dalin nga një farë bime. Ish shenjë se vesa ish terur dhe dielli filloi të përsëllojë.



Atëhere ktheva kryet pas patekave të fushës. Udha e madhe zjente nga karvanet e italianve të mërzhitur. Marshonin për nga lindja, ndënë vështrimin e fshatarve që shihnin me urrejtje.

Në rrugicat e ngushta pas mezhdave me manaferra kalonin si me frikë ca karvane të tjerë. Ishin gra, fëmijë e pleq të mykës, që flisnin një gjuhë të huaj. Po bëheshin javë të tëra që këta karvanë të mjeruarish po shtoheshin gjith' e më shumë. Ishin grekët e uritur, që i huaji mündohej t'i vdesë më uri. Shpesh herë i pata vështruar në këto ditë: shumica ishin gra me fëmijë në krah dhe aty këtu i ndiqte nga pas ndonjë plak i krusur. Me torba e thasë ndër duar rendnin fshat më fshat e portë më portë duke kërkuar lëmoshë një copë bukë. Kur mernin rrugën e kthimit nuk më kish zënë syri të kishte ndonjë grua të pangarkuar. Por ja, të nesërmen karvane të tjerë, më t'uritur e më të shumtë, kalonin përsëri vijat e vjetra të kufirit dhe hynin thellë Toskërisë e gjer në det. I mbante shpresa, por edhe këtej lufta kish bërë të sajën, fshatrat ishin prishur, grabitur e përvëlur nga ushtarët e Duçes. Por me gjith këto, vendësit i ndihmuan fqinjët me aqë sa u mundej.

Ndër këto ditë pranvere, kur lufta zjente në Ballkanë e tërë, na ardhë në fshat gjithë burrat e mbetur në kurbet posht e lart Moresë. E jo vetëm burrat e punës, por edhe far' e fise ikur e martuar prej kohe m'at'anë kufirit, tashti u kthyen në vendlindje.

Sa e sa herë në këto ditë m'u pat kujtuar Teto Limiadha. Se, që ta dini edhe ju, kisha një Teto Limiadhë të humbur asaj Moreje, që as unë e as babaj nuk e kishim parë ndonjë herë. Puna e saj i kish rrënjët të thella dhe unë e dinja veç nga goja e gjyshit që ma tregonte punën e Teto Limiadhës kur unë ngulnja këmbë e kërkonja përrallë sa të më avitej gjumi.

— «Kur isha djal' i ri — tregonte Gjyshi — kisha një motër fill të vetme me emrin Limiadhë. Nëna e mbante me pekule se ishte femër e vetme në një sërë vëllezër. E sado të rritur me kujdese, kur ardhni dita, Limiadha na e bëri njollën dhe turpin më të madh: iku një natë nga shtëpia dhe u martua me një grek nga Kosturi, që sillej fshatrave duke shitur ikona. Ne e mallkuam se nuk na arrinte dora t'i presim kokën... dhe që atëhere s'ja dimë as fillin e as tragën...»

— «Po pse e mallkuat, o gjysh?

— Po e mallkuam, o bir, se iku pa pyetur!

— Po po ta kapnit do t'ja prisnit kokën?



— Do t'ja prisnim se na turpëroi.

— Po në ardhhtë ndonjë herë do t'ja presësh kokën?

— ...Tashti edhe nuk ja pres, po një dru do t'i heq.

Unë trapitnja pas Teto Limiadhës që e rrihte gjyshi dhe dëgjonja edhe shpjegime të tjera, por me gjumë në sy se koka më rëndohej dhe goja më hapej sa një kamare.

Ja në këto ditë më kujtohej më fort Teto Limiadha; se një ndjenjë e çuditëshme — ndofta e lidhur me rrethanat e kohës — më thosh se do ngjallet Teto Limiadha ose ndonjë nga njerëzit e saj. E ndofta prandaj në ato ditë lufte, delnja fushës nga vinin grekët e uritur dhe i shihnja në sy gjithë gratë dhe plakat e huaja.

Asaj dite, kur isha ndejtur atje pas kodrës, mbi lumë, hija ime ishte veç dy pllaze e gjatë e unë s'kisha ndërmend të këthehesha në fshat.

Tutje nga Kosturi lufta kërciste gjithënjë. Dëgjoheshin motorat që ulërinin si të tërbuar, zhgarkoheshin bomba nga qjelli e dukej sikur toka andej kish marë zjarr.

Zbrita nga kodra e rashë t'i pres udhën një karvani që u duk tutje nga ugaret.

Koha ish gjithënjë e kthjellët, fusha gjith po ndizej nga ngjyra e bimëve e me gjith këto, një trishtim pushtonte fushat an' e mb'anë. Krizmat e topave dhe era e rëndë e barutit ndiheshin nga çdo anë. Njëpër disa zabele njiheshin ledhe llogoresh e atje kundërmonte era e rëndë e ushtarve të vdekur, që egërsirat e natës nuk i linin në paqe.

Ku ish gjendur ay qiell i kulluar, ajo fushë e stolitur që qëndisej or' e çast dhe pastaj ajo skëterrë lufte që po mbytte botën an' e mb'anë!

Duke zbritur tatëpjetë hasa Tefon e Coles që po lëronte poshtë kodrinës. I kish vidhosur damalugut një çallesh përpara se hapte lëndinë. Toka çapej me disa kërsëllima të buta kur këpureshin rrënjët e barit e plisat, që shtriheshin si jastëkë e fshihnin si me droje faqen e gjelbër pas patozit të lagështë. Marimagat remdnin njëpër plisat duke lëshuar fije të holla: ish shenja se toka kish vlagë e priste farën.

Kur dolla mb'udhë karvani i huaj edhe s'kishte mbrijtur. Ata ecnin ngadalë, të lodhur e të drobitur, sikur sillnin pas urinë dhe vajtjen. M'u desh të bëj më tutje e shkova i hasa në një tumbë lisash që ngrihej në mes të fushës. Ndjeva të mbërthyera mbi mua qindra sy hetonjës që më vështronin miqësisht sikur ndillnin



mëshirën. Sy, gjith të zinj, të venitur, sy grash të lodhura me fytyra të tretura me ato hundët e hequra e të rrepta q'u zbrisnin drejt nga balli. Në krahë e në shpinë mbanin fëmijë të nemitur nga frika e nga uria, syzinj edhe ata e flokë-pisë, me fytyra të buta, të bardha.

U përgjigja për sa më pyetën ashtu si dinja e si munda, ca me dorë e ca me gojë. Flisnin për urinë si për një famë të shëmtuar që po u rrëmbente ditë për ditë jetën e foshnjave.

— «Pina, qe mono pina!» (1)

Këto fjalë i përsëritnin gjithënjë, me ngulmë dhe me trishtim si për të nxjerrë kuptimin e tyre më të thellë e më të hidhur. Këtë fjalë të nëmur e mbajnë mënd edhe sot e kësaj dite ndër anët tona.

Veç më ardhni disi e papritur kur dëgjova fëmijët që flisnin lirisht gjuhën e tyre!

M'u duk sikur më sëmboi në zemër, kur dëgjova zërat e mekura të fëmijëve, që kërkonin bukë, e nënë gjorat bënin sikur nuk dëgjonin e druanin t'i shihnin në sy.

U tregova rrugën e fshatit se ashtu më binte të bëj dhe u nisën duke më uruar.

Unë fillova të sillem pas mezhdave, kur më zu syri njerëz të tjerë që kishin marrë rrugën e fshatit dhe po vinin tëhu. Dallova një plakë hipur mbi një kalë dhe tri vajza që i vinin pas. Në kalë dukej e ngarkuar edhe një makinë për të qepur.

Do jenë grekë, më tha mëndja, që vinë të fitojnë bukën me punë. Dhe ashtu ishin vërtet!

Kur m'u afruan disa çape diçka folën në gjuhën e tyre. Më shkau syri pas vajzave se ishin të bukura.

Plaka dukej shumë e shkuar nga moshja, por e mbajtur mirë. Dhe plaka më foli me një shqipe të thyer:

— More, biro, pa hajde këtu!

Vajta.

A nuk më thua, a rron Nasja i Dones në këtë fshat?

— Rron moj rron, si lis i fortë është, po ku e njeh ti Nasen e Dones?

Kështu ju përgjigja unë, por mëndja më punoi shpejt si i ri që isha:

— O bobo, kjo do të jetë Teto Limiadha!

Kur ngrita sytë balli më kish marrë zjarr. Plaka po qante du-

1) Pina qe mono pina = uri dhe vetëm uri.



ke zbritur kalin. Dhe ashtu si po rrinja i shastisur në mes të rru-  
gës, ajo m'i këndoi sytë (gjallë si të gjyshit i kam) pastaj më push-  
toi dhe më puthi se fisi e gjaku nuk bëhen ujë.

Edhe unë u ngashëreva dhe lotët m'u ronitën palë palë. Dhe  
sa çudi! Ato vajzat e reja i kisha kushërira.



\* \* \*

Na janë mbledhur miq atëhere nga ishin e nga s'ishin, e ke-  
mi bërë gaz sikur martohej Teto Limiadhë. Por më tej bëmë das-  
më të vërtetë se të tri vajzat u martuan në fshat e aty janë sot  
e kësaj dite.

Sa për Teto Limiadhën ajo vdiq asaj vjeshte kur filluan shirat  
e Tetorit.

«Prindi nuk i dha uratë, njeri nuk i këndoi:

*Ku fute këmbët  
Më të rënçin dhëmbët...,*

pa dheu i huaj nuk e mbante brenda.»

Kështu e shpjegoi im gjysh vdekjen e saj në tokën ku lindi...»



## NDËNË SHELGJET NË MULLIRI

Atë mullirin e madh të fshatit tim, nuk kam për ta harruar sa të më mbijë lëndina mbi krye. Bota ime, që ku u përmënda dhe sa u rrita, ishte shtëpia ku lindi dhe ay mulliri i madh. Kishim një oborr e na ndante një vijë uji.

Më thonë se mulliri mbahet mirë sot e kësaj dite e më dërgon të fala e shëndete. Q'është i fortë dhe i patundur e besoj pa u betuar njeri: Themelet i ka të thella sa një hosten, muret të trashë një çap malësori, gurët qoshë prej mademi e qenësteja q'ë mbulon sipër, është e listë dhe e dendur sa nuk do t'ja dijë as nga barra e plloçave e as nga rrufeja e qiellit!

Si më thonë, mulliri bluan e punon gjithënjë e më radhë (si në mulli) me gërr gërr gërr e vuu vuu vuu, po ashtu si më mbantezë mua kur nxora piskamën e parë.

Mullirin e kam njohur që kur m'u hapën sytë, por pahun e miellit që grinin gurët e tij e kam thithur bashkë me sisën e nënës që më jepte gjy aty ndënë shelgjet anës ujrave. Këngët e djepit i kam dëgjuar ujem me këngët e mullirit dhe në çdo agim zgjohesha nga çak-çuku i Kolë Mullisit që kalitte gurët... Në sërish më rrëmbente gjumi gjersa pëllisnin gomarët e lidhur sërë aty te porta e mullirit, ku ngriheshin stivat e thasëve me bereqet.

Aty rrotull mullirit kam qeshur e kam qarë. Aty jam rritur e hedhur valle foshnjërie... dhe gjith aty për herë të parë kam puthur një vajzë! Dhe sot, kur kujtoj ato kohë dhe ato derte, më rrotiten lotët palë palë! Herë lotë gazi e herë lotë vreri, herë veg e veç e herë të përzjerë si shi me diell.

Mbaj mënd, një herë në vit, ditën e Shëmitrit, mblidhej aty para mullirit fshati i tërë dhe merrte sikush pjesën e tij. Se gjysma e mullirit ish e fshatit, e ngritur me djersën e ballit dhe paratë e kurbetit. Atje Kolë Mullisi jepte basapet «grarisht» me gishtat e njëjës dorë (dorën tjetër e mbante në zemër). Si thashë, gjysma e mullirit ish e fshatit, po gjysma tjetër ish e beut të Kuçit, as punuar, as para derdhur beu, po me që mulliri ish ngritur nënë hijen e tij i takonte gjysma, se kështu ishte e drejta e kohës.



Po një ndryshim ka ndodhur vjetët e fundit: ditën mulliri bluan e bën miell e këрма (1) dhe natën, në vënd të gurëve, vërtit ca rrota e makina që i japin dritë fshati. Kjo është punë e të rinjve, — si të rinj që janë — kanë dalë tashu në krye të fshatit, kanë marë timonë dhe bëjnë përpara.

Veç një psherëtimë e nxjer fshati kur kalon aty përpara dhe kujton Kolë Mullisin. Se Kola ka qënë ay që ngriti namin e mullirit tonë: ish mokër dhe Kola, në krye të fshatit, e bëri të madh e hijerëndë me dy gurë e një dërstilë. Kur flasin pleqtë për punë të lashta, thonë vetullunjur se atje te mokra e zunë të prerat nënën e Kolës kur solli në jetë mullisin tonë. E si rojti shtatëdhjet e ca vjet, Kolë Mullisi, ose Kolë Kryqi, si e thërresin gratë, dha shpirt atje në mes të mullirit, i vranë me plumb dhe i prerë në besë.

Kolë Kryqi, ashtu si e mbaj mënd unë, ish një plak i gjatë e kockëfortë, i veshur dimër e verë me shallvare shajaku, mbante një xhamadan me xhep të gjërë tej e ndanët e, kur ngisnin cikmat e forta të shkurtit, vishte edhe një koxhuf prej lëkure dashi. Fytyrën e kish të kuqe, sytë të vegjël dhe të qetë, vetullat e dendura, tërë qime të trasha. Gjithë ditën punonte dhe i vinte rrotull mullirit me ato duart e mëdha si panxa. Ish i fortë sa i hidhte killën në pot me gishtin e njëres dorë. Sa vinte n'udhë mullinë, delte te sheshi para portës me sqepar në dorë dhe i shtrohej punës. Se ndërtonte zgjedha e parmenda, vitellë e kuptore, latuarë e sops e rrallë herë, me prrosi të një dambeli të mërzitur që rronte në fshat, i bënte një farë luge të gjatë e me kokriza për të krojtur kurrizë.

Ja edhe sot e kësaj dite më bëhet sikur e kam përpara atë mullirin me Kolën te porta, ku dukej i mbërthyer një potkua i madh.

Një tumbë plepa e shelgje ushëtonin me të madhe dimër e verë aty rrotull mullirit. N'atë pyll drurësh zjente beharit një mizëri shpeshërie si t'ishin zgjoje bletësh kur rritin. Strebët e mullirit sikur qeshnin të mbushura rrëngë me çerdhe dallëndyshesh. N'epër bisqet e degëve, në fole prej bari, rronin si fqinjë të mirë harabela e gushëkuqë, garguj e piktha. Edhe një shtërk i madh e qafëgjatë ngrinte folenë me gjemba kullumbrie mbi oxhakun e vjetër të mullirit. Se Kola kish një dashuri të thellë për shpeshët. Kur delte pas jazit për të mbledhur ujrat e haste harabelat duke pirë ujë, qëndronte në vend e unjte kokën i përmbledhur si në kishë kur dëgjonte ungjillë. Rrinte ashtu gjersa shpeshët largoheshin vetë.

1) këрма = miell' i trashë i urovit dhe burxhakut që përdoret për ushqimin e kafshëve.



Ndënë plepat, atje ku derdhen ujrat e pendës, rridhte lumi i madh i fshatit, që zbriste tatëpjetë duke dremitur në shtratin e tij mbuluar nga hijet e shelgjeve. Në ditët e verës kur shtërngonte vapa e largoheshin rosat, binte qetësija. Atëhere kërcenin peshqit mbi faqen e ujrave e thithnin atë ruhun e miellit që zbriste dallgë-dallgë nga porta e madhe e mullirit.

Shpeshët pushonin të çkujdesur në foletë; veç pikthat me ato si freska të vogla e të kuqe në kokë qëllonin me sqep trungjet e bardhë. Ndonjë vajzë çapkëne me llërë përveshur lidhte legët tyra thekërishte atje pas lumit ndënë shelgjet. Në foletë, gollogushët binin në gjumë. Bota rreth mullirit platitej e mbytur n'atë ztiurmën e pareshtur t'ujrave që vërshonin nga sopi, gjersa kalonte aty pari ndonjë gomare e urtë ngarkuar me plehë. Atëhere gjendja merte zjarr dhe qetësija kthehej në një lesh e li britmash e pëllitjesh në rezik të kapistrave që tendoseshin e bëheshin cop'e trokë nga sulmet e përsëritura e luftarake! Sulej përjashta Kola me ndonjë tjetër e, duke qeshur si me pahir, mundoheshin të kthenin në vend paqen e qetësinë me ndihmën e kërbaçit. Kështu më prishej gjumi dhe rendja jashtë duke lëshuar thirrje sulmi...

Kur mbaronin përleshjet, shihnja ata gomarët perçe-egër që ngrinin turinjtë nga qielli e bënin ngërdheshje sikur i kërkonin Shenpjetrit të hapte teftërë për kopaçet që hëngër kurrizit e vitheve.

Në ditët e pranverës kur kuarin bretkosat dhe sillej në qiell sqifteri, ruanja rosat e Kolës aty mb'anë lumit poshtë mullirit; ngrinja pantallonat gjer mbi gju dhe futesha në lumë. Uji ishte i vakur sa nuk më bënte zemra të delnja jashtë; peshq të vegjël më gudulisnin pulpët e njoma.

Ja se kù aviteshin atëhere vajzat e fshatit me pëlhurën e pajës ndër krahë, e shtronin nër ata gurat e vjetër të mullirit, që vinte Kola pas lumit, dhe hynin n'ujë për ta larë.

Më dehej shpirti atëhere nga gazet që dëgjonja. Qeshnin dhe këndonin vajzat me gropëza në faqet, laheshin duke u përkulur pas pëlhurës sa faqet e kuqe u pështeteshin pas ujrave dhe gërshetat e gjata ua merte rryma. Ja, atëhere u zbardhte gjiri e gusha si dëbora e Gramozit atje tej, që s'ka të tretur as dimër as verë. Pa kur ndodhte të ma ngasin rosakun e Kolës për zullumet që bënte (bënte ç'bënte ish punë për të), e lëshonja gojën m'urof atëhere ashtu si dinja e si ma merte mëndja, sa vajzave u bëhej balli flakë e më ndiqnin me grushta uji. Po në më ndiqnin e në më shanin zemra ju a ndillte fjalët e mija. Kjo zgjatte gjer dëgjonte Kola dhe më delte krah:



— «Mjaft, moj çupa, ma ngatë djalën... lereni, moj, se, është i vogël, lereni, moj, se ja u rrit pa do t'ju zërë udhën... do t'ju zërë udhën t'ju marrë shaminë!..»

N'oborrin e mullirit aty pas strehëve, ishte hedhur një pendë e vjetër druri e nër lugët e saja nxirnin krye tufa najazme. Uleshë aty e vëzhgonja Kolën kur gëdhendte shtiza e parmenda. Ay i gëdhendte me punë e djersë, po unë i ndihnja me gjuhën time që sillnja dhe e nduknja nëpër dhëmbë. Po shpesh herë lodhej, se druri ish i zgjedhur prej rrënje e më hidhte nga një fjalë:

— Do ma vjedhësh zanatin, o kapedan? Ver re, se edhe yt gjysh usta ka qënë... .

Unë përmblihdhesha e kruanja gushën me mjekër, po fjalë nuku nxirnja; humbisnja i tëri pas strungullishtave që çvatte tëhu i sqeparit. Ashtu ja humbisnja tragën vehtes i ndejtur disi këmbë kryq të më rrihte era për freski.

Një ditë, kur u ndodhëm kështu vetëm për vetëm me Kolën, ja se ku i ndritën sytë për një çast... pastaj buzët iu çelën edhe më, rrudhat iu tendosën në ballë e iu mblodhë në çip të syve, ashtu iu shkri një gaz e një e qeshur sa foli me shaka:

— «Mbylle dyqanë, bre kapedan...»

Po unë asi këqe isha i vogël e më t'u shtriva përmbys e ja dhashë të qarit me thirrje e buçima sa, besa po, e lashë muftinë në baltë.

Rendën gratë e u ngrit Kola, dhanë e muar të më pushojnë, po unë isha i goditur keq në sedër dhe e ngrinja kujen në majet sa më kërcëu damari i ballit dhe më digjte gurmazi i gjeksit.

Por dikush me një gjuhë nepërke vërshëlleu me të sharë. Ish Katua e Llambros:

— «Lereni, moj, të qajë sa t'i fryhen sytë e të pëlçasë... thirrë qerata... thirrë më shumë...»

Ishte kjo një ndërhyrje e paduruar në punët e brendëshme që s'duhej lënë pa ndëshkuar.

«— ...ëëë, moj, ç'ke ti? gjuhëlopë!»

Ja kështu pushova, për inat të Katos dhe u ngrita. Fërkovala sytë e ënjtur dhe ika tutje. Nëna m'u lut të flinja sa të më ftotej koka po unë nuk u binda, se e ndjenja vehtem burrë e haka duhej marrë pas kanunit e zakonit.

Majë gardhit varej një goxhë kungull rrumbullak. Mora çelikanë e ndava nga rrënja dhe e kapa për bishti. Që mos shihë njeri punën time u futa në mes të bathëve dhe u vura ta bëj kungullin fener. Po kur i hapa vrimën e parë më kërcëu në kokë e drejta e hakmarrjes dhe u hodha përpjetë si shqiptar i vjetër që i thosha vehtes. Ja nxora zorrët kungullit dhe, jo në jaz, se



mbahej në reshetkat (1), po (inat i Kolës) shkoj dhe e vërvit brenda në kadet. Atje ujrat gumëzhinin sikur t'ishte ndonjë peti (2) e madhe.

Sa piu një dy gllënqka ujë e sa lëshoi ca filluska, ky kungulli më vërë m'ori drejt e tatëpietë sa e mbajti zhytjen aty te sopi afër pendës. Sopi u zu, guri i mullirit qëndroi e ujrat e kades tep-tisën përjashta.

E sa më shumë vërshonin ujrat e zërat e trembura, e sa më shumë ndihëj zëri i Kolës oë po i mbytej mulliri, aqë më thellë futesha unë ndër ferrat karshi mullirit. Atëhere sekush hoqi drasën e cfratit (3) dhe vërshimi zu të gajasë; ujrat filluan të derdhen nga sopi me ca zhurma e gogësima që s'i kisha dëgjuar herë tjetër. Pastaj e pashë Kolën që doli nga cifuni (4) me sqepar në dorë, i qullur si çardolec.

Po dikush do kishte parë «trimërinë» time, se ndjeva emrin që m'u zu ngoje me të shara. U tremba e u shukosa sa m'u mbushën këpucët dhe i ndjeva këmbët të lagura. . .

Shtrenjt e pagova «trimërinë» time e veç e voç: paga e madhe ish për dëmin e mullirit, e vogla për kungullin.

Ndojta fshehur disa ditë dhe nuk dolla në pjacë. Kola gjith më kërkonte:

— «Thuajini moj djalit të dalë se fajin e kam vetë!»

— «Jo, ore Kolë, jooo, — ja kthente nëna duke situr në magje, nuk e kam djalën në shtëpi, ka marë malet e ka dalë kaçak...

— «Lerini, moj shakatë, po thuajini të dalë se e kam në zemër e do t'i shes zananë.»

Unë dëgjonja i mbledhur kuspull si kërmill e rinja hundëvarur sikur më kish ngrënë derri brumët.

Por asaj jave ngjau në fshat një gjëmë që e la në hije, atë që bëra unë. Dikush kish futur në një torbë kozine maçokun e Tases, ish ngjitur majë kishës dhe kish lidhur torbën në gjuhën e këmbanës së madhe!

Atë shamatë dhe rrëmuje kurrë s'e kam dëgjuar. Këmbana gjëmonte si ditën e gjyqit të madh, maçoku hidhej, çirrej e ulërinte si lugat. . . pa u trembën njerëzia sa u hyri ljepuri në bark. U mbledhë ca burra me zemër aty te kisha, ca të tjerë i thirrë vrapit te dhespoti e ca te beu i Kuçit, kur. . . maçoku dha e dha e plasi! Pa do ti që ma ngjitën mua edhe këtë rëng? Sa edhe sot e kësaj dite Dhori i Teto Savos, i hollë si cirua, ma nxjer gjuhën

1) Reshetkë = Lesë e vogël që ndalon hyrjen e sendeve në kadet e ujit të mullirit.

2) Peti = Tundës.

3) Cfrat = fraksion i jazit ku kthehen ujrat për të mos shkuar në kadet.

4) Cifun = Vendi ku vërtitet penda e mullirit.



kur e takoj në udhë e më mban mëri se gjoja unë u bëra shkak që ardhi në botë shtatanik, dy muaj para afatit! Mirë thotë fjala: më mirë të të dalë syri se nami.

E kur dëgjova se ma hodhë fajin mua, m'u ngashërye shpirti, buza m'u drodh e iu avita Kolës duke sherëmtirë:

— «Dilmë krah, o xhaxhi Kolë, se për kokën e babajt unë nuk kam gisht n'atë punë.»

Zëri më dridhej, lotët më roniteshin palë palë e bryll' e gju-një i ndjenja si të këputur. Më mori ndër krahë Kola. M'i fshiu lotët me ato pëllëmbët tërë miell dhe më dha zemër duke qeshur.

Tashti miqësia jonë u përtërit; veç kur e takonja Kolën andej nga kadet e ujit, nuk e shihnja dot në sy, iknja i turpëruar më nj'anë e shkonja i mbushnja ujë me bardhakun q'e mbante vulo-sur me një koçan misri. E tashti jo me gënjeshtëri te jazi a te pellgu, as te pusi i Naqove, por tutje fshatit te çezma e Llëngës, ku s'pinje dot me gojë se të thaheshin buzët e të mpiheshin dhëmbët.

Kur vinte dita e Shën Gjinit, më ngrinte Kola një kashtare të madhe dhe m'i varte zile e këmborë sa tundej fshati nga tringëllimat e tyre. Pastaj më sajonte qerre e karroca me rrota prej kulpri e spica prej druri. U lyente edhe boshtin me katran që mos kërcëllinin e të nxirrnin tym!

Ditë për ditë vinin e shkonin fytyra të reja në mulli. Kush vinte për të blojtur me qerre, kush me kalë e më dendur me qese, sipas kamjes e sipas sërës. Kish nga ata që tregonin ndodhi e histori të vjetra që më hynin në kokë e më delnin në ëndër. Kësh-tu dëgjonja si bëri dyfek Ali Pasha me Sulltanë, si u vra Abidini i Shagut e si u prish asqeri i Xhavitit. Po më shumë më është kalitur një këngë e bukur q'e këndonte për inat të Kolës një djalë cipëplatur:

*Je lulëz e verdhë, dalë nga xheneti,  
S'është me pahir, moj, me të dashur qefi  
Sapër ardhi vajza, malet vetëtinë,  
Gjynah perëndie, kush ja çkopsit gjinë!*

Nër netët e majit mblidheshin aty në trarët para mullirit, djemt e rritur të fshatit. Qeshnin e këndonin si të rinj, se zemra u ndillte gaze dhe rinia i shponte për këng e valle, sindozot i shpon tagjia mëzat e rinj për të harbuar gërxheve. Unë, delnja jashtë këmbëzbathur, mernja maçokun në prehër dhe ulesha më nj'anë pas plepave për të mësuar punët e djemërisë, se — si e thotë edhe fjala — sheh rrushi rrushin dhe skuqet.

Andej m'at'anë lumit nga ay vidhi i madh i Shëngjergjit me



degët e përdredhura si çengelë, dilte hëna e lante n'argjënd plogat e mullirit dhe çurrilat e ujit që vërshonin nga penda. Mizëri bilbila ja thoshin këngës aty rreth nëpër bisqet e plepave, e nipi i vogël i Kolës, q'ë ngitte violinë, e hiqte harkun sa ta ngrinte shpirtin peshë e ta hidhte tutje nëpër pyje e vruga ku këndonin të bukurat e dheut. Të tjerë e ngrinin këngën me afsh e vrull rinie:

O bilbil ta bëra benë:  
Në ta gjetsha dot folenë  
Do ta marr ta hedh në lumë  
Se na le çupat pa gjumë.

.....

— 'Ç'janë këto turpe që këndonin, bre? — ua priste Kola i habitur, — ku i kini këngët e trimave!»

Djemtë qeshnin dhe i mblidheshin plakut përreth. E merte fjalën Kola atëhere dhe tregonte ndodhi të lashta. E fillonte me kohën e Turqisë, kur luftonin halldupët me Themistoklinë e zgjatte me frëngun që mblidhte njerëzinë angari dhe tundte kokën me dëshpërim kur zinte ngoje vitin njëzet e katër, kur bejlerët me Zogun e përzunë Nolin.

Kur zhurma e gurëve e ndronte zërin, qe shenjë se mielli ish mbledhur kapulicë e duhej hequr më nj'anë. Atëhere e priste fjalën Kola dhe u kthehej djemve:

— «Hajde, merjani një herë «Ali Pashës» tashti e ikni, se nesër u pret puna e duhet hequr sopata.»

Ngjau një ditë pas ca vjetësh q'ë gjeta Kolën ndenjtur mbi një gur të vjetër me kokën ndër duar. Ish i vrerosur dhe i thelluar në mendime. Kjo ndodhte n'ato ditë kur u hap fjala se pllakosi Italia. Fjalën e kisha dëgjuar edhe vetë kur pashë vullnetarët q'u nisën për në Durrës të luftojnë të huajin. Shkova ngadalë përpara gurëve të mullirit dhe ngula vështrimin në gushën e potit që rridhte e s'kish të sosur. Guri vërtitej me sulm e ujrë vërshonin me potere. Asaj ditë pamë edhe që ardhën të huajtë. Në fillim u dëgjuan zhurma motorësh e më vonë u dukën aeroplanët e Italisë që sillleshin posht e lart. Njerëzia në fshat u dëshpëruan, po Kola u jepte zemër:

— «Është vakëf ky vendi i ynë, ore, kush vjen me dhunë, me turp do ikë.»

Më tej na kaluan nëpër fshat ushtarët e huaj me pendë kaposhi në helmetat e të veshur me këmisha të zeza. Njeri nuk dolli t'u japë ngjatjetën e sikush i shkoi llozë portës.

Kohët kalonin, moshatarët si unë rriteshin e bënëin përpjetë, po edhe Kola s'kish të tundur nga pleqëria dhe mbahej si një lis



i fortë. Kisha mbushur atëhere të gjashtëmbëdhjetat, kur hyra të punoj si çirak në mulli.

Dhe ish pranverë. Aty rrotull mullirit plepat furshullonin lehtë e lehtë me një fëshfërrimë që nuk e kapte dot veshi. Shelgjet sapo plasur gjethi i mbanin degët e vogla kthyer tatëpjetë nga barra e atyre vëthëve ngjyrë qipre që rrinin kaluar nëpër bisqet. Fusha dukej si e ngjyer me një gjelbërim të thellë. Trëndafilat e egër po çelnin sythet e fjetur e peshqit kërcenin në ujrata e jazit. Në qiell shpeshët cicëronin të çkujdesur në ajrin e vakur. Lumi fryhej e ngrihej shkumbë kur ngjitej dielli lart dhe tutje në Moravë nëpër bardhësinë e dëborës po nxirte krye gjethi i ahut. Fshati nga larg zbardhonte si një vezë midis pyllit me drurë. Kërcejt e gjatë të karafilleve po ngjiteshin në dritoret e vajzave ku kundërmonte borzilogu.

Diku pas lumit, ku lanin vajzat, ish një shelg plak me lëkurë t'ashpër. Nëpër trungun e tij vareshin tufa myshku. Ujrat aty flinin pas hijeve e merrnin një ngjyrë të thellë si vaj. Më tej, ato kishin atë ngjyrën e çelur të hirës së kulluar. Anës shtratit të lumit shtriheshin lëndinëza të vogla ku mbinin tufa bari. Vinja herët aty e lanja faqet. Nëpër barin e njomë, qëndiseshin fije marimage, aty këtu pika vese si thierza prej xhamit ndrinin mbi bar. Unjësja atëhere aty pas lumit dhe ngulnja vështrimin pas bulezave të verës që dukeshin si bebe syri e lëshonin vezullime në ngjyrat e ylbarit. Dhe unë atëhere isha djalë i ri. Ma kish ënda të bridhnja mezhdave ku rritej bari, t'i binja kryq e tërthori fushës me grunjrat e ngalluar dhe pyllit me lajthishte, të rendnja nëpër vrugat anës lumit, ku ujrata ngrinin valëzat e bardha.

Dhe kështu harbonja pa u ngopur me shatën në dorë pas lumit e grazhdeve të remës për të mbledhur ujrat që gjarpëronin nga pylli nëpër ara e livadhe e gjer në fshat. Kur vinte mbrëmja, ndiheshin këmborët e kthehej grigja nga kullota; atëhere ndihej këmbana e kishës dhe Kola më lëshonte nga puna. Unë delnja një herë pas krojeve të fshatit. Sulinarët ishin plot e ujrata vërshonin të gëzuara. Vinin atëhere vajzat e fshatit me shtambat e gjymet ndër duar. E mbanin shaminë e bardhë lidhur më njanë e gazin në buzë; e jo veç gazi i buzës, po u marte zjarr nuri i faqeve të kuqe dhe i llërëve të bardha. Më dukej atëhere se aty te kroi ku gurgullonin sulinarët, mbledhej gjithë gazi i fshatit, më dukej se era e borzilogut frynte e s'kish të sotur, desha të kisha dyzet palë sy për të shikuar dhe krahe për të fluturuar.

Kështu më mbushej shpirti me gaze.

Dhe ja, atëhere n'atë moshë më ra në kokë për një vajzë. Emrin e kishte Afërdita. Sytë i kish të kulluar si ujrata e krojeve, faqet të kuqe si cipa e pjeshkës dhe gushën të bardhë si mjelme.



Me 'të ishim rritur dhe kishim lidhur verore, bashkë kishim lojtur burr' e grua fshehur nëpër lisnikët me bar të njomë, në bangot e shkollës kishim ndenjtur tok... po tashti që u rritëm (pa shkak e pa të sharë) kur shiheshim me sy nuk flisnim me gojë. Dhe më kujtohej ajo kënga:

*Me qershi  
Bënja mustaqet  
Tinë skuqnje faqet  
Jam e bukur theshe  
Të të puthnja deshe  
Në faqe, në sy.*

*Pastaj  
Sërënditnim nuskat  
I vinim si krushkat  
Losnim burr' e grua  
Dhe më thoshe mua:  
Merremi të dy?*

Tashti, kur ndronte udhën dhe balli i merte zjarr, kur kthente kryet më nj'anë e mbante çapin ngadale, kur buzët e kuqe gjak si qip thëllëze i dridheshin si flet' e trëndafililit... më mbahej fryma dhe më kërcente zemra. E shpesh këndonja me vete:

*Fët me sy, fët me qepallë  
Më fute në dhe të gjallë*

.....

Shkuan ca muaj dhe ja, një mbrëmje, e hasa jashtë fshatit. U ndodha me shatë në dorë pas ujrave të jazit kur e pashë Afërditën që rrihte të kapë manaren shilege dhe s'e kapte dot. E mëkonte me krodhe buke po manarja s'desh të shtrohej dhe ikte tutje.

M'u ndez damari i ballit atëhere dhe e mora lumin me një të hedhur. U vërsula pas manarit e kapa me një frymë dhe e mora në krahë. Qengji ish i butë dhe i bardhë po nuk desh të shtrohej. Kështu ishte edhe vajza, po u shtrua. Dhe si u shtrua vajza lëshova manaren... dhe manarja iku e mori dhenë po ne s'kishim kohë ta ndiqnim!

Në një natë pa hënë, u ndodhëm me Afërditën aty ndënë shelgjet e mullirit. S'kishim gjuhë të flisnim po as këmbë të iknim. Një xixëllonjë doli nga trëndafilat e egër dhe sillej aty rreth, një tjetër iu lëshua dhe e ndoqi pas! Një bilbil ja ngriti këngës aty



nëpër degë... edhe një tjetër i shkoi pranë dhe u bënë dy. Edhe ne ishim dy atje ndënë shëlgjet.

Vura dorën në zemër se m'u duk se po më ikte. E m'u bë atëhere një brengë e një dëshirë. Kisha frikë se m'i ikte zorra edhe vajzës! Desha t'i ve dorën në zemër... po kur ngrita pëllëmbën bryli m'u këput... M'u këput bryli dhe i zura llërën...

E kini parë miloren kur çan shtegun dhe ikën si shigjetë?

Ja kështu më iku Afërdita me vrull e me të keq e më la si të goditur aty ndënë shëlgjet.

Po vajza ishte tekanjoze.

Sot iku dhe nesër mbrëma ardhi. Dhe kur ardhi s'kish të ikur. Më vinte atëhere të kisha krahët të gjatë dhe të pushtonja e të puthnja gjithë botën.

Vajza më iku në agim, po unë mbeta aty gjer u ngrit dielli. Rrezet e tija s'e çanin dot pyllin me shëlgjishta e ujrata e lumit e ndillnin dritën nga rrezet që kalonin sipër e rrëshqitnin tutje për nga vreshtat. Mbi faqen e qetë t'ujrave të mëngjezit dukej atëhere si në pasqyrë mulliri me oxhakun që tymonte ngadalë, plepat me pullat e bardha e gjer currilat e argjenta që vërshonin nga penda.

U këput një petale e kuqe nga trëndafilat e puthi ngadalë faqen e ujrave sikur druhej mos i zgjonte. E, sado e lehtë petalja, ujrata përhapën valëza t'imita, e dukej atëhere sikur falej e për-kundej mulliri, trunget sa edhe vetë Kola me sqepar në dorë që më thërriste mua.

Kohët kalonin. Lufta e madhe kish marë dhenë në botën e tërë që ku lind e perëndon. Edhe vendi ynë s'mbeti prapa. Brana e luftës kaloi e ashpër me të sajat: vrasje, zjarre e prishje an'e mb'anë. Tashti nër netët e majit, kur veç bilbilat s'deshën të dinë për punë lufte, mblihdeshin sërish djemt' e fshatit atje para mullirit. Po tashti as valle hidhnin e as këngë këndonin. Fjala tashti punonte për çetat nër malet dhe për luftën kundër shkelësit të huaj. Djemtë e fshatit zunë pakësoheshin gjithë e më shumë. Gjer dje i merte kurbeti, tashti iknin malit përpjetë me pushkën në krah e yll në ballë.

Një ditë të djele u dha një çetë partizanësh aty para mullirit. Doli edhe Kola e u dha ngjatjetën, unë i rinja më krah.

Djem të rinj ishin partizanët, armatosur gjer në dhëmbë, syrin pishë e kapellat kapitur më n'anë. Komandanti i tyre shtroi fjalë me Kolën dhe e bënë litar të gjatë. Fshati i tërë ish mbledhur atje si ditën e Shënmitrit dhe u gëzohej partizanve dhe fjalës së tyre.

Kur ardhi koha të largohen, komandanti i tyre u ngrit, i rrahu supin Kolës dhe i tha:

— «Ki mëndjen, baba Kolë, në arthtë beu, daç vetë daç me



sejmenët, gjë mos u jep; dërgomë zë asaj Morave se ja ndreqim samarë...»

Kur dëgjoi këto fjalë, Kola erth e u shtang atje pas murit e u bë si i kthisur:

— «Ki mëndjen, o djal' i Josifit, mos e merr kështu rrëmbyer, se ti akoma i ke dhëmbët me qumësht, s'e di ti, ore, se ç'do me thënë bej e sejmen, më pyet mua dhe tët atë, beu të vret e të rrëmben me dorën e tjetrit... e ke dëgjuar atë fjalën? Edhe gomar të bëhet beu mos e hip se të rrëzon!»

Kështu e pati frikën Kola, po ndryshoë doli puna.

Herë në mal e herë në fushë zu punonte pushka. Patrullat e italianve rendnin Devollit e s'u zinin këmbët dhë. Komunat e postat e karabinjerëve u fshinë e s'u mbeti shenjë. Partizanët hapnë kosheret e dhjetarëve dhe bereqetin ja ndanë fukarasë pesë e pesë. Kështu u shtua edhe puna e mullirit se tashti fukaraja filluan të bluanin jo me qese, po me thasë.

Por këto punë që anonin peshën nga fukaraja nuk u ardhë për shtat as bejlerëve e as agallarëve. Nuk vonoi, dhe çetat e ballit nisën të sillen si hije nëpër fshatrat, me bejlerët në krye.

\* \* \*

Qetësinë aty rrotull mullirit e prishi përgjithënjë koha me ngjarjet e saja. Atje para mullirit, në një mbrëmje të zymtë, u bë luftë e u derdh gjak.

Fshati im kish miq atë ditë, ata djemat e tij me yll në ballë. Po ja, në mbrëmje u dukën mb'anë fshatit një sërë ballistë veshur si pojakë. Të dy palët gjer atëhere shiheshin vëngër, po gjer te këmbëza, puna nuk kish vajtur. Dhe u gjendën të dy palët ballë për ballë atje para mullirit. Ata të ballit rrugën nuk e kishin atje, po nga pushkët që mbanin peshë, dukej që e kishin lëshuar brezë e donin sherr. Nga partizanët u ndodhë atje nja dhjetë djema me pushkë krahut, që, besa po, për punë lufte e trimërie, nuk e hanin bukën kot.

Fjala solli fjalën dhe biseda u bë e ashpër. Ballistët ishin të shumtë dhe u dukej hunda dyfek. Donin «t'u hapej udhë e t'u bëhej vullja, se besa besën do përpinin retë».

Atëhere doli Kola me dorë në zemër e i u lut të dy palëve mos bëjnë dyfek. Po ca ballistë gjuhë-prishur i jepnin bukë sherrit.

— «Amani, bre burra, dermani ore djema, dëgjomëni mua se ja u thinja e di më shumë, qëndroni bre, mjaft me këto fjalë... jo të kuqe jo të zezë, jo me yll jo pa yll, jo u lak jo s'u lak... juve bre ballista ju them, mjaft ore me të shara! Qëndroni bre, si s'kinë turp nga thinjat e plakut e nga gratë e fshatit?»



Një ballist mustaqemadh e hijerëndë, si ndonjë katallan, iu kthye Kolës:

— «Mbylle gojën, ti shtrik, se t'i derdha trutë...»

Ballisti lëshoi një të sharë që Kola s'e kish ngrënë herë tjetër. Po plaku gjithë lutje me lot për faqe dhe u duk sikur shërri u platit. E kur zunë të shtrohen gjakrat ja ku plasi një pushkë andej prapa nga ishin ushtarët e ballit. Plumbi fishkulloi përmbi kokët e partizanve. Kështu mori zjarr baruti e plasi lufta. Kola ashtu si u ndodh u përmbys atje te pragu, mbuloi sytë me pëllëmbët që mos shonë gjëmën.

Gjashtë ballistë mbetën të vrarë atje. Nga partizanët u vra një trim i ri.

Më tej ardhë më nge ata burrat e ballit me gjermanët pas, se vetëm nuk ua mbante. Ishin në turp për atë luftën që e paguan rëndë; kështu e hapën gjyqin atje para mullirit. Dolli edhe Kola t'u dëgjonte ngjatjetën, po ata ishin t'egër si në istikam dhe e kapën me t'ashpër:

— «Edhe mullisi na qëlloi me dogra, — foli një ballist kapadai që Kola s'ja kish parë sytë tjetër herë.

— «Ku i ke niprit, mor gërçho? — i foli një tjetër.

Kola i shikonte si i çuditur e desh t'i dëgjonin fjalën, por ata s'i linin radhë:

— «Niprit ku i ke, mor matuf? — foli sërish ay i pari.

Atëhere Kola e mblodhi vehten:

— «Ja ore, asaj Morave janë, me shokë të zgjedhur si njëri tjetri, në jini burra dhe në ju a mban ngjiti t'i hasni... ju presin si u ka hije, si krushq e si dhëndurë...»

Dollu atëhere në krye të ballistëve Fuat Beu dhe e mori punën shtruar. E kish të njohur Kolën dhe ja thosh mëndja plakut se e kish mik.

— «Pse, brë Kolë, ke qëlluar me dogra pas krahëve? Pse ore nuk shikon troshankat e mullirit po u ngrite pusi ushtarëve të ballit? Pse ore ke dërguar niprit atij mali e u mban anën kuqalashëve?»

U gëlltit i menduar plaku dhe tundi kokën me sytë e hapur sa s'ja kisha parë herë tjetër:

— «Kush ka qëlluar, i qëlluar qoftë, o Fuat bej; unë shoh punën time të më shkojë tymi drejt përpjetë e ujët tatëpjetë, nuk më ha malli për thash e theme e jallan shahitë... U fola ushtarëve të tu mos e ngrënë këmbën si breshka, po nuk më dëgjuan; e në s'më dëgjuan kush u ka faj? Sa për djemtë q'u mbaj anën, ashtu më thotë vizhdani. Doemos fukaranë e dua, se ashtu jam edhe vetë. Fukarasë i mbaj anën, o bej, që bluan me qese, e jo zotris sate që bluan me qerre e karvane.»



Zu mahisej puna sa ushtarët e ballit filluan ta qëllojnë Kolën me kondakët e pushkëve. E në kisha atëhere plagë në zemër, e në më dridhej shpirti për gjësendi... këto ishin kujtimet e largme kur isha sjellë keq me Kolën. Kur e pashë q'ë muar nëpër këmbët (u bu bu, sa turp qënka kur rrahin plakun në sy të njerëzisë) m'u err bota...

Por atëhere pashë trimëri prej djali në zemër prej plaku. Se Kola turpin s'e hante dhe faqen tjetër s'e kthente. Rrëmbeu dastavallë (1) e listë që këthenim gurët. I madh e shpatullgjërë, me dejet e qafës kërcyer e mavijosur një gisht, ulëriti e qëlloi si më ujk e më ari. E lojti dastavallë me tërsëllëm sa theu e bëri bërrilok duar, pushkë e ç'gjeti përpara. Kështu bëri, po vdekjen e njo-hu dhe i priste plumbat nga gjoksi.

Pastaj ngjau gjëma e mënxyra. Që prapa kurrizit, nga dritorja e vogël e mullirit, ballistët ja lëshuan Kolës me batare. Plagët i hëngri të rënda se plumbat i dollën nga gjoksi por Kola ish koskëfortë dhe u mbajt si burrë.

— «Më hëngërt që prapa e më vratë kurrizit, o qena të pabesë, turp nga niprit kur të më shohin plagët...»

Dhe u mbajt sa zgjodhi vendin aty në pengorja ku kalitë gurët gjithë jetën. Pastaj u shtri duke gulçuar me fytyrën nga lindja.

Atëhere më sëmboi në zemër dhe më ra çerja e vdekjes. Lotë të nxehtë valë m'u ronitën faqeve dhe m'u duk se zemra më pushoi.

Dhe mulliri më mbeti mua. Po as e mbajta dhe as më mbante. Se gjithë ujrë e lumit nuk do ta lanin dot gjakun e baba Kolës.

Jam ngritur atëhere në një agim vjeshte dhe me një sërë shokë ikmë malit nëpër patrullat e gjermanit.

Shokë ishim shumë e ata më hoqën udhën se ishin më të pjekur.

Ishim të rinj atëhere, po lufta nuk pyeste rininë tonë.

Kishim (e sikush e dinte si e kish) nga një dhëmkë të fshehur, po i vumë zemrës gur dhe shkuam të hasëm shokët atje lart, në Moravë.

---

1) Dastavall = Hu i trashë, një farë manivele që shërben për të ngritur gurin e mullirit.



## PJETËR PRENGA PARTIZAN PREJ IBALLE

Kur dolla në pragu atij mëngjezi vura ré se natën kishte rënë shi. Toka po terej ndërsa ploçat e oborrit kishin marë një ngjyrë si të plumbit; qielli ishte kthjelluar e pullazi i shtëpisë kundrejt po avullonte. Një kërcell kungulli ishte rëzuar nga gardhi i kopështit dhe i qenë këputur lulet e tija të bukura ngjyrë portokalli e në formë këmbane.

Po menjëherë m'u kujtua se të djeshmen, përmbi fshat, kaloi lufta. Gjermanët e vunë fshatin në shenjë, që në agim dhe gjer në mbrëmje. Dhe ja tashti, tej pragut dukeshin çati të shëmbura, shtëpi të djegura, plepa të çapluar dhe fytyrat e njerëzve të trembura.

Gjermanët po vepronin kundër partizanëve në gjithë gjërësinë e Moravës .

Tek po rrinja ashtu, dikush që nga bathët e kopështit m'u fanit si një hije:

— O çun i Ferezit... nxito këtu!!!

U përkula që të shoh kush më thirri kur ay nxori kokën nëpër purtekat e fasuleve. Ishte Kolja i Stefanit me një shtambë në dorë. M'at'anë lehu qeni, këtu krisi gardhi ndënë këmbët e mia dhe iu avita.

— S'ke marë vesh ngjarjet? — më pyeti Kolja.  
Unë çaplova sytë e skleposur. Ay vazhdoi:

— Gjatë natës kanë ardhur gjermanët me karvane që s'kanë të sosur... po ikin për nga Fusha e Korçës; aty në spitalin e Moravës, shokët kanë sjellë një partizan të dëgjuar. Merre këtë shtambë me qumësht dhe shpjere... në takofsh gjë ballistë a gjermanë thuaju se e shpie në livadhet ku kositin!

— Po në më rënçin pas?

— Ikë more, se ti je i vogël dhe nuk bije në sy, pastaj ata nuk i futen pyllit, ndjekin veç xhadenë.

Rrëmbeva shtambën, po Kolja s'kish mbaruar:

— Shiko të nxitohesh, lingua të vesh e ljepur të këthehesh.

Unë e nisa rrugën me linkth, duke kaluar nëpër vijën e vaditjes pas mezhdave me manaferra. Zhurmë të huajsh ndje-



va por me sy as i pashë e as më panë. Veç më të dalë të fshatit, Balua i kopesë m'u vu pas e më vështronte me ata syt e tij të prushtë sikur mburrej me armaturën prej hekuri që mbante qafës.

Spitali partizan mbante nja dy orë larg fshatit dhe ishte mes një pylli me boriga. Godina, që ishte ngritur nga italianët, ishte e ndarë me dy këthina, njëra sa katër rrogozë vend, e pa-lyer me llaç por e spërkatur me sherbet gëlqereje.

Kur u afrova, një partizan i armatosur, u shkëput që pra-pa drurëve dhe më doli përpara: ishte roja partizane, që më la të kalonja pa më dlorur. Ndoqa një fill telefoni, që zvarrisej nëpër halat dhe boçat e thata të borigave dhe mbrija. Ne dera jashtë vura re një brankardë të njollosur me gjak. Hyra brenda si i trembur dhe lëshova shtambën më nj'anë. Aty kundër-monte një erë e rëndë jodi dhe gjaku. Rreth shtratit ku qe i plagosuri ishin mbledhur një tok njerëz. Katër ishin druvarë nga fshati im të ardhur vullnetarë për ndonjë shërbim, kurse të tjerët ishin partizanë: Ishte infermier Llambi (që e thërrisnin doktor Llambi) i gjatë sa një furkë kashtareje me kokën e rrojtur me brisk, ishte Vasilika, një shoqe që punonte në terren, i treti ish Seferi, përgjegjës dhe kuzhinier i spitalit. Nga fytyrat e tyre të vrejtura dhe fjalët e pakta që shkëmbejin kuptova se i plagosuri ishte keq. U afrova ngadalë dhe nëpër duart e atyre që shërbenin pashë partizanin e plagosur: Ishte Pjetër Prenga, partizani i dëgjuar për trimëritë e tia të rralla. Unë e kisha parë edhe herë të tjera, por sot mezi e njohta. Nga zjerrmia, fytyra i qe përskuqur si kaftan, ishte tretur e ligur, mjekra i qe rritur, flokët e zes dhe t'ashpër si kozinë tashti sikur i qenë zbutur e mbushur me zbokth. Dukej si i humbur në një gjumë të thellë. Damari i tëmthit i rrihte nxituar dhe flegurat e hundës i qenë tendosur. E kishin lidhur me ripa pas shtratit, sepse, si dukej, nuk ishte në vehte. Ndërsa e mjekonin, pashë se plagën e kishte në kofshën e djathtë; përpara plaga s'ishte e rëndë, veç i qe mahisur, po, kur e këthyen të plagosurin përmbys dhe i hoqën fashën për t'ja ndruar, atëhere pashë diçka të dhëmbëshme që më bëri të dridhem sa m'u mbush trupit me mornica. Nga prapa plaga ishte e thellë dhe e gjërë sa të nxinte brenda një vezë pate; mishi rreth plagës ishte zverdhur e qelbëzuar dhe krimba të hollë sa një fidhë, me rrudha t'imta e me kokë ngjyrë kafeje, i delnin hera-herë nëpër gojëzat e mishrave të coptuara. Infermieri me një pincë të hollë ja pastronte plagën dhe sa herë që hekuri i plagës takonte në mish, i plagosuri, i përhumbur siç ish, merte frymë me zor.

Atëhere vura re edhe një partizan tjetër, që ishte ulur në



një fron druri në kthinën tjetër; ay ngulçonte e psherëtinte me gjoks in plot por unë nuk po e njihnja se ay mbante fytyrën mi-  
dis duarve. Hera herës dëgjonja Llambin që bisedonte ngadalë  
me Seferin.


Partizani i panjohur, që ishte në kthinën tjetër, u ngrit  
dhe iu qas shtratit. Atëhere i pashë fytyrën dhe e njohta: Ishte  
Qemali, partizani qimekuq, që dikur më kishte falur një kon-  
servë gjermane. I parrojtur, me sy të përskuqur, duart lëshuar  
poshtë si të këputura e shihte Pjetrin me një vështrim të për-  
dëllyer ku përzjehej frika dhe dhëmbja. Ju afrua Llambit dhe i  
foli:

— Thuamë drejt, o Llambi, a ka shpresë...?

— Të thashë, o Qemal, i duhet prerë këmba, po këtu nuk  
bëhet ajo punë, mjeku nuk po duket dhe plaga është mbushur  
plot me krimba... s'ka si ta pastrojmë...

Më mënyrën e një njeriu, që ka marrë një vendim, Qemali  
tregoi se i ati kishte qënë xhera dhe vetë merte pak vesh nga  
«ato punë»... Pastaj Qemali tha diçka që m'u bë sikur nuk dë-  
gjova mirë. Të tjerët po hapnin sytë dhe po e shihnin të habitur  
atë partizanin qimekuq që po lante goj' e buzë me ca alkool që u  
ndodh mbi komodinë.

Në këtë rast u bëra dëshmitar i një ndodhije që është zot





ta përshkruaj; çaplova sytë, ndërsa buzët m'u shtërnguan...

Qemali mbështolli me buzët e tia plagën e Pjetrit dhe filloi të thëthijë. (Mua m'u bë sikur më ardhën zorrët ne goja). Pastaj hoqi gojën më nj'anë dhe zbrazi në legen një përzierje krim-fash dhe qelbi. I plagosuri ndjeu dhëmbje se filloi të rënkojë dhe të flasë përçart me një zë të thekshëm. Qemali vashdoi të thëthijë me një mënyrë t'ethëshme ndërsa bulëza djerse i rridhnin prej ballit. Kjo zgjati gjersa Llambi e mbajti për supin. Nga habia unë mbeta si i shastisur.

Tashti gjendjen e të plagosurit e shihnja në syt' e Llambit që dukej disi i qeshur. Duke pastruar plagën ata diçka flisnin. Nga kjo kuptova se atje pritej të vinte mjeku, bile Seferi shpjegoi se ishin nisur korrierët në katër drejtime për të hasur Batalionin ku ishte edhe doktori.

Po rrinja më nj'anë vetullngrysur kur Pjetri filloi sërish nga përçarti:

— «Katër mbetën vrarë... për atë qiellë katër mbetën... ha ha si ikin burrat... ndalni bre, ndalni, oj ballista! ja, ja që ku asht Marka Gjoni...

Më tej i plagosuri u qetësua; Llambi tha se e nxehta i ra më poshtë e duhej qetësi, — Prandaj, merrni mundimin e delni të gjithë jashtë! — na foli neve.

Dollëm të gjithë dhe u unjëm në lëndinën e vogël sa gjysmë lëmi para spitalit. Kundrejt dukej një borigë me një plagë sopate hapur në formë govate ndënë degat e fundit; q'atje rridhnin pika rëshire që kundërmonin një erë të këndëshme. Për rreth nëpër drurët dhe nëpër ca lule të merme zukatnin bletët. Një sopatë punonte përtej nga korijet.

E morëm në mes Qemalin; e shihnim me nderim të thellë atë partizan trim q'u tregua aqë zemërmadh me shokun e tij. Si ndezën duhanin, Qemali mori fjalën:

— «Ky djalë nga Iballa solli ndër ne trimërinë e maleve të Mirditës. Historia e tij është e rrallë dhe me trimëri të padëgjua ndër anët tona.»

Unë u struka edhe më pas Qemalit, u bëra vesh i tëri dhe e nxita të vashdojë:

— «O khaxhi Qemal, tregona diçka për Pjetrin që të jetë me trimëri dhe me luftë...»

Si çkopsiti gjerdhanin, q'i shtërngonte belin, Qemali e nisi fjalën:

— Natë dimri, e natë furtune ka qënë ajo, kur Pjetri ardhri partizan në çetën tonë. Sa u err dhe gjer sahati dy allafirënga e kemi rrahur dëborën jo me gju, por me gjoks dhe me shpatull; në të hyrë të Braçanit rrethuam postën ku Italiani mbante





nja njëzet shpirt t'armatosur. Ca me hile ca me trimëri u hymë brenda pa na pikasur. Me kobure kokës i bëmë të ngrejné duart lart. Thamë se mbaruam me aqë kur... zuri të na merrte puna spicë! Një nga ata nuk iu bind as fjalës dhe as revoles. E ndjemë se ky ishte prej tjetër brumi, se nuk i bëri veshi tërr. E ky ishte Pjetri. Mbante një granadë në dorë gati ta shkreppte. Na foli me inat dhe me zë të gjerrë:

— Pash zotën mos më prekë kush se e shkrepça bumjen të digjena të tanë!!!

Na shihte i egërsuar me ballin e vrejtur e flokët ngritur përppjetë. Komandanti i çetës hyri në mes dhe i foli me urti. Po ku të merrte pykë kok' e Pjetrit! Si na hëngri me sy të gjithëve e ngriti zërin përsëri:

«Zotnij partizanë! Në luftoni për Shqipni po vij me ju, në goftë ndryshe hapni rrugën se ju griva, të flasi komandari juj!»



Ju afrua Loni dhe i foli shtruar, ju betua dhe i dha besën. Atëhere u bind dhe ardhi me ne, po pushkën nuk e lëshoi nga dora. Ditë të tëra dëgjonte kuvendimet tona dhe na bombardonte me pyetje si t'ish fëmijë. Një ditë u ndodhëm në një manastir afër Moravës, Komisari e mori Pjetrin pranë dhe shtruan fjalë. Pjetri e dëgjonte duke e vështruar në sy e pastaj e ngriti zërin:

— Ça po thue bre burr, Marka Gjoni asht'i fortë, robi ja ka frikën dhe krahun e ka të gjatë...

— Të gjatë e ka, o Pjetër, — ja ktheu komisari — të gjatë e ka se nuk kish dalë njeri t'ja presë...

Shiheshin sy ndër sy dhe, n'atë cikmë dimri, fryma u për- zjehej.

Pjetri e mori fjalën përsëri:

— A po shkojmë asaj Mirdite, o shoko, do të çoj n'ballë e atje mbledhim burra sa të duash...

— Me ngadalë o partizan, më tej do të shkojmë edhe në Mirditë!

— Bes' e burrit! Piqe këtu!

U përqaftuan dhe zunë dorë.

\*\*\*

Kur çeta merrte rrugën në fushë a në mal, Pjetri doemos ishte pararojë. Takonte që natën ndiheshin zhurma përpara; ay shtrihej barkas, vinte veshin pas tokës dhe ta thoshte me siguri se kaqe dhe aqe njerëz e kalorës vinin që andej. Është i mësuar me jetën e ashpër dhe i duron vuajtjet si jo tjetër njeri. Në luftë është veç të tjerëve, kur jepet shenjë sulmi Pjetri është gjithënjë përpara.

Në luftën e Pojanit u vërvit mbi një llogore të italianëve dhe i mbuloi me bomba-dore, pastaj na thirri:

— Ngarendni këtu, oj shoko, se po maron taljani!

Në luftën e Qafës së Gollomboçit, u fut ndënë kamionat e armikut dhe atje, që nga poshtë i griu me automatik tre mlicë që nuk deshën të dorëzohen.

Si trim nuk ka shok, por është edhe zemërmadh! Një ditë i dollën përpara, në mes të një fshati, nja katër ballistë dhe deshën ta çarmatosën. (Atëhere nuk kishte filluar lufta me ballin.) Do kishte plasur pushka, kur u futën atje në mes një tufë gra dhe iu lutën të dy palëve që mos shtijen. Të dy palët u bindën, por veç një mustaqemadh e shkeli dhe e shau Pjetrin në sy të grave. Atëhere s'kish burrë t'i mbante dorën Pjetrit, por veç zakoni i maleve të tia e ndaloi! Ju kthye ballistit dhe i tha: «Po të shpëton «Kanuni i Lekës» o qen bir qeni, nuk qit



dot pushkë mirditasi kur ka pranë një grua shtatzanë, po mbaj mënd, oj cubë se edhe në bri të drenit të futesh, unë kam me të gjet. . .»

Po do ti — këtu Qemali lojti vendit dhe ngriti zërin sikur përzuri ndonjë të keqe — do ti, që më tej, kur balli u bë njësh me gjermanët e solli çargu dhe mustaqemadhi ra rob bash në dorë të Pjetrit! Na u shtri ndër këmbë ky birko mustaqemadhi, çirrej e lebetitej me aman derman, i puthte këmbët Pjetrit dhe lutej t'i falim jetën. Ne prisnim të shohëm ç'do bëjë Pjetri, kur ky çpërveshi buzët dhe i foli:

— Ngreu e vdis si burrë!

Po mustaqemadhi gjithënjë lutej e falej dhe i lagu pantallonat.

Atëhere Pjetri s'e duroi dot dhe e shtyjt:

«— Ikë tutje bajgë, Pjetër Prenga nuk e filliq pushkën me nji burracak.»

Dhe nuk e vrau.»

Nga spitali u ndje sërish përçarti i të plagosurit dhe pastaj zëri i Llambit, që mundahej ta qetësojë. Qemali kërceu në dera, por infermieri nuk e la të hyjë. Në po mbanim frymën të dëgjonim ndodhitë e Pjetrit dhe i varëm sytë mbi buzët e Qemalit. Për rreth ish qetësi e thellë e vapa e qershorit sapo kish filluar. Borigat me kurorat e gjëra të degëve dukesh sikur i rinin roje asaj heshtjes madhështore të pyllit. Nuk ndihej asnjë zhurmë aq sa një urith i nënëdheshëm, nja dy çape larg, filloi të ngrohë një kapule dheu të ronitur si kaçamak.

— «Trimëria e rrallë e këtij djali, rifilloi Qemali — u duk të mërkurën që kaloi. Asaj dite u ndez lufta në vreshtat e Hoçishtit. Gjermanët po na sulmonin me forca të mëdha. Artileria e tyre qëllonte aqë dendur sa unë kurrë nuk kisha parë ndonjë luftë t'atillë. Më dukej se pas gjith asaj lufte asnjë nga shokët nuk do kish shpëtuar. Vate n'atë dynja batalioni i ynë, mendova, kaqë e patëm. Gjatë tërheqjes nëpër tymin e predhave takova edhe dy shokë të tjerë: Ejani o vëllezër, u thashë, veç ne kemi shpëtuar. Në pyllin e Bradvicës ishte vendi ku mblidheshim pas lufte. Në jetën time kurrë nuk kam patur gaz më të madh se atë që ndjeva atje: shokët gjith po mblidheshin, shumica me plagë, por të gjallë. Sa me ankth e kaluam atë natë, duke lidhur plagët e duke nëmëruar shokët. Pas mesnate ardhni edhe një grup shokësh që mungonin. Nga goja e tyre dëgjuam lajme të hidhur: Bajaziti, Nikolli e Muçua u gjendën të vvarë nga fshatarët, i varrosëm mb'anë një dëllinje, mbi kokë u vumë nga një gur.

Tashti mungonte veç Pjetri. Askush nuk e pa, askush nuk e dëgjo. Mbrëmje herë u nisa vetë poshtë Devollit dhe hyra



në Hoçisht kur, nja dy pionerë lajmëruan Këshillin se në pyllin e Gracës ishte një partizan i plagosur. U vesha si çoban me një brucë krahëve dhe u nisa për atje. Disa gra, që m'u vunë pas, i ktheva të më sillnin një brankardë. Thellë pyllit e gjeta Pjetrin! Po si ishte bërë? Do t'i dhimbsej edhe gurit edhe drurit. Si kishte mbetur gjallë, ay e di! Plagën e kishte pllakosur me duhan dhe e kishte lidhur me këmishën. Kur më pa, i ndritnë sytë e venitur, u ngrit përgjysmë duke shtërnguar dhëmbët dhe atëherë e vura re se ishte ligur e tretur sa s'ka më keq. Ngriti duart me grushtat mbledhur. Më përfshiu për qafe dhe më puthi, ndofta i ardhi vaj nga gëzimi por lot nuk derdhi, veç dënesa gëzimi i gufonin në gjoks. E mjekova si munda dhe u nisëm nëpër errësirë. Ato gratë e Hoçishtit më bënë nder të madh se bashkë me 'to e sollëm gjer këtu. Gjer në mes të rrugës e kishte mëndjen dhe më tregoi vuajtjet dhe ndodhitë, por më këtej e humbi.

Kish mbetur i goditur nga një plumb pëlcitës gjatë luftimit. Me shumë zor ishte zvarrosur gjer në dushkera nëpër këmbët e armikut që përparonte. Nëpër tymin e predhave gjermanët nuk e kishin vënë re. Sapo kish zënë pyllin e kishin vënë re katër ballistë; ata pandehën se ranë më mish të ngordhur dhe qenë lëshuar ta zënë gjallë. Fundi i fjalës Pjetri ua kish derdhur zorrët me «matiken» (kështu quan Pjetri automatikun). Nëpër rrëmujën e luftës, armiku nuk kish vënë re si kishin mbetur vlarë katër ballistët dhe Pjetri që futur edhe më thellë pyllit. Tri ditë e dy net kish mbetur Pjetri pa ndihmë, pa mjekim dhe pa ushqim. Ishte mbajtur gjallë me fletë dushku dhe me ca vezë breshke që kishte gjetur aty në një kumishtë. Guaskat e vezëve ja gjeta aty rrotull dhe më tregoi se kishin qënë të mira me shijë t'athët dhe ishin si të përzjera me gëlqerë...»

U dëgjua një e kollitur e çjerrë e të plagosurit, vijoi një përçart i pakuptim dhe më von u dëgjua kthjellët zëri i Pjetrit që kërkonte ujë.

Nëpër drurët e borigave u dukën nja katër partizanë që po ngjiteshin me nxitim për nga ne. U ngritëm më këmbë dhe u kthyem ngjatjetën: Liri Popullit!

Ay me çifte në vend të dyfekut ishte «partizan doktor Shabani» (kështu e vinte firmën) I ri dhe shëndet-dobët, me kaçurrelat e zeza mbi ballin e djersitur, shpëjtonte të hyjë në spital. M'u duk i dashur i zemrës ay mjek me dyfek krahut sa më vinte t'i hidhesha për qafe e t'i lutesha me lot për faqe:

— O shoku doktor-partizan, shpëtoje këtë trimin e lekosur që po lufton me vdekjen!



Kur unë hyra i fundit, në spital nuk ndjehej veçse ndonjë krimb i padukur që brente trarët dhe frymëmarrja e nxituar e Pjetrit. Pastaj pashë Shabanin që ngriti kokën dhe sytë i xixëlluan të qeshur. Eënë toka me Qemalin dhe u përqaftuan. Shabani foli:

— «Qemal, or vëlla, i ke shpëtuar jetën, sikur mos ishin pastruar krimbat, helmimi i gjakut nuk mund të ndalej, bëni gati brankardin dhe gjith sa duhen për rrugë, do shkojmë në spitalin e Llëngës për t'i prerë këmbën; këtu nuk kemi vegta, bëni, edhe një kamfur të plagosurit, nxitohuni!»

Si e mjekuan dhe e lojtën nga vendi, Pjetri u përmënd dhe vështroi rrotull. Qemali i rrinte në koka. I plagosuri çelji buzët e thara dhe foli:

— Shumë dobët ndihem, oj shokë, në vdeksha i çoni fjalë nanës...!

Shabani qeshi, i mori dorën, e pa në sy dhe i foli:

— «Trimat, që janë rrahur me vaj e me uthull, nuk i vdes një plagë e tillë; por trimave u flasim drejt: nga vdekja shpëtove por këmbën do ta presim!

E pashë Pjetrin që rrudhi ballin, shtërngoi dhëmbët dhe gëlltiti një psherëtimë. Druvarët kapën brankardin dhe u nisën nëpër një shteg të pyllit. Unë u rashë pas. Më tej muarëm të përtpjetën e Propasit dhe dollëm në Bigëll. Poshtë dukej i gjithë pellgu i Dardhës sikur ta shinnje në pëllëmbët: Shkëmbi i Shënpjetrit me ballin e nxirosur e të brejtur nga veriu dukej si një shkëmb prej çmërsi, tutje nga jugu, nga dërstitat e Nikolicës, zvarrisej lumi i Devollit. Kopetë e dhenve kullohnin nër luginat atje ku nisin rrëzat e Gramozit festebardhë.

Era e pishave m'i përkëdhelte faqet e ndezura dhe fitadi i lindjes po m'i rrihte flokët pas ballit dhe tëmthave. Pylli oshëtinte dhe më valavitej një shami e kuqe si gjaku, që mbajnja në xhepin e vogël të bluzës, aty afër ku rreh zemra.

Një ketër kërceu nëpër degët me një fistikë në gojë, një kope pëllumbash endeshin në qiellin e kulluar.

Në fund të Rrahut u ndava nga partizanët. U urova rrugën e imbarë dhe bëra rrugë nga e djathta.

Vëreja një copë herë fshatin që shtrihej pas shpatit të malit: shquajta gjermanët aty rrotull kishës dhe mora mendimin me sytë katër dhe me një mendim të prerë:

Sa partizanë të vinin nga Llënga do t'i pyesnja për Pjetrin.



## BALASHI

Asaj kohe ne kishim gjysmë pende e pesë dynym tokë në një skërkë afër Moravës. Pra, dy ara në rrëzim dhe një kë me emërin Balash.

Si e patën pagëzuar Balashin dhe si pat ardhur ndër ne, unë nuk ë kisha arrijtur. Veç di që vogjëlja ime ka qënë e lidhur me të sikur ne të ishim vëllezër a binjakë. Se edhe sot e kësaj dite, kur e kujtoj vogjëlinë time, shihem vet i dytë me Balashin ay pranë.

Kisha gaz të madh kur ay kulloste në mezhde, unë i rrinja ndër këmbët e para, ja mernja ndër duar lafshën e gushës së gjërë dhe të butë mëndafsh dhe me të fërkonja fytyrën; kështu tretesha nga gazi dhe zemra më ngrohej.

Ishte ka i urtë Balashi. Nuk ngitte as njerëz as bagëti. Bënte punën e robit dhe hante barin e zotit.

Me Kuqon e kumbares i bënim pendë dhe lëronim arat tona pas radhës si është e drejta dhe zakoni.

Ishte ka i fortë Balashi dhe me trup të lidhur; brirët si dy hënëza të Turkut i mbante lart, gjoksin e gjërë këmbët e holla dhe të shkathta, zverkun të ngjeshur dhe fuqinë të rrallë. Por atë që e kish jo të rëndomtë me bagëtitë e tjera, ishte zëri i tij, e pëllitura e fortë e zgjatur dhe zhurmëmadhe, që nuk pajtohej me urtinë e tia. Për këtë, disa ziliqarë më thoshin se Balashi ndjell luftë e duhej thërrur. Kjo më vinte ndër mendime të thella, të huaja për moshën time. Kështu futnja fytyrën në pëllëmbët dhe tretesha në mendime të frikëshme gjersa psherëtimat më njomeshin me lotë të hidhur.

Por Balashin nuk e gëzova gjer në fund.

Ish atëhere prilli i tridhjet' e nëndës kur na u dukën në fshat shumë ushtarë të huaj t'armatosur rëndë q'i ngritën çadëret sipër nga livadhet. Me luftë e zjarr ushtëria e Duçes pushtoi vendin tonë. Q'ato ditë na filluan prapësisrat:






Livadhet i bënë lëndina, arat i çanë thellë dhe i bënë llogore, nëpër pyje ngritën depo e limere për t'u sulur në vendet e fqinjve, krojet nuk i lëshonin se mbushnin kazanet, vijat e vaditjes i kthyen gjetiu për të shuar gërqelen se ngrinin kazerma. Pastaj u ardhi radha shpendëve që ndoqën dhe i shojtën gjer në fund, sa nuk ndihej më as zë këndezi, as kakarisje pule. Si mbaruan shpendët iu vunë gjësë së gjallë; sot një shqerë nesër dy dhen, pastaj një viç dhe më tej një mëshqerë; gjer këriçat e njomë nuk gjetën qetësi. Edhe unë nuk shpëtova nga gjëma. Të këqijat e këmishëzinjve më goditën rëndë:

Kjo ngjau një ditë vere më të mugëtirë, kur këthehen bagë-



tia nga kullota. Isha me shokë atë ditë dhe i kishim futur bagëtinë në pyll për kullotë. Dielli afër maleve — prapa reve — dukej sikur ndriste që prapa një cohe të kuqe; më pas coha e kuqe sikur u bë e murme e sa vinte i afrohej së zezës. Shokët po i ngisnin dhe i ndillnin bagëtinë të dalin nga pylli, kur vetë zura vend mb'anë jonxhës së Lemes që mos këputeshin aty bagëtia. Po shihnja një grumbull pendë pulash ndënë një drizë të mbështjella me një gazetë në gjuhë të huaj kur... dëgjova një lebeti që vinte nga Përroi i Burimeve. M'u bë sikur më kafshoi gjarpëri. Rrëmbeva sopatën e vogël, q'e mbanja pas dhe u vërsula këmbë e duar përpjetë...

Thika më shpoi në zemër, por e keqja ishte bërë: Balashi im i gJORË shtrihej sa gjat'i gjërë në fund të përroit dhe ngulconte. Ishte rrokullisur nga gremina e nuk ngrihej dot. Nga zërat e huaj që ndiheshin prapa lisave, kuptova ç'kishte ngjarë. Shokët thërrisnin dhe kërkonin ndihmë. Telua ulërinte me duart nga qielli; ay i kishte parë ushtarët e huaj kur shtynin Balashin në greminë që pastaj ta thernin.



U munduam ta ngrehim Balashin, por më kot, ay kishte thyer kryqet. Kështu s'më mbeti gjë për të bërë dhe nisa t'ja lanj me lot dhe t'ja puth me buzë lafshën e butë të gushës. Dhe si shpirt i gjallë, Balashi më shihte dhe kuptonte (se nga lebetitë e mia do kuptonin edhe gurët) dhe më gjuhën e tij t'ashpër prej plaku më lëpinte ballin tim prej kalamani dhe më shihte thellë me syt e tij t'urtë.



Pastaj u derdhën aty një sërë ushtarë. Atëhere i përmblo-  
dha këllqet e mij të njëmë dhe u bëra si i egër; kapa sopatën  
dhe u ngrita gati të mbroj Balashin tim sikur të më sulmonte  
edhe një batalion i tërë! Edhe shokët më pasuan, por ata, far' e  
keqe, na hëngër me të pabesë:

— «Do ta shërojmë Balashin», na thanë.

Dhe kur ne nuk e pandehnim, ajo çetë kusarësh cipëplatur,  
na kapën që prapa, na muarën sopatën dhe na lidhën me kapistrat  
e mushkave.

— «Do ta them, se nuk shërohet», foli i pari i tyre.

Ne vumë kujën dhe i çorëm me thonj e me dhëmbë, u kaf-  
shuam duart dhe i pështymë fytyrës, përpoqëm këmbët dhe  
qirreshim me të madhe... por ne ishim katër miturakë kundër  
një çete ujçerish të huaj.

Nuk vlejtnë as lotët as lebetitë tona, as të sharat, të pësh-  
tyrat e as kërcënimet, as lutjet e as dënësat!

Kur ja vunë bajonetën në lafshën e butë dhe nëpër curri-  
lat e kuqe të gjakut i zbardhoi gurmazi, Balashi i shkretë na  
shihte ne një grusht kalamanësh të lidhur me litarë dhe perën-  
donte syt e tij të mëdhenj prej plaku.

Atë çast bota m'u errësua, veshët më buçitën dhe u platita  
mëndje-humbur duke rrahur kokën pas gurëve të përroit.

Sa kohë mbeta ashtu nuk kuptova. Kur ardha në vehte isha  
zgjidhur, por shenjë e Balashit nuk dukej gjëkund. Shokët ki-  
shin shkuar me bagëtitë e tjera dhe veç Telua më rrinte pranë.

Nata kishte rënë e plotë. Hëna po delte që prapa lisave,  
e kuqe si më gjak. Një peshë e rëndë më pllakoste në shpirt,  
një urrejtje e tërbuar më lëvrinte në gjak.

Zhurma e huaj që tej nga livadhet ngrinte një potere që  
të çante veshin.

Këmb' e duar u vumë të dalim në buzët e përroit kur ujrart  
e burimeve po gërritnin fshehur n'errësirë.



## NJË NDODHI E JETUAR

Prandverën q'u mblodh Kongresi i Përmetit, malet ishin mbushur me partizanë. Në një nga ato ditë — më kujtohet si sot — ma desh zemra e më ra shorta, që me shokë t'i bijem malit kryq e tërthori dhe t'u shpijem bukë partizanëve. U ndodha vet' i katërtë, ne ura e madhe e fshatit, kur pamë djemt e rritur të njësitit që bënin përpjetë ngarkuar me tarkaçe të rënda. Ne, që ishim të katër ferishtë, na kishte ngarkuar kumbarja me plloska dhe po vinim të ftonim fshatin në gazin e Vanthisë që ja hanim dasmën asaj jave. E pleqësuam punën me syt e çakaritur që na lëshuan xixa dhe me këritjet e gurmazit se, sa për fjalë e kuvend, as vendi e nxinte as goja s'na punonte. Pra, edhe ne u dhamë këmbëve përpjetë: Ja t'i ftojme edhe partizanët në dasmë. Nja dy çupa të reja, që gjetëm mb'udhë, na dhanë nga një trajse buk' e gjizë për partizanët, na lidhën edhe borzilog të ri në plloskat dhe ne, ku rënça mos u vrafsha... hajde... malit përpjetë!!!

Ne Biglla e madhe e Moravës dëgjuam këngë dhe zhurmë që tej nga korijet e Pishave dhe andej i thirrëm vrapit.

Kur u afruam pamë në majën e një pishë rojen partizane me dylbi në sy. Të mëdhenjtë kaluan dhe nuk i folën, por ne, që sapo kishim mësuar t'i bëjmë buzët bilbil, i provuam një herë:

— «Fiu... fiu... o shoku partizan zbrit të hash bukë dhe të pish verë!!!»

Por ay nuk na e vuri veshin fare e as që na foli... pa ne i varëm buzët një pëllëmbë. E ku e dinim ne se roja nuk flet?

Në pyllin e Burimeve e gjetëm limerë e partizanëve. Kur na panë ne, me mësalla të bardha gjer përdhe dhe çoçer dy pëllëmbë mbi lëndinë, na u sulën me të madhe:

— «Hej plloskaxhinj, për ku kështu?»

— «Na dërgoi shoku kumbare t'ju ftojme në dasmë, të vini të gjithë dhe më kokë tuaj...»



Në fillim u dhamë plloskat the ata na uruan sipas zakonit. Trajstat na i mori një partizan, që mbante një çantë në krah dhe një kalem në vesh.



Pastaj u vumë të piqemi me partizanët. Ishin gjithë me fytyra t'ashpra, por të qeshur, rëndom me shami të kuqe qafës, rrinin ngjeshur me gjerdhane e pallaska me rroba më shumë prej gjermani dhe italiani, kush me këpucë e kush me opinga kau. Disa lanin rrobat në burimet, të tjerë vajosnin armët. Njoha xha Selimin që dikur kish qënë bazë ndër ne. Rrinte pështetur pas një ahu të madh dhe hiqte çibukun; një tufë partizanë, e më fort të rinj, i qenë mbledhur për rreth. Xha Selimi ishte skuadër-komandant, partizan i vjetër dhe plak nga mosha, i gжатë për çudi, i drejtë si dhëmballë dhe kur fliste, gërmën -r- e hante si me grykë. Të gjithë e deshën se ish trim në luftë, nishanxhi në të shtënë dhe hokatar në muhabet. Dikush po i lutej t'u tregonte ndonjë ngjarje luftime, por me të lutur xha Selimit sikur nuk i vinte mbarë dhe, me ata syt' e tij të qeshur dhe të fshehur në një si lëmsh vetullash të bardha, po shihte posht e lart të kapë me voli ndonjë fill të muhabetit...

«— Hajde, për hatër të këtyre niprave plloskaxhinj se do t'ju a hamë dasmën një javë me radhë!» Dhe filloi xha Selimi:

«— Që thuani ju djema, marsi që shkoi kishte marë tri javë kur një mesnatë, vet'i pestë, u ndodha në Qytezë. Ishte ftohtë dhe dëbora gjer mbi gjoks, por bunacë dhe era nuk para frynte se atje është vendi gropë. Duallën qytezarët dhe na pritën me gaz zemre. Burrat gjith të rrallë se i mban kurbeti, po më fort gra e çupa, q'u skuqnin faqet q'atje tej — (se jo më kot rrojnë në mes të pyllit. Shkëmbyem ngjatjetën dhe na nisën



në një bazë. Harrova t'ju kujtoj se me mua ishte edhe Petro Çobani, djalë për kokë të djalit, tashti është në brigadën e parë. E zonja e shtëpisë po vinte kazanin me ujë në zjarr, kur ne u dhamë ne porta. Ama të themi atë që është, ne citë me morra Ishim; dhe morra të sjellë prej Mokre të mëdhenj e xanxarë që të zënë e s'të lëshojnë. Në fillim e tokëm me të shtëpisë dhe vumë nga një kafshatë në gojë. Pastaj plaku na hoqi më nj'anë që të nxirnim rrobat për t'i larë e përvëlur dhe të mernim nga një banjë.

Urët në zjarr sapo ishin prerë kur ne fërkonim kurrizet, që i kishim bërë copë së krojturi. M'at'anë rrobat po zjenin në kazan. Duke u sapunisur, Petro Çobanit se si i ardhi në gojë një këngë dhe me t'ë po na çante veshët:

*«Mere mandolinën e dil në sokak...»*

Mua m'u bë sikur dëgjova krizma armësh dhe i them:

— Dale, more derr, se le që me mandolinë, por më duket se ndër brekë ke për të dalë sonte në sokak!

Vumë veshin: një batore u dha që nga Vidohova. N'atë çast ja edhe një roje e fshatit u fut me vrap n'oborr:

— Shpejt shokë se po kërcet!

Veshëm me nxitim ato që na solli plaku, kurse Petrua po mbathte ato djall çizme që mezi i nxinin; pa do ti që, si i fundit, mbeti pa roba? Dha andej e këtej, koha nuk priste, gjeti aty një thes të vjetër, i çavi një vrimë për fundi, dy për anash dhe e veshi. Shkoi gjerdhanin në mes dhe... këmbëve përjashta!

Në Borigat ishte ndezur lufta. Plumbat vinin gjer këtej, fishkëllonin si me përtesë dhe lëshonin pas një si bisht kallmëri prej zjarri. Një kompani e jona ishte përpjekur me gjermanët, dyfeku sa vinte po nxehej. Më tej shungulloi edhe topi, pastaj plasën disa shrapnela dhe gjyle mortaje. Ne u nisëm për andej, kur takuam kompaninë që tërhiqej me nxitim. Biseduam me ata: forcat gjermane u ishin dukur të mëdha. Komandanti i tyre, si m'i pjekur, i gjente t'ishin nja pesëqind gjermanë. Në luftim kishte rënë partizani Mazllëm. Një tabor ballistë po çirreshin dhe shanin që tej nga gryka e lumit.

Tre batalione partizanë ndodheshin në Dardhë, por ata edhe nuk po ndjeheshin. Mbi Qytezë na arrijti një korier: shtabi i ynë urdhëronte të tërhiqeshim duke luftuar, po vetëm në drejtim t'Arëzës. Ashtu bëmë, por gjermanët, që ishin djegur shumë herë nga qulli, tashti i frynin edhe kosit; nuk na ndoqën,



por filluan të hedhin shenja. N'errësirë gjetëm shokët që kishin zënë një vijë fronti gjatë rrugës Dardhë-Arëzë me ballë nga Lindja. Mua më takoi një vend i shëndoshë mbi një shkëmb, atëherë një dushkere.

Zbrazje armësh nuk po ndjeheshin më; u duk që beteja do hapej me mëngjezin. Komandantëve tonë nuk u zunë këmbët dhe gjithë natën. Rëndnin nga një vend në tjetrin, jepnin urdhëra për të hapur hendeqe, kontrollonin armët, ndanin fishekë, i vinin shokët të kërcëjnë për të mos u mpirë nga e ftçhta.

M'u kujtua Petro Çobani që kisha të çveshur, më ditë të hallit, dhe zura të shikoj andej këtej mos dukej njeri i veshur me thes, por nuk po binja më të. Një shok që ma bleu mëndjen dhe tragën, më tha se Petros i kishte dhënë komisarit kapotën e tij dhe e kish nisur me shërbim. Ashtu disi e fjeta mëndjen.

Pas pak njësi të Dardhës na solli disa thasë me patate të pjekura, që ishin akoma të ngrohta. Dhe ta dini, që patate më të shijëshme se ato që rriten n'ato malësi s'ke ku i gjen gjetiu.

Dha sabahu dhe fillova të shikoj për rreth. Gjermanët të veshur me kapota të murme po hynin n'Arëzë. Fill atëhere dikush nga shokët i qëlloi me mitroloz dhe ata u shpërndanë. Pastaj filloi të qëllojë topi i gjermanit si për të pastruar vendin. Në kishim urdhër mos shtijem veç po të sulmoheshim nga afër. Tej nga veriu, nga Korija e Madhe, një grup shokësh po u mernin krahet gjermanve nga larg e pa u dukur. Të tjerë po i qarkonin nga Livadhet. Prapa nesh, sipër në shkëmbi i Shënpjetrit, qëndronte shtabi ynë me një kompani rezervë. Një korier që zbriti prej andej tregoi se forca gjermane po afroreshin edhe nga perëndimi, nga ana e Kamenicës.

Si po dukej, plani i gjermanve ishte të na sulmonin nga të dy anët, të na mbyllnin udhët e tërheqjes dhe pastaj të na shtrydhnin fare në ndonjë luginë të Moravës aty rreth. Gjendja ishte e vështirë; rrugë tjetër nuk kishim: Ja ne, ja ata!

Nuk vonoi dhe hyri në luftim edhe shtabi i ynë me gjermanët që afroreshin nga ana e Kamenicës. Armiku nisi të hedhë në qiell dritëra me ngjyra, si për të dhënë shenja se na kishin rrethuar.

Nëpër poteren e luftës, pashë që zbriti nga shkëmbi i Shënpjetrit një partizan në pikë të vrapit. Ngulçonte dhe rrihte dëborën me gjoks nëpër disa përrenj gjersa u avit ndër ne. Atëhere e njoha: ishte komandanti ynë. Dha urdhër të mblidhemi gjithë komandantët e njësisive. Dhe pas pak të gjithë ndodheshim përpara tij. Atëhere e vura re mirë. Ishte i mbuluar me baltë nga koka në këmbë; i lodhur nuk dukej, veç ballin e kish të vrejtur. Na foli shpejt e shkurt:



«— Shkoni u thuani gjithë partizanëve se jemi në një gjendje shumë të vështirë; armiku po na sulmon nga dy drejtime dhe është i pajisur me armë të rënda; ka pas kallauzët e ballit dhe është i vendosur të na zhdukë. Ne do t'i sulmojmë dhe me trimëri prej partizani do t'i zhdukim... nisuni!»

Edhe nuk kishim sosur në vendet kur armiku i dendësoi qëllesat e artilerisë. Gjylet, si ndoca dosa prej zjarri, kafshonin dhe e gryenin tokën duke e përhapur mbi dëborë si ndonjë kaçamak të ronitur.

Nuk vonoi dhe armiku filloi të sulmojë me trupat. Drejt po më vërvitej një laro kapkërpudhë veshur me një si tallagane, kërcente hendek më hendek si ndonjë gallof pa pendë gjersa e futa mirë në veshkat e manxërit; ja shkrepja dhe pashë q'u rrokullis kokposhtë më hundëzaj në një baltovinë.

Armiku vashdonte të sulmojë me mitroloza dhe mashinka q'i mbanin krah-qafë, por ne i mbuluam me bomba-dore dhe me plumba. Ata dhanë e muar me të gjitha armët që kishin, por ne qëndruam me shpirt ndër dhëmbë. E thotë mirë popullorja: guri rëndon në vendin e vet!

Tashti plumba të largët po na vinin edhe që nga perëndimi por ata që na sulmuan po ktheheshin prapë.

Armiku edhe s'i kishte mbledhur mirë këllqet në istikamet që kish, kur u dha shenja e sulmit tonë. Borizanët i çanë boritë së gjëmuari. Britmat e luftës, u përzjënë me bataretë sa na u ngritën leshrat përpjetë. Ashtu u vërsulëm përpara me URRA! duke i sharë dhe mallkuar me rrënj' e degë, me soj e sorollop!

Përleshja ishte e gjakëshme dhe trup me trup. Gjermanët të trimëruar se na kishin rrethuar, me kallauzët e ballit pas, dhe me armatime të rënda, qëndruan të patundur.

Nga gjithë anët nëpër dëborën e bardhë, filluan sikur të mbijnë nga dheu, njolla gjaku që të vrisnin syrin. Pashë përpara meje Tosunin që ishte kacafytur me një gjerman të madh sa një ari dhe po mundeshin në një rrëzim me akujt. I pari i arriti Vaska që ja mbështeti gjermanit revolen prapa veshit dhe ja çau kokën më dysh sa Vaskës ju dogjën vetullat nga flaga e nagantit. Më tej, pas një kaçube, na doli përpara një gjerman me duart lart; dy shokët e tij ishin të vrrarë mb'anë një mitrolozi të shkatëruar. Gjermani i gjallë, pranonte ta vrisnim, po kursesi të ndreqte armën që vehtë kish prishur.

Gjermanët dinë mirë të sulmojnë dhe të të shtrydhnin për bukuri, por, po i vure përpara, gjëkundi s'e mbajnë vrapin; këshu që si e panë punën pisk e nisën me ik të ikim. Ne i ndoqëm me H Y A! me bjeri e bot, na ku të ha e na ku të dhëmb!



Tashti ndjekja vashdonte nëpër një fushëzë të vogël që shtrihet nga Arëza gjer mbi Sinicë. M'banë fushëzës, nga e majta kur zbret për Qytezë, është një ujvarë që derdhet me potere nga shkëmbi. Aty rreth qëndronte një gjerman i fshehur dhe s'ish e mundur të gjendej se ku ndodhej. Ay na vravi një partizan dhe plagosi tre të tjerë; po vinim vërdallë nëpër fushëzën dhe plumbat e atij qenit të fshehur si lugati, na fshiknin në zemër; së fundi e gjurmova si ay zagari plak dhe e gjeta. Gjermani ishte futur prapa rrjedhës së ujvarës në boshin që është hapur në bark të shkëmbit. Një mashinkë gjermane, që sapo e kisha zënë, më bëri punë se më plumb dyfeku nuk ja gjenja dot nishanë. I dhashë një batare ujvarës dhe në çast u rrokullis duke pëllitur tatëpjetë shkëmbit një alamet gjermani, që s'i mbet as koskë e as kokë nëpër qoshet e gurëve.

S'kishim arritur ne Shkallza e Qytezës kur u dha një aeroplan i madh dhe i zi si katrani. Ardhi një herë rrotull dhe i zhgarkoi bombat diku afër Qytezës. Pastaj toka u drodh dhe shungulluan plasjet. Do duheshin edhe tankse që lufta të merte pamjen e një beteje të madhe. Dhe tankse, gjermanët mund të kishin sjellë, por ne me kohë e kishim shkatëruar xhadenë e veane që çan këto malësi t'egërta.

Kaluam Devollin, kur shoh përpara komandantët tanë që po bisedonin midis tyre. Kishin qënë në vijën e parë të sulmit dhe tashti po jepnin urdhëra më të djathtë e më të majtë. Po shihnin nga unë dhe diç kuptova se për mua flisnin. Më thirri komisar i im. Kur u afrova dikush po i tregonte komandantit për plaçkën e luftës që kishim zënë. Pas fjalëve që dëgjova armët e zëna ishin të shumta dhe midis tyre edhe dy flamurë.

Komisari m'u drejtua:

«— Më kanë thënë, o shoku Selim, se ti i njeh mirë këto anë!»

— Si urdhëron shoku Komisar! — ja ktheva, — gjithë jetën çoban kam qënë këtyre fshatrave!

— Atëhere më thuaj, në cilin fshat mund t'i vendosim në një depo armët e kapura? Të jetë vend i sigurtë dhe rruga të punojë.

«— Shoku komisar, — ja ktheva unë, — në asnjë vend s'më mbushet qypi, veçse në Slimnicë që mban ndonjë vrap pele nga karakolli i Arëzës, për atje është rruga e hapur nga fshatarët që venë për pishë në Gramoz; atje është tokë e Ynanit por gjithë vëllezër jemi...»

Komisarit i qeshi nuri dhe më tha:

«— Do të të jap dhjetë shokë dhe të nishesh, veç prit sa të shkruaj një letër...»



U unj para një arke me municion dhe u vu të shkruajë; kur mbaroi u ngrit dhe ma zgjati letrën:

«— Këtë letër ja jep në dorë kapedan Karaxhajt. Na edhe një flamur prej të gjermanit ja jep dhuratë. I thuaj se e ka peshqesh nga partizanët alvanitë».

E mora ndër duar flamurë e gjermanit. Ish sindozot një mendeze basme me një palo kryqi në mes dhe i varur në një shtizë prej tunxhi. Po mejtobesha një çast si do t'ja delnja me gërqishten andej nga Unani kur ndjej zërin e Petro Çobanit. Ngrita kokën... ç'të shikoj? Më kapardiset përpara ky Petrua gjithë fodullëk dhe ma shkon gishtin ndënë mustaqet! Veshur fringo me rroba të reja gjermani, me gjyzylyke në sy nxjerrë nga ndonjë maskë; akoma edhe kapellën e kish plaçkë lufte me strehë të ndritur kapitur më nj'anë.

«— More, leri shakatë, — i fola, — po thesin ç'e bëre?»

«— E kam, ore, e kam, do ta mbaj për kujtim; të mori e mira, o xha Selim, tërë fajin ma pati ajo mandolina që këndonja. Hajde nisemi se do bëjmë qyfyre asaj ruge...»

E mora për qafe Petron dhe m'u ngroh shpirti; djalë i mirë, shumë i mirë.

I vumë përpara kuajt e gjermanit që po rrënkoin nga barra e rëndë. Lufta gjith po kërciste e po largohej tatëpjetë.

Mua si më plak më bënë nder djemërija dhe më dhanë një pelë balashe me shalë pun' e madhe. Dolla në krye të karvanit dhe pashë xhepanetë. Vallahi gjesh më lojti koka. Na qenkëshin nja dyzet kuaj të ngarkuar aqë shumë sa ment këputeshin në mes; mortaja më deshe a, mitroloza, bomba-dore, — ç'të të them më parë!

Muarmë rrugën drejt Arëzës nëpër fushën ku u bë lufta më e madhe. Hendeqet ishin plot me gjermanë të vrarë; dhe të vrarët veshur si për banjë, sikur do vinin në det...

Ik e ik se ku u ndodh dhe na del përpara hoxhë Hafëzi. Ishte një tyrçeli ky, që as shqipën s'e dinte mirë, po kish ilaka të fortë me ata larot e ballit; qimeverdhë e mjekërçap, pikalosh nga lëkura, çakër nga sytë dhe katarosh nga dhëmbët. Ja edhe prapësija ma preu udhën, më tha mëndja.

— Ore djema, — u thërres shokëve, — amanet ore pelat mos na pëlcastin nga syri!

Hoxha më hëngri me sy dhe ma pat:

«— Pse kështu vrisna robët allahut yve a?»

«— Ik or surrat palarë — i them, — ik ore, se për atë përrëndi gjer tashti qindi u mbush dhe ti e kapërçen, po thyej qafën nga na dolle se mezi m'u ftoh manxëri...»



Më tej kur arritëm fushën e Arëzës, më pa syri atë që do mos e harroj gjer të më mbijë bari mbi krye: Gratë dhe çupat e fshatrave për rreth qenë lëshuar nëpër dëborë pas partizanve të vrarë dhe të plagosur. E ngrihnin kujen këto nënat si për djemat e tyre dhe unë, që qiri s'i kam ndezur as djallit e as xhebrahilit, kur i pashë që i ngrinin të plagosurit dhe u mbështillnin plagët dhe trupin me shallat e me këmishët e tyre, sytë m'u mbushën dhe u mundova të gëlltit dënesat.

Afër Arëzës, takuam kompaninë e shtabit që po vraponte tatëpjetë nga vashdonte ndjekja e armikut. I shkëmbyem lajmet dhe morëm vesh se ata e kishin vënë në ikje armikun drejt Kamenicës.

Kapërxyem Arëzën gjith anës lumit Devoll, lamë më të djathtë Nikolicën dhe morëm rëzë Gramozit. Ndjehesha i lodhur dhe goja më hapej për gjumë. Pelën nuk e ngisnja as me mamuzet e uzengjijve e as me fshikull, po gjith me të përpjekur gjuhën pas qiellëzës. Shokët prapa po qeshnin dhe molloisnin ngjarjet e luftës. Djem ata. Unë po dremitnja dhe po qyravitesha majë kalit se andej xhan xhin armiku s'mund të kishte; koka më qe varur mbi gjoks dhe isha bërë shuk i tëri... kur ndjeva përpara zhurmë e brohori... Hap sytë e shikoj: unë jam e unë s'jam!!! Ç'është kështu??? Qemë afruar Slimnicës dhe një kallaballëk andartë grekë ishin sëritur për pritje në të dy anët e rrugës me dyfegjet në krah dhe shihnin nga ne me gaz e me kuresht. Si duket kishin marë vesh ç'kish ngjarë dhe ç'po ngjiste. Desha s'desha ngrita kokën lart, u krekosa mir' e mirë mbi shalën e pelës dhe thirra nga shokët:

— Petro more bir, ç'është kështu mor derë-bardhë? e përse po bjenë këto borë, ore? Kë presin kështu, bre?  
Pela gjith po ecte dhe desha s'desha isha brenda në vallet, po buzët ama m'u bënë trokë.

«— Mbahu xha Selim, — më kthehet Petrua, — ti i dhe datën gjermanit e tashti ç'të ka buza që të dridhet nga boritë e andartëve?»

«— Mirë more bir, — i them, — po unë s'jam për këtë shkallë, na hip ti në pelët si i parë, se për atë vakëf, po më mbliidhet një si lëmsh në kërthizë...»

Dy komandarë grekë m'u derdhë për qafë dhe më puthën. Njëri dha një komandë:

— «Për nder armë!!»

Po kalonim në rivistë, si i thonë, dhe trupi m'u mbush si me gjilpëra sa u bëra për hapu dhë të futem. Më vinte për-pjetë e kijamet. U dha një tjetër komandë dhe na u derdhë sipër



këta abdartët puth e bot, zer për dore e përqafo, sa mua m'u buavitnë faqet nga të puthurat dhe më kërcisnin koskat nga të përshëndoshurat. Një mustaqe-kacaros i mblodhi shokët rreth meje e ja thirri këngës:

*Alvanites palikarja*  
*Me spathja qe me hanxharja*

• • • • •

Prapë u bë heshtje. Një komandar grek, burrë i thyer po i pashëm, po na mbante fjalë. Unë diç kuptoj nga gjuha e tyre se në të ritë tim vinja dendur andej nga Sheheri me lejlek për korrje si argat. Ay që fliste ishte vetë Karaxhaj.

Na përgëzoi për fitoren na tha se jemi vëllezër e miq nga gjysh-stërgjyshët që bashkë edhe ata kanë luftuar kundër latinve dhe turqve; por mua më la mbresë të madhe fjala e tij andej nga fundi kur tha: «Ne nuk do harrojmë kurrë karvanet e grekve t'uritur ata karvane që vjetët e fundit i ranë kryq e tërthori vendit tuaj dhe u kthyen të ngopur dhe të ngarkuar me bereqet; sot që u shohim miq ndër ne gëzimi ynë është i pakufi!»

Si më ardhi për krah një terxhuman që dinte thjesht shqip, më ardhi fjala edhe mua. Desha s'desha e hapa edhe unë, ca me dorë e ca me gojë e u dhashë ngjatjetën për nderin që na bënin. Por me mëndjen time thosha: Hajde, hajde o Selim mavria, më t'u shoftë nami, u bëre ti t'i mbash fjalë gjithë atij mileti dhe për ty të thërresin ZITO gjith ata burra!

Së fundi nxora letrën e komisarit dhe flamurin e gjermanit dhe ja dhashë Karaxhajt. Atëhere gazi vajti në majët sa vetë Karaxhaj u mallëngjye e më puthi e më përqafoi vëndçe. Unë nxora një top cigare nga ato q'i zumë gjermanit dhe jau ndava të gjithëve.

«— E sollët hakun tek i zoti, — më foli Karaxhaj, cigaret janë greke të plaçkitura nga gjermanët.»

Zërin e kish si të ngashëryer dhe qepallat i rrihnin si më dendur, por lotët — të themi atë që është — i gëlltiti.

Kur po zhgarkonim në një oborr, një komandant grek zgjodhi një bombë-dore gjermane, prej ato që e kanë kurrizin si breshkë. Duke më thënë diçka që nuk e kuptonja e çvidhosi bombën dhe u derdhën prej saja një grusht rruaza të zeza, njëra sa një danë gruri. Këto, or tungjatjeta, na qënkëshin gurë çakmaku, që gjermani, si i kish boll, i përdorte në vend të barutit. S'e



bëra të gjatë dhe e lójta hovardhallëkun, por Karaxhaj ma mbajti dorën.

Në fund t'oborrit po cigarisnin në hell dy milorë. Na mbajtën për darkë.

Pastaj ardhën dy korierë nga Dardha me urdhër që të kthehemi shpejt.

Zona ishte spastruar krejt. Shokët kishin kapur edhe një top, materiale të tjera dhe dy barrë pajra vajzash, të plaçkitura nga armiku. Gazin e fitores ma prishi lajmi se gjithësej dymbëdhjetë shokë kishin mbetur të vrarë gjatë asaj lufte.

Dhe vetë Karaxhaj na ndihmoi të ngarkojmë kuajt një për një.

Na përcollën gjer në kufi.

«— Hajde, sinagonisté, orakali!

— Mir u pafshim!

— Thanato tu fashizmu!

— Liri popullit!

Dhe muarëm monopatin rrëzë Gramozit nëpër pishat që rënkonin nga dëbora.»

Kaqe tregoi xha Selimi atë ditë në pyllin e Moravës.

Kur na bënë gati trajstat, atëhere u kujtuam se po priste fshati ta ftojmë më dasmë. U lamë shëndet partizanve dhe muarëm vrugat e pyllit për në fshat.

Lart në qiell, nga majat e Moravës, po sillej një shqiponjë.





## ZJARR NË FOLENË TIME.

Dimri i fundit që mbajtën kokën përpjetë hoxhakët e bejlerve, pat qënë me të vërtetë i keq dhe i ashpër. Dëborra ra jo me pllaska por shtëllunga me fërtymë sa i rëndoi së tepërmi malet e lartë që nisën të gjëmojnë nga tufanet sikur rënkonin nga oarra e rëndë. Okita i veshi ahët e Moravës me një kore si prej xhami. Veriu mblodhi dëborën kapulicë nëpër hijet e përrenjtë e pyjeve dhe vetëm majat e drurëve mbetën jashtë. Mjergulla e denaur lëshojë mëngjes e mbrëmje nëpër napsirat e maleve dhe mbyste lusen me një si lave të noushme në ngjyrën e qumështit të prerë.

Egërsira pat shumë atij dimri të mallkuar dhe më fort eger-sira me dy kembë që ishin lëshuar me horchi e kopera me mashinka qares dhe me ure të ndezura nder uar, pas me laro kalauze e me qen zinxhiri. vesnur me donoma të bardha dhe me kapella të gjera që vareshin mbi vesnët, delnin si hije nga mjergulla dhe lëshoneshin si ujë të lëpuar neper ishatra; mbështetur pas gjeruheve shinin me mashinka mbi femije dhe çapinin gojen e zbardhinin dhembet kur kalinin lepetinë ndër gra.

Në një natë të tillë u ndodha mik në ishatin tim. Kështu them, se atëhere kisha disa muaj që mbanja një yll të kuq në ballë dhe në kondakun e dyfegut.

Me katër shokë partizanë bënim rojë në një postë vrojtimi në lindje të ishazit mbi një kodër. Mbanim veshët ngrehur dhe sytë katër mbërthyer n'errësirën andej nga pandehej se vinte armiku. Disa çape para nesh rrinte përgjegjesi i rojes. Ai kishte ngulur këmbet në dëborë, kapotën zberthyer, jakën ngritur sa tehu i saj i epërmë i arrinte kurorën e prapme të flokëve, duart i kish shtërnguar në kollanin e lëkurtë të mezit, kundronte tutje në horizont, atje ku cipa e përskuqur e agimit me-



zi shqubëj nga vija e zbardhëlyer e kodrinave. Prapa nga fshati ndiheshin çapat e patrullave partizane që gatiteshin të vijnë të ndrohen me ne. Ngadalë fshati po zgjohej ndënë zbardhëllimin e mugët t'agimit në kohën kur tingujt e këmbanës së kishës u përhapën mbi fshat. Hapësira po ndritej e hijet e natës zvarriteshin ngadalë sikur rëkëlleheshin nga një dorë e padukur.

Befas një shirit drite, e verdhë, në formën e një rrodheje, shpërtheu drejt qiellit dy treqind hapa tutje dhe pastaj një krizmë e vetme dhe e thatë prishi qetësinë e mëngjezit. Drita u ngjiti sa dy minare lart, qëndroi atje disa çaste sikur u mbërthye dhe u lëshua teposhtë duke ndritur me një dritë verdhashe dhe të dobët. Pas drurësh dhe ndër hendeqe filluan të shkasin hije akoma t'errëta të veshura me roba të bardha; ishte e kjartë: fshatit i afroheshin gjermanët.

Dhamë alarmin në çast duke shtënë me pushkë e bomba dore drejt armikut që afrohej vjedhazi. Si përgjigje muarëm batara të gjata mitrolozi. Nga fshati nuk mungoi përgjigja e zjarrit; nga hendeqet e dritoret e shtëpive të fshatit plumbat batara lëshoheshin kodrave dhe fushave duke ngritur re e dumanë pluhuri. Një gjyle topi plasi n'oborin e kishës dhe u vuri





gërshërën drurëve t'oborrit. Shtëllungat e tymit ngriheshin si mullarë të murmë nëpër sheshet e fshatit pas krizmave t'egra të gjyleve. Ktheva kryet nga fshati im dhe, kur pashë atë gjëmë që vërsulej, një ngashërim i thellë më mbuloi shpirtin. Më vinte të thërres, të çirresha, të ulërinja si një ujk i tërbuar dhe të hanja me dhëmbë dhe me thonj atë hordhi që godiste aqë egër dhe vërshonte aqë zjarr mbi atë folenë time të dhëmbshur ku njoha dritën dhe jetën. Ajo shtëpia ime e vogël e zgjuar dhe e lebetitur në gjumë, më dukej sikur ishte fshehur zjarrit dhe prishjes, aqë sa unë nuk e shihnja dot. Gjylet po çkallmonin çatitë e shtëpive, rafshonin hajatat e kumbullat dhe bënin që toka të dridhej si n'ethe. Më vinte të rrëmbej granata dhe gurë (po edhe gurë), pushkën a mitrolozin dhe të sulesha për të mbrojtur folenë time. Por n'atë skëtërrë zjarri arsyeya nuk më linte t'i bëj rrugë atij vërshimi të marrë.

Nëpër zhurmën shurdhonzëse të luftës, dëgjuam një urdhër të shkurtër të komandës: — «Hetoni nga maja e lisit vendin ku ka ngritur mortajat armiku.»

Mitralieri i shkathët nuk e bëri të gjatë. Rrëmbeu dylbitë, u mbërthye si një mace pas trungut të lisit për anash dhe u vërvit këmb'e duar drejt majës. Duke rrëzuar ashkëla të thata nga lëkura e lisit, ay u ngjit, zuri vend mbi një degë, vuri dylbinë në sy, rrotulloi vështrimin në gjysmë rrethi përpara; pastaj lëshoi dylbitë në gjoks, uli kokën dhe na thirri: — «Poshtë shelgjeve, nga ana e mullirit, më të djathtë të lumit, katër mortaja...».

Një batore plumbash vërshëllyen nëpër degët e lisave.

— «Ulu poshtë, të diktuan, — i thirrëm njëzëri.

Shumë vonë. Mitralieri ish goditur për vdekje. E pamë nga poshtë nëpër gërshetin e degëve kur desh të mbahej me duar pastaj me këmbë: mundim i kotë! Nëpër vërshëllimën rënko-njëse të degëve që çaploheshin ndënë peshën e të vrrarit, ay u përplas për tokë ndënë rrënjët e lisit. Kjo ngjau vetëm në një çast. M'u duk atëhere sikur një thikë e mprehtë më çavi në shpirt dhe i shtërngova nofullat me forcë sa dhëmbët më kërse-llitën. Nga kafka e çarë përmbi veshin e djathtë i zbardhnin trutë sikur përçeshnin vdekjen. Në faqen e djathtë i ishte derdhur syri bojëhiri i kaltëryer.

Vendosëm të ndrojmë vendin: Marsh nga e djathta! Duke u zvarrosur i treti në radhë, tërhiqnja pas shokun e vrrarë e më tutje në rrugën që ndiqnim, pashë të këputura kopsa palltosh



të shokëve të parë; e para se të ishin këputur ato kopsat e ngrata kishin nga një alamet brazde... Nuk ishte shaka, përmbi ne në radhën valavitëse të lisave të vegjël, bataretë e mitrolozave gjermanë, këputnin degët e fletët si me një kosor të mprehtë e të padukur. Zumë një hendek të ri dhe filluam të hapim zjarr. Pëgjegjësi m'u drejtua:

— «Ti, shoko, nisu për në fshat, lajmëro shtabin mbi vrojtimin dhe për shokun e vrarë...»

Unë ktheva kryet dhe disi e pashë në sy, diçka desha ti them por mora përgjigje një vështrim t'ashpër.

Për rreth kundërmonte barut. Plumbat dhe zjarri i armikut sa vinte po shtohesh. N'atë rrebesh gjëmimesh gjylet pëlcisnin si rrufe në furtunë e më dukej sikur qielli po e çkallmonte dhe rrihte tokën me një kopan të madh prej zjarri.

E mata me sy rrugën e zbuluar, ku duhet të kalonja. i hodha një sy trupit akoma të ngrohtë të shokut të vrarë... Ndjeva se diçka hakmarrëse përmbante lajmi që do shpinja.

Këto zgjatën vetëm një çast dhe u vërsula drejt fshatit disi shtritur disi në vrap në një mënyrë që është zor ta tregosh. Arrita në shtëpitë e para. Tymi i murmë i gjyleve përzjehej me dumanin e kuqëremtë të tullave që ngrihej nga shtëpitë e dërmuara; copa trarë e makazë fluturonin si cingla nëpër flagët e zjarreve. Arrita në bazën e komandës:

— «Shoku Komandant, diktuam armikun herët n'agim dhe qëlluam, mortajat janë në oborrin e mullirit nga e djathta, mitralieri i rojës ra në krye të detyrës...»

Në fjalët e fundit, komandanti u mvrejt duke mbyllur për një çast sytë, sikur të mos desh të shihte vdekjen që dëgjoi. Pastaj m'u drejtua:

— Durim djalë, edhe disa minuta, tashti nisu për në shkët, shko zerë vend ja aty afër kishës...

Kur ktheva kryet andej pashë një radhë shokë që ishin shtritur pas një ledhi mbi dëborë dhe qëllonin me nxitim.

Nëpër qoshe e vija u vura në rrugë. Rrugët e fshatit tim, të njohura të dashura; ç'do gur e qosh i tyre më kujtonte gjithë jetën time. Më dhimbsheshin ato shtëpitë e vogla që po i rafshonte lufta, ato kopshte mbuluar me dëborë, hoxhakët e rëzuar... Urat e vogla gjatë rjedhës së lumit që gjarpëron nëpër fshat; atje kur isha i vogël hidhnja gëpin dhe i harruar pas peshkut nanurishja ëndërat e fëmijërisë pas valëve t'ujit. Më tutje shkolla ime; xhamet i qenë ronitur, prevazet e dritoreve



si skelete, më dukej sikur më vështronin me habi e me frikë: Shkolla ime ku kalova vjetët e lumtur të vogjëlisë. Më dukesh sikur brenda atyre mureve të gërvishtur nga kujtime kalamanësh do të shifnija vehten time fëmijë, midis bangove me nxënës, me syt e kulluar dhe pantallonat e shkurtëra, faqendezur, më këmbë duke recituar vjershën e dashur:

*Asht toka e jonë  
Të parët na e lan  
Askush mos e preki  
Se vdesim të tan!*

Një qenie njerëzore ishte copëtuar atje në skajin e obrisrit të shkollës. Ja edhe gropa e gjyles afër kufomës. Koka me një pjesë të gjoksit e grirë nga predha, qe vërvitur ndënë fronin e gurtë. Nga mish e zorrë të bëra lëmsht rridhte gjak. E vështrova mirë: një e ngjethur më pushtoi. Ishte Dhorka. Shoqja e vogjëlisë sime. Atje e kish përfshirë vdekja. Me atë kur ishim fëmijë venim në shkollë e shëtitnim në vreshta. Dhe shpesh herë ashtu si pa të keq, me zemër ferishteje i thosha:

— «Moj Dhora, unë kur të rritem do të të mar nuse...»

Asaj i kuqeshin edhe veshët dhe ikte e turbulluar drejt tek e ëma:

— «Mama, ay Pavli më thotë llafe turpe...»

Por prapë shkonim bashkë në shkollë sikur të mos kishte ngjarë asgjë. Por ja tashti sa me tmer kishte mbaruar. Sytë qelq të zgurdulluar dhe pikla nga gjaku i vet i kishin spërkatur sy e fytyrë.

\* \* \*

Kur arrita në llogoret e shokëve isha disi i trullosur e pa mënt në kokë. Por ata flisnin shtruar dhe qëllonin me kujdes. Kështu e mblodha vehten dhe rashë afër tyre.

Shtërngata e luftës disi ishte platitur.

Po sa e tmerëshme është ajo qetësi e pabesë! Një heshtje e plotë pas një skëterre gjëmimesh. Syri i gjaktë i armikut, ndër ato çaste përgjon gjahun por edhe shpesh herë vështron prapa. Në ato minuta kur heshtja ishte vendosur, nga larg ushëtima e luginave dhe jehona e kodrave, solli tingujt e nxituar të këmbanëve të kishës të fshatit fqinj. Dhe m'u duk se ata tinguj të qëlluar me nxitim dhe si me këmbëngulje, vinin nga një botë tjetër. Dhe bukur vepronin ato këmbana kun-



drejt radiove e raketave të gjermanit. Ato ishin sinjale të ndër-  
lidhjes partizane. Shumë herë të tjera i kisha dëgjuar ato këmba-  
bana, por sot n'ushëtimin e zërit të tyre të rrëmbyer, më dukej  
se ndjenja një kumbim të fuqishëm dhe t'ëmbël që m'i ngriti  
flokët përpjetë dhe nuk di se si ngjau, por nofullat m'u shtër-  
nguan vetiu. Një revoltë kryeneçe ndjeva se më plasi në shpirt  
dhe diçka kryengritëse dhe e ashpër po më çkallmonte gjoksin  
përbrënda. Katilat dhe zjarrvënësit ishin m'at'anë lumit, flagët  
dhe të vrrarët më këtë anë; por jo vetëm flagët, jo vetëm të  
vrrarët, këtej ishin dhe hakmarësit! E ndjeva në pëllëmbët he-  
kurin e armës sikur po më brente mishrat. Nga kopshtet për-  
tej, gjermanët e fshehur pas gjerdheve thërrisnin:

— «Partizan kaput»!


Pastaj zëra ballistësh:

— «Partizanë dorëzohi...»

Dorëzchu? Po, pritme se dorëzohem!

Që nga kodrat përtej, andej nga vinin tingujt e këmbana-  
ve, batare të reja filluan të qepen në kurriz të gjermanëve. Dhe  
ja n'atë çast boria jonë lëshoi tingujt e sulmit. Atëhere u vër-  
sulëm të gjithë. E ngrita mirë trupin dhe zërin e ju betova  
vehtes:

— «Për folenë time që po digjet, për ata që sot u vranë në  
syt e mi, për hakmarrje, për Atdhe e për fitore... Përpara!!!  
Dridhmë në gjunjë nuk ndjeva e as shtangje. Një urrejtje  
e tërbuar për armikun më shtërngoi kokën. Edhe vdekje në kish,  
unë nuk e njihnja. Sepse zëri i ndërgjegjes, zëri i urrejtjes është  
më i fortë se frika.





M'u duk atëhere sikur një flamur i kuq, i përflakur e madhështor m'u ndeh përpara!

Ashtu të gjithë u lëshuam në sulm. Qëllonim ku të mundnim dhe rëzoheshim atje ku nuk shihnim. Po përsëri vërsuleshim përpara duke e ndjekur armikun.

\* \* \*

Kur trupat e armikut u tërhoqën, atëhere pata kohë të takoj ata shokë që na ardhën në ndihmë duke na lajmëruar me tingujt e këmbanave. Pandehnja të ishte ndonjë Brigadë apo Batalion partizan por nuk ishte ashtu.

Ishin djemt e njësiteve të fshatrave për rreth. U vërsulën në ndihmën tonë kur na panë të rrethuar. Nuk kishin armë të gjithë. Në çdo katër veta kishin një pushkë. Të tjerët mbanin nër duar sopata dhe bomba dore.





## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Maleve në Shënëndre .....	3
Gazet dhe helmet e fshatit tim.....	14 +
Byk e kashtë nga fshati im .....	30
Kur isha i vogël .....	37 +
Pusia anës lumit .....	44
Mihali .....	54
Teto Limiadha .....	61
Ndënë shëlgjet ne mulliri .....	66 +
Pjetër Prenga, partizan prej Iballe .....	79
Balashi .....	88
Një ndodhi e jetuar .....	92
Zjarr në fole në time .....	102